
DORACAK PËR TRAJTIMIN E MONEDHAVE VIRTUALE NË PROCEDURAT PENALE



Doracak për trajtimin e monedhave virtuale në procedurat penale

Botues: Misioni i OSBE-së në Shkup

Autorë: Llençe Ristoska, Anita Veternik

Redaktorë: Artan Murati, Gjorgji Koneski

Përkthim dhe lekturë: “Bestel”, Shkup

Dizajni grafik: Polyesterday, Shkup

Materialet në këtë botim janë vetëm për referim. Edhe pse Misioni i OSBE-së në Shkup ka përkushtuar kujdesin më të madh në zhvillimin e tij, i njëjti nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, apo për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, asnjë pretendim nuk mund të bëhet kundër OSBE-së lidhur me pasojat e mundshme nga besueshmëria e informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

ISBN: 978-92-9271-028-6

Doracak për trajtimin e
monedhave virtuale në
procedurat penale

Përmbajtja

I. Hyrje	8
II. Konceptet dhe përkufizimet	10
1. Monedhat virtuale	10
1.1. Monedha virtuale e konvertueshme dhe e pa konvertueshme	12
1.2. Monedha virtuale e centralizuar dhe e decentralizuar	13
2. Pjesëmarrësit e sistemit të monedhës virtuale	15
2.1. Shpikësit dhe administratorët/emetuesit e monedhave	15
2.2. Gërmimi dhe gërmuesit	16
2.3. Përdoruesi	17
2.4. Shkëmbyesi	18
2.5. Platformat e tregimit	20
2.6. Portofoli i monedhës virtuale	20
2.7. Ofruesi i portofolit	23
2.8. Fara	24
2.9. Mundësuesit e pagesave	25
2.10. Anonimizuesi (mjete anonimizes)	25
2.11. Përzierësit dhe “tumblers”	25
2.12. Tor	27
2.13. VPN	27
2.14. Bitcoin	27
2.15. Altcoin	28
2.15.1. Kripto-monedhat e bazuara në gërmim	28
2.15.2. Monedhat stabile	29
2.15.3. Tokenët e sigurisë	29
2.15.4. Tokenët e shërbimeve	29
3. Si zbatohet në praktikë koncepti i monedhave virtuale	30
III. Rëndësia e monedhave virtuale në procedurat penale	31
1. Zbulimi i monedhave virtuale në procedurat penale dhe marrja e informacionit dhe provave përkatëse	31
2. Vendosja e kontrollit mbi monedhave virtuale	34

IV. Legjislacioni i Republikës të Maqedonisë së Veriut lidhur me monedhat virtuale	37
1. Baza ligjore kombëtare për trajtimin e monedhat virtuale në procedurat penale	38
1.1. Sekuestrimi dhe konfiskimi i përkohshëm i monedhave virtuale si sendeve të përdorura gjatë veprës penale dhe sendeve të dala nga kryerja e veprës penale	39
1.1.1. Sekuestrimi i përkohshëm i monedhave virtuale si sende të përdorura ose sende të fituara nga kryerja e veprës penale	40
1.1.2. Konfiskimi (sekuestrimi i përhershëm) i monedhave virtuale që janë përdorur ose janë të fituara nga kryerja e veprës penale	44
1.2. Sekuestrimi i përkohshëm dhe konfiskimi i monedhave virtuale të cilat paraqesin dobi pronësore të fituara nga kryerja e veprës penale	46
1.2.1. Sekuestrimi i përkohshëm i monedhave virtuale të cilat paraqesin dobi pronësore e fituar nga kryerja e veprës penale	46
1.2.2. Konfiskimi i monedhave virtuale që paraqesin dobi pronësore të fituara nga kryerja e veprës penale	48
1.3. Monedhat virtuale si provë në procedurat penale	49
2. Baza ligjore ndërkombëtare për sekuestrimin e përkohshëm dhe konfiskimin e monedhave virtuale që janë obliguese për Republikën e Maqedonisë të Veriut	53
3. Sfidat praktike lidhur me sekuestrimin e përkohshëm dhe konfiskimin e monedhave virtuale në procedurat penale dhe pyetjet e hapura	55
V. Përvoja e Republikës së Sllovenisë në trajtimin e monedhave virtuale në procedurat penale	59
1. Korniza ligjore	59
2. Hetimi dhe sigurimi i informacionit	63
3. Sigurimi i kërkesave dhe konfiskimi i pasurisë	65
4. Dispozitat penale përmbajtësore në kornizën ligjore sllovene	67
5. Përvoja praktike – studim rasti	70
VI. Përfundime dhe rekomandime	75
Bibliografia	78
Shtojca	83

BE	Bashkimi Evropian
BQE	Banka Qendrore Evropiane
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
BB	Banka Botërore
FATF	Grupi i punës për Veprim Financiar
GjDBE	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
RrEGjKK	Rrjeti Evropian Gjyqësor i Krimit Kibernetik
BS	Banka e Sllovenisë
SSPO	Prokuroria e Specializuar Shtetërore e Republikës së Sllovenisë
PP	Prokuroria Publike
PP	Pastrimi i parave
FT	Financimi i terrorizmit
MV	Monedhë virtuale
MDBQ	Monedhat digjitale të Bankës Qendrore
VPN	Virtual Private Network (Rrjeti privat virtual)
PoW	Proof-of-Work (prova e punës)
OFM	Ofertat fillestare të monedhave
Kodi QR	Kodi i përgjigjes së shpejtë
PIN	Numri personal i identifikimit
IP	Protokolli i Internetit
ID	Identifikimi personal
CCTV	Televizor me qark të mbyllur ose mbikëqyrja me video
UTXO	Produkti i transaksionit të pashpenzuar
NNJ	Ndihma e ndërsjellë juridike
AMLD 5	Direktiva (EU) 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e datës 30 maj 2018 që e ndryshon Direktivën (EU) 2015/849 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, dhe që i ndryshon Direktivat 2009/138/EC dhe 2013/36/EU

ZPPDFT	Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit i Sllovenisë
ZPlASSIED	Ligji për Shërbimet e Pagesave, Shërbimet e Lëshimit të Parave Elektronike dhe Sistemeve të Pagesave i Sllovenisë
ZDP-2	Ligji për Punë Devizore i Sllovenisë
ZNVP-1	Ligji për Letrat me Vlerë të Pamaterializuara i Sllovenisë
ZTFI-1	Ligji për Instrumentet Financiare i Sllovenisë
ZUE	Ligji për Futjen e Euros i Sllovenisë
OZ	Ligji për Obligacionet i Sllovenisë
SPZ	Ligji për Pronësinë i Sllovenisë
KZ	Kodi Penal i Sllovenisë
ZKP	Ligji për Procedurën Penale i Sllovenisë
KP	Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut
LPP	Ligji për Procedurën Penale i Maqedonisë së Veriut

I. Hyrje

Monedhat virtuale po bëhen realitet i ri jo vetëm për sistemet financiare, botën digjitale dhe përdoruesit e tyre, por edhe për organet e zbatimit të Ligjeve dhe gjyqësinë. Pavarësisht ekzistencës dhe qëllimit të tyre legjitim, monedhat virtuale shpesh janë në shënjestër të kriminelëve dhe paraqiten si mjete të përdorura për kryerjen ose që janë si rrjedhojë e një veprë penale ose si pasuri e përfitur nga kryerja e veprave penale, gjë që krijon nevojën që organet e ndjekjes të zhvillojnë një kuptim më të thellë mbi konceptin e monedhave virtuale, përdorimin e tyre dhe për rrjedhojë, keqpërdorimin e tyre për qëllime kriminale.

Doracaku për trajtimin e monedhave virtuale në procedurë penale është zhvilluar me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup në kuadër të projektit: “Forcimi i Sundimit të Ligjit dhe i të Drejtave të Njeriut në Maqedoninë e Veriut” dhe në bashkëpunim me Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publik. Qëllimi i Doracakut është i dyfishtë: 1) të shërbejë si një mjet për organet kombëtare të zbatimit të Ligjeve dhe Prokurorinë në procedurat penale që përfshijnë monedhat virtuale dhe 2) të përdoret si një mjet trajnimi për gjykatësit dhe prokurorët publikë që ndjekin trajnimin në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë.

Ideja kryesore për zhvillimin e këtij lloj Doracaku qëndron prapa situatës aktuale në Maqedoninë e Veriut lidhur me monedhat virtuale, e cila është më se sfiduese. Pasi nuk është në gjendje t’i njohë monedhat virtuale si realitet, legjislacioni në Maqedoninë e Veriut në këtë moment nuk merret fare me monedhat virtuale. Megjithatë, duke pasur parasysh interesin e Maqedonisë së Veriut për integrim në BE, standardet e BE-së dhe standardet dhe instrumentet ndërkombëtare që e obligojnë Maqedoninë e Veriut, në momentin e botimit të këtij Doracaku, ka përpjekje legjislative të autoriteteve kombëtare të Maqedonisë së Veriut për t’i përcaktuar dhe për t’i rregulluar deri diku monedhat virtuale. Duke marrë parasysh këtë, Doracaku ofron një pasqyrë teorike të konceptit të monedhave virtuale, e nënvizon pozicionin legjislativ dhe përpjekjet legjislative të autoriteteve të Maqedonisë së Veriut, si dhe ofron zgjidhje praktike se si të trajtohen monedhat virtuale në procedurat penale në bazë të legjislacionit aktual.

Për më tepër, Doracaku ofron informacion për standardet ekzistuese të BE-së në këtë fushë dhe praktikata më të mira, duke marrë si shembull legjislacionin slloven, si legjislacion i ngjashëm me atë të Maqedonisë së Veriut, por në të njëjtën kohë legjislacion që është në përputhje me të gjitha standardet evropiane.

Përveç mundësisë për ta thelluar të kuptuarit e tyre rreth zhvillimeve ekzistuese ligjore lidhur me monedhat virtuale në procedurat penale, profesionistëve u jepet mundësia të mësojnë nga përvojat e vendeve të tjera dhe t'i zbatojnë praktikatat më të mira.

Në thelb, Doracaku synon t'i përmirësojë kapacitetet e organeve të ndjekjes në Maqedoninë e Veriut kur kanë të bëjnë me monedhat virtuale në procedurat penale, duke ofruar informacion praktik për hetuesit dhe prokurorët për hetimin dhe sekuestrimin e monedhave virtuale në procedurat penale. Duke pasur parasysh se Doracaku nënvizon standardet ndërkombëtare dhe të BE-së në këtë fushë, të kombinuara me përpjekjet aktuale kombëtare, ai mund të shihet edhe si një udhëzues për autoritetet e Maqedonisë së Veriut të cilët janë të interesuar për hartimin dhe miratimin e legjislacionit gjithëpërfshirës dhe të harmonizuar për temën e monedhave virtuale në procedurat penale.

Metodologjia e përdorur për zhvillimin e këtij doracaku bazohet në hulumtimin ligjor në këtë fushë dhe njohuritë dhe përvojat praktike të ekspertëve që e kanë zhvilluar atë. Gjithashtu, janë realizuar një sërë takimesh dhe intervistash me përfaqësues nga institucionet e Maqedonisë së Veriut, të cilët janë të interesuar për zhvillimin e kornizës ligjore për monedhat virtuale (në tekstin e mëposhtëm MV).

Doracaku përbëhet nga pesë kapituj kryesorë, duke përfshirë hyrjen si kapitull i parë. Kapitulli i dytë fokusohet në konceptet dhe përkufizimet të cilat praktikuesit duhet t'i njohin për ta kuptuar më mirë teknologjinë dhe monedhat virtuale. Kapitulli i tretë shpjegon rëndësinë e MV-ve për procedurat penale dhe jep informacion dhe këshilla praktike se si të zbulohen dhe të sigurohen MV-të në procedurat penale. Kapitulli i katërt analizon legjislacionin e Maqedonisë së Veriut dhe ofron udhëzime për praktikuesit për sekuestrimin dhe konfiskimin e MV-ve sipas legjislacionit aktual. Gjithashtu janë shtjelluar edhe detyrimet ndërkombëtare, të cilat Maqedonia e Veriut i ka marë përsipër lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e MV-ve. Kapitulli i pestë përfshin përvojën e Republikës së Sllovenisë, si një përvojë relevante e BE-së në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të MV-ve. Korniza e shtjelluar ligjore është mbështetur me një shembull praktik, e po ashtu është përfshirë edhe një rast studimor. Kapitulli i fundit trajton përfundimet dhe rekomandimet, të cilat i kombinojnë përvojat praktike që ekzistojnë në Slloveni dhe kornizën ligjore ekzistuese në Maqedoninë e Veriut.

II. Konceptet dhe përkufizimet

1. MONEDHAT VIRTUALE

Monedhat virtuale nuk janë një koncept i ri, duke pasur parasysh monedhat e shumta virtuale që janë shfaqur dhe janë zhdukur gjatë dekadës së fundit, duke filluar nga E-Gold (1996), WebMoney (1998), Liberty Reserve (2006), Bitcoin (2009) etj.¹

Përkundër këtij fakti, për momentin nuk ka një përkufizim të unifikuar për monedhat virtuale. Agjenci dhe institucione të ndryshme ofrojnë përkufizime të ndryshme lidhur me atë se si i kuptojnë monedhat virtuale, si për shembull Banka Qendrore Evropiane², Fondi Monetar Ndërkombëtar³, Banka Botërore⁴, FATF-ja⁵ dhe institucione tjera ndërkombëtare⁶.

Në suazat e Bashkimit Evropian, monedhat virtuale përcaktohen në nenin 1, 2), d) të Direktivës (EU) 2018/843 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës të datës 30 maj 2018 që e ndryshon Direktivën (EU) 2015/849 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, dhe që i ndryshon Direktivat 2009/138/EC dhe 2013/36/EU⁷.

- 1 Doracaku Bazë për Zbulimin dhe Hetimin e Pastrimit të të Ardhurave nga Vepra Penale duke Përdorur Monedha Virtuale – UNDOC, qershor 2014, fq.7 dhe 8 https://www.imolin.org/pdf/imolin/FULL10-UNODCVirtualCurrencies_final.pdf
- 2 Banka Qendrore Evropiane “Skemat e monedhave virtuale”, tetor 2012, <https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/other/virtualcurrencyschemes201210en.pdf>
- 3 Shënim nga diskutimi i stafit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, “Monedhat virtuale dhe përtej: Konsideratat fillestare”, janar 2016, <https://www.imf.org/external/pubs/ft/sdn/2016/sdn1603.pdf>
- 4 Distributed Ledger Technology (DLT) dhe Blockchain, Shënimi nr.1 i FinTech, Grupi i Bankës Botërore, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, 2017 - <https://documents1.worldbank.org/curated/en/177911513714062215/pdf/122140-WP-PUBLIC-Distributed-Ledger-Technology-and-Blockchain-Fintech-Notes.pdf>
- 5 FATF “Monedhat virtuale – Përkufizimet kryesore dhe rreziqet e mundshme AML/CFT”, qershor 2014, <http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Virtual-currency-key-definitions-and-potential-aml-cft-risks.pdf>, Udhëzuesi i FATF për Qasjen e Bazuar në Rrezik ndaj Monedhave virtuale, qershor 2015 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Guidance-RBA-Virtual-Currencies.pdf> dhe Udhëzuesi i FATF për Qasjen e Bazuar në Rrezik, Mjetet Virtuale dhe Ofruesit e Shërbimeve të Mjeteve Virtuale, Qershor 2019 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/RBA-VA-VASPs.pdf>
- 6 Të tilla si Autoriteti Bankar Evropian, Autoriteti Evropian i Letrave me Vlerë dhe Tregjeve etj.
- 7 Kjo Direktivë njihet edhe si Direktiva e Pestë Kundër Pastrimit të Parave (AMLD5) <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32018L0843&from=EN>

II. Konceptet dhe përkufizimet

Kështu, monedha virtuale është “një përfaqësim digjital i vlerës që nuk është lëshuar ose garantuar nga një bankë qendrore ose një qeveri, e cila nuk është domosdoshmërisht e lidhur me një monedhë të përcaktuar ligjërisht dhe që nuk gëzon statusin ligjor të monedhës ose parasë, por e cila pranohet nga personat fizikë ose juridikë si mjet këmbimi dhe që mund të transferohet, ruhet dhe tregtohet në mënyrë elektronike.”

Përkufizimi i dhënë i referohet karakteristikave të përbashkëta të monedhave virtuale:

1. MV-të janë përfaqësim digjital i vlerës
Vlera në përgjithësi mund të përfaqësohet në botën fizike (p.sh. ar, pasuri e patundshme, të holla reale) si dhe në botën digjitale (të holla elektronike, monedha virtuale). Për dallim nga vlera në botën fizike, vlera në botën digjitale është virtuale, që do të thotë se nuk është e prekshme, është jo materiale dhe përbëhet thjesht nga informacioni.
2. MV-të mund të transferohen, ruhen dhe tregtohen në mënyrë elektronike
3. MV-të nuk emetohen e as nuk garantohen nga një bankë qendrore ose një qeveri dhe nuk e kanë statusin ligjor të monedhës ose parasë
Monedha virtuale dallohet nga monedha fiat (e njohur edhe si “monedhë reale”, “para reale” ose “monedhë kombëtare”), e cila është monedha dhe kartë-monedha e një vendi që është përcaktuar si mjet i ligjshëm për pagesë; që qarkullojnë; dhe zakonisht përdoren dhe pranohen si mjet këmbimi në vendin që i lëshon ato. Monedhat virtuale dallohen nga paratë elektronike, e cila është një paraqitje digjitale e monedhës fiat që përdoret për të transferuar në mënyrë elektronike vlerën e përcaktuar në monedhën fiat. Paraja elektronike në thelb është një mekanizëm i transferimit digjital për monedhën fiat – do të thotë ajo e transferon në mënyrë elektronike vlerën që ka status të mjetit të ligjshëm për pagesë.⁸ Këtu duhet të theksohet gjithashtu se termi “monedhë digjitale” ka një shtrirje më të gjerë se termi “monedhë virtuale”, pasi nënkupton përfaqësimin digjital të monedhës virtuale si një monedhë jo-fiat ose të parasë elektronike si një monedhë fiat.
4. MV-të nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me një monedhë të përcaktuar ligjërisht
5. MV-të pranohen nga personat fizikë ose juridikë si mjet këmbimi
Ky aspekt e arsyeton termin “monedha”. Përkundër faktit se monedhat virtuale nuk janë para, pasi ato nuk përfshijnë një pretendim ndaj një banke apo qeverie, ato pranohen nga përdoruesit e tyre si një mjet këmbimi dhe mund të jenë gjithashtu një njësi llogarie dhe ruajtje e vlerës.

8 Doracaku Bazë për Zbulimin dhe Hetimin e Pastrimit të të Ardhurave nga Vepra Penale duke Përdorur Monedha Virtuale – UNDOC, qershor 2014, fq. 4

Ndryshe nga përkufizimi i këtillë i dhënë në Direktivën e pestë kundër pastrimit të parave të BE (AMLD5), në rekomandimet e fundit FATF-ja ka sjellë një qasje më të gjerë, duke e pranuar konceptin e „**mjeteve (aseteve) virtuale**“ në vend të konceptit të “monedhave virtuale”. Arsyeja kryesore për zgjerimin e përkufizimit të monedhave virtuale dhe futjen e konceptit të aseteve virtuale është: 1) zhvillimi i teknologjive të reja që mundësojnë ose lejojnë transparencë të reduktuar dhe rritje të fshehjes së transaksioneve financiare, 2) shfaqja e modeleve të tjera të biznesit të aseteve virtuale ose aktiviteteve që paraqesin rrezik nga pikëpamja kriminale dhe 3) shfaqja e tipologjive të reja të financimit të paligjshëm, duke përfshirë rritjen e përdorimit të skemave piramidale virtuale-në-virtuale përmjet të cilave përpiqen t'i turbullojnë më tej transaksionet në një mënyrë relativisht të lehtë, të lirë dhe të sigurt.⁹ Kështu që, sipas definicionit të FATF set virtual është një paraqitje digjitale e vlerës që mund të tregtohet ose transferohet në mënyrë digjitale dhe mund të përdoret për qëllime pagese ose investimi. Asetet virtuale nuk përfshijnë përfaqësime digjitale të monedhave fiat, letrave me vlerë dhe aseteve të tjera financiare që tashmë janë përfshirë me të tjera në Rekomandimet e FATF-së.¹⁰

Në shikim të parë vërehet se përkufizimi AMLD5 i “monedhave virtuale” është shumë më i ngushtë se përkufizimi i FATF-së i “aseteve virtuale”.¹¹ Ai i përfshin vetëm monedhat virtuale dhe nuk përfshin lloje të tjera të krypto-aseteve, veçanërisht tokenët.

Pavarësisht nga termi i përdorur, ekzistojnë dy nënloje kryesore të monedhave virtuale: a) monedhë virtuale e konvertueshme dhe e pa konvertueshme dhe b) monedhë virtuale e centralizuar dhe e decentralizuar.

1.1. Monedha virtuale e konvertueshme dhe e pa konvertueshme

Monedha virtuale e konvertueshme (ose e hapur) ka një vlerë ekuivalente në monedhën reale dhe mund të këmbehet në të dyja drejtimet për monedhën reale. Shembujt e kësaj monedhe përfshijnë: Bitcoin; e-Gold (që nuk ekziston

9 Udhëzues për Qasjen e Bazuar në Rrezik ndaj Aseteve Virtuale dhe Ofruesve të Shërbimeve të Aseteve Virtuale i FATF-së, qershor 2019 fq. 6 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/RBA-VA-VASPs.pdf>

10 Po aty, fq. 57

11 R. HOUBEN dhe A. SNYERS, “Crypto-assets, Key developments, regulatory concerns and Respons”, Komisioni i Parlamentit Evropian për Çështjet Ekonomike dhe Monetare, Departamenti i Politikave për Politikat Ekonomike, Shkencore dhe të Cilësisë së Jetës, studimi i Drejtorisë së Përgjithshme për Politikat e Brendshme, prill 2020, fq.48 (është në dispozicion në mënyrë elektronike nëpërmjet [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU\(2020\)648779_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU(2020)648779_EN.pdf)).

II. Konceptet dhe përkufizimet

më); Liberty Reserve (që nuk ekziston më); Second Life Linden Dollars; dhe WebMoney.¹² Duhet theksuar se nocioni “monedhë e konvertueshme” nuk nënkupton në asnjë mënyrë konvertibilitet për shkak të pozitës (ex officio) (p.sh. në rastin e standardit të arit), por më tepër një konvertim de fakto (p.sh. sepse ekziston në treg). Pra, një monedhë virtuale është e “konvertueshme” vetëm për sa kohë që disa pjesëmarrës privatë bëjnë oferta dhe të tjerët i pranojnë ato, pasi “konvertueshmëria” nuk është e garantuar aspak me ligj.¹³

Monedha virtuale e pakonvertueshme (ose e mbyllur) është dedikuar të jetë specifike për një botë ose domen të caktuar virtual, si p.sh. një lojë me role në internet me shumë lojtarë (Massively Multiplayer Online Role-Playing Game - MMORPG) ose Amazon.com, dhe sipas rregullave që rregullojnë përdorimin e saj, nuk mund të shkëmbehet për monedhën fiat. Shembujt e kësaj monedhe përfshijnë: Project Entropia Dollars; Q Coins; dhe World of Warcraft Gold.¹⁴ Duhet theksuar se karakterizimi i monedhës si e pa konvertueshme nuk është domosdoshmërisht statik, pasi edhe atëherë kur, sipas kushteve të përcaktuara nga administratori, një monedhë e pa konvertueshme është zyrtarisht transferuese vetëm brenda një mjedisi specifik virtual dhe nuk është e konvertueshme, është e mundur të lindë një treg i zi jozyrtar, dytësor, i cili ofron një mundësi për të shkëmbyer monedhën virtuale “të pa konvertueshme” me monedhën fiat ose një monedhë tjetër virtuale. Në përgjithësi, administratori do të zbatojë sanksione (duke përfshirë ndërprerjen e anëtarësisë dhe/ose konfiskimin e monedhave të mbetura virtuale) ndaj atyre që kërkojnë të krijojnë ose të përdorin një treg dytësor, në kundërshtim me rregullat e monedhës. Zhvillimi i një tregu të zi të fuqishëm dytësor për një monedhë të caktuar virtuale “të pa konvertueshme”, si çështje praktike, mund ta transformojë atë në mënyrë efektive në një monedhë virtuale të konvertueshme.¹⁵

1.2. Monedha virtuale e centralizuar dhe e decentralizuar

Monedhat virtuale të centralizuara kanë një autoritet të vetëm administrues (administrator) - gjegjësisht, një palë të tretë që e kontrollon sistemin. Administratori e emeton monedhën; i vendos rregullat për përdorimin e saj; e mban librin qendror të pagesave; dhe ka autoritetin për ta shlyer monedhën (ta tërheqë atë nga qarkullimi). Kursi i këmbimit për një monedhë virtuale të konvertueshme mund të jetë ose i ndryshueshëm - p.sh., i përcaktuar nga oferta

12 Doracaku Bazë për Zbulimin dhe Hetimin e Pastrimit të të Ardhurave nga Vepra Penale duke Përdorur Monedha Virtuale – UNDOC, qershor 2014, fq. 4 dhe 5

13 Udhëzuesi për Qasje të Bazuar në Rrezik ndaj Monedhave Virtuale, qershor 2015, fq.27

14 Doracaku Bazë për Zbulimin dhe Hetimin e Pastrimit të të Ardhurave nga Vepra Penale duke Përdorur Monedha Virtuale – UNDOC, qershor 2014, fq. 4 dhe 5

15 Udhëzuesi për Qasje të Bazuar në Rrezik ndaj Monedhave Virtuale, qershor 2015, fq.27

dhe kërkesa e tregut për monedhën virtuale - ose i lidhur - gjegjësisht i fiksuar nga administratori me një vlerë të caktuar të matur në monedhën fiat ose në një mjet tjetër të botës reale që e ruan vlerën, si për shembull ari ose një shumë monedhash. Aktualisht, shumica dërrmuese e transaksioneve të pagesave në monedhë virtuale përfshijnë monedha virtuale të centralizuara. Shembuj: E-gold (më nuk ekziston); Liberty Reserve dollarë/euro (më nuk ekziston); Second Life “Linden dollars”; PerfectMoney; WebMoney “WM units”; dhe World of Warcraft gold.¹⁶

Monedhat digjitale të Bankës Qendrore (MDBQ) janë monedha digjitale që emetohen nga bankat qendrore, prandaj ato janë forma virtuale të monedhës fiat. Një MDBQ është një shënim elektronik ose shenjë (token) digjitale e monedhës zyrtare të një vendi dhe si e tillë mbështetet plotësisht nga qeveria që e emeton atë.¹⁷ MDBQ-të mund të dizajnohen në një sërë mënyrash, kështu që nuk ka një përkufizim të vetëm se çfarë është një MDBQ. Në nivelin më themelor, një MDBQ mund të përshkruhet si “vlerë monetare e ruajtur në mënyrë elektronike që përfaqëson një detyrim të Bankës Qendrore dhe mund të përdoret për të kryer pagesa”. Megjithatë, MDBQ-të nuk duhet të ngatërrohen me krypto-asetet, pasi a) përderisa krypto-asetet janë asete private, MDBQ-të janë sovrane për nga natyra dhe b) përderisa emetimi i krypto-monedhave mbështetet në përdorimin e regjistave të shpërndarë (DLT) ose teknologjisë së ngjashme, emetimi i MDBQ-ve nuk varet nga përdorimi i ndonjë teknologjie specifike.¹⁸

Monedhat virtuale të decentralizuara (të njohura si krypto-monedha) janë monedha virtuale të shpërndara, me kod të hapur, të bazuara në matematikën “peer-to-peer”, të cilat nuk kanë autoritet qendror administrues dhe nuk kanë monitorim apo mbikëqyrje qendrore. Shembuj: Bitcoin; Litecoin; dhe Ripple.¹⁹ Krypto-monedha i referohet një monedhe virtuale të konvertueshme, të decentralizuar, të bazuar në matematikë, e cila mbrohet përmes kriptografisë - gjegjësisht i përfshin parimet e kriptografisë për të zbatuar një ekonomi informacioni të shpërndarë, të decentralizuar dhe të sigurt. Krypto-monedha mbështetet në çelësat publikë dhe privatë për të transferuar vlerën nga një person (individ ose subjekt) te një tjetër dhe duhet të nënshkruhet në mënyrë kriptografike sa herë që transferohet. Siguria, integriteti dhe bilanci i regjistrave të

16 Doracaku Bazë për Zbulimin dhe Hetimin e Pastrimit të të Ardhurave nga Vepra Penale duke Përdorur Monedha Virtuale – UNDOC, qershor 2014, fq. 5

17 <https://www.investopedia.com/terms/c/central-bank-digital-currency-cbdc.asp>

18 “Crypto-assets, Key developments, regulatory concerns and responses”, Prof. Dr. Robby Houben dhe Alexander Snyers, Departamenti i Politikave për Politikat Ekonomike, Shkencore dhe të Cilësisë së Jetës, Drejtoria e Përgjithshme për Politikat e Brendshme, Parlamenti Evropian, prill 2020, fq. 27

19 Doracaku Bazë për Zbulimin dhe Hetimin e Pastrimit të të Ardhurave nga Vepra Penale duke Përdorur Monedha Virtuale – UNDOC, qershor 2014, fq. 5

II. Konceptet dhe përkufizimet

llogarisë së krypto-monedhave sigurohet nga një rrjet palësh që kanë mosbesim të ndërsjellë, të cliët mbrojnë rrjetin në këmbim të mundësisë për të përfituar një tarifë të shpërndarë rastësisht (në Bitcoin, një numër i vogël bitcoin-ësh të krijuar rishtazi, i quajtur “shpërblim blloku” dhe në disa raste, edhe tarifa e transaksionit që paguhet nga përdoruesit si një nxitje për “gërmuesit” që të përfshijnë transaksionet e tyre në bllokun e ardhshëm).²⁰

Në praktikë, shumica e monedhave virtuale që shfaqen në procedurat penale janë krypto-monedha.

2. PJESËMARRËSIT E SISTEMIT TË MONEDHËS VIRTUALE

2.1. Shpikësit dhe administratorët/emetuesit e monedhave

Shpikësit e monedhave janë individë ose organizata që krijojnë monedhë virtuale dhe zhvillojnë pjesën teknike të rrjetit.²¹ Në disa raste identiteti i tyre dihet (p.sh. Ripple, Litecoin, Cardano), por gjithnjë e më shpesh ato mbeten të paidentifikuara (p.sh. Bitcoin, Monero).²² Disa mbeten të përfshirë në ruajtjen dhe përmirësimin e kodit të krypto-monedhës dhe algoritmit themelor (në parim pa kompetencat e administratorit), ndërsa të tjerët thjesht zhduken (p.sh. Bitcoin).²³

Emetuesit janë në gjendje të prodhojnë njësi të monedhës virtuale. Varësisht nga dizajni i MV-së, vëllimi total i emetimit mund të jetë i i caktuar paraprakisht ose varet nga kërkesa. Në monedhat virtuale të centralizuara, emetuesit janë shpesh administratorë të MV-së²⁴. Administratori është një person (ose subjekt) i angazhuar si biznes në emetimin (vënien në qarkullim) të një monedhe virtuale të centralizuar, vendosjen e rregullave për përdorimin e saj; mbajtjen e regjistrit të centralizuar të pagesave; dhe ka autorizim për të shlyer (tërhequr nga qarkullimi) monedhën virtuale.

20 Udhëzuesi për Qasje të Bazuar në Rrezik ndaj Monedhave Virtuale, qershor 2015, fq.27 dhe 28

21 BQE, “Skemat e monedhave virtuale - një analizë e mëtejshme”, shkurt 2015, fq.7 <https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/other/virtualcurrencyschemesen.pdf>

22 R. HOUBEN dhe A. SNYERS, “Crypto currencies and blockchain, Legal context and implications for financial crime, money laundering and tax evasion”, Komisioni i Parlamentit Evropian për Çështjet Ekonomike dhe Monetare, Departamenti i Politikave për Politikat Ekonomike, Shkencore dhe të Cilësisë së Jetës, studimi i Drejtorisë së Përgjithshme për Politikat e Brendshme, korrik 2018, fq.28 (është në dispozicion në mënyrë elektronike nëpërmjet [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU\(2020\)648779_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU(2020)648779_EN.pdf))

23 BQE, “Skemat e monedhave virtuale - një analizë e mëtejshme”, shkurt 2015, fq.7 <https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/other/virtualcurrencyschemesen.pdf>

24 Po aty

2.2. Gërmimi dhe gërmuesit

Gërmimi është procesi i krijimit të një MV-je të re duke zgjidhur probleme të ndërlikuara matematikore duke përdorur kompjuterë me performansë të lartë. Rezultati i gërmimit është i dyfishtë. Së pari, kur kompjuterët i zgjidhin këto probleme komplekse matematikore në rrjetin e monedhës virtuale, ata prodhojnë MV të reja. Dhe së dyti, duke i zgjidhur problemet e llogaritjeve matematikore, verifikohet informacioni i transaksionit, duke mundësuar kështu një rrjet të besueshëm dhe të sigurt. Transaksioni është lëvizja e MV-së nga një llogari në tjetrën, kështu që në procesin e gërmimit bëhet verifikimi i historisë së transaksionit të mëparshëm duke verifikuar se si MV-ja ka mbërritur në adresën publike që tani e bën transferimin. Transaksionet grumbullohen së bashku në “bloqe” dhe shtohen në një regjistër publik të quajtur “blockchain”.²⁵

“Blockchain” është një sistem i ruajtjes të informacionit në një mënyrë që e bën të vështirë ose të pamundur ndryshimin, hakimin ose mashtrimin e sistemit. Është një lloj baze të dhënash, ku informatat mbledhen në grupe, të njohura edhe si blloqe. Çdo bllok në zinxhir përmban një numër transaksionesh dhe sa herë që ndodh një transaksion i ri në “blockchain”, një shënim i atij transaksioni shtohet në regjistrin e çdo pjesëmarrësi. Blloqet kanë kapacitete të caktuara të ruajtjes dhe, kur mbushen, lidhen në zinxhir me bllokun e mbushur më parë, duke formuar një zinxhir të dhënash - prej ku vjen edhe emri “blockchain”, zinxhir blloqesh.²⁶

Megjithatë, teknologjia “blockchain” mund të përdoret në një shkallë shumë më të gjerë. Me aftësinë e saj për të krijuar më shumë transparencë dhe drejtësi, duke duke kursyer kohë dhe para për bizneset, teknologjia prek një sërë sektorësh duke filluar nga mënyra se si zbatohen kontratat e deri te funksionimi më efikas i qeverisë.²⁷ Disa shembuj të përdorimit të tillë janë në fushat e mëposhtme: transferimi i parave dhe përpunimi i pagesave, monitorimi i zinxhirëve të furnizimit, programet e shitjes me pakicë të bazuara në shpërblymjet e besnikërisë, dokumentet digjitale të identifikimit (ID), shkëmbimi i të dhënave, mbrojtja e besnikërisë dhe e të drejtave të autorit, votimi digjital, transferimi i pasurive të patundshme, siguria e ushqimeve dhe kopja rezervë e pandryshueshme e të dhënave.²⁸

Subjektet që kryejnë procesin e gërmimit njihen si gërmues. **Gërmuesi** është një individ ose subjekt që merr pjesë në një rrjet të decentralizuar të monedhës

25 <https://www.investopedia.com/terms/b/bitcoin-mining.asp>

26 <https://cointelegraph.com/bitcoin-for-beginners/how-does-blockchain-work-a-beginners-guide-to-blockchain-technology>

27 <https://builtin.com/blockchain/blockchain-applications>

28 <https://www.analyticsinsight.net/real-world-applications-of-blockchain-technologies/>

II. Konceptet dhe përkufizimet

virtuale duke ekzekutuar softuer të posaçëm për të zgjidhur algoritme komplekse në një sistem të shpërndarë “proof-of-work” (prova e punës ose procesi i verifikimit të transaksionit) ose në një sistem tjetër të shpërndarë të verifikimit²⁹ që përdoret për të vërtetuar transaksionet në sistemin e monedhës virtuale.³⁰ Kur gërmuesit e MV-së shtojnë një bllok të ri transaksionesh në “blockchain”, pjesë e punës së tyre është të sigurohen që ato transaksione të jenë të sakta. Në veçanti, gërmuesit e MV-së sigurohen që MV-të të mos dyfishohen, një veçori unike e monedhave digjitale që quhet shpenzim i dyfishtë.

Transaksionet e monedhave virtuale janë teknikisht të ndryshme nga transaksionet bankare dhe nuk prodhojnë të njëjtat grupe të dhënash që i prodhojnë transaksionet bankare. Monedhat virtuale transferohen nga një adresë publike (ajo e paguesit) në një tjetër (ajo e ofruesit të shërbimit) dhe ky transaksion, pasi të vërtetohet, përfshihet në “blockchain”.

Çdo transaksion përbëhet nga:

1. Numri identifikues (ID) i transaksionit (vlera “hash”)
2. Numri i MV-ve që janë dërguar
3. Tarifa e transaksionit
4. Një ose më shumë hyrje të transaksionit (të njohura si UTXO)³¹ ose adresa(t) e dërguesit
5. Një ose më shumë rezultate të transaksionit (një ose më shumë adresa të pranuesve dhe ndoshta një ose më shumë adresa ndryshimi për kthimin e mbetjes).³²

2.3. Përdoruesi

Përdoruesi është një person/subjekt që merr monedha virtuale dhe i përdor ato për të blerë mallra ose shërbime reale ose virtuale ose për të dërguar transferime në posedim personal tek një person tjetër (për përdorim personal), ose që e mban monedhën virtuale si një investim (personal).³³

29 Ethereum ka zhvilluar një sistem tjetër të verifikimit të quajtur “proof of stake” në vend të “proof of work” - <https://ethereum.org/en/developers/docs/consensus-mechanisms/pos/>

30 FATF “Monedhat virtuale – Përkufizimet kryesore dhe rreziqet potenciale të AML/CFT”, qershor 2014, fq. 7 dhe 8 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Virtual-currency-key-definitions-and-potential-aml-cft-risks.pdf>

31 UTXO: Produkti i transaksionit të pashpenzuar. Më shumë informacion në: https://en.wikipedia.org/wiki/Unspent_transaction_output

32 “Udhëzues për sekuestrimin e krypto-monedhave”, Zyra e Programit të Krimin Kibernetik e Këshillit të Evropës, shkurt 2021, fq.13

33 FATF “Monedhat virtuale – Përkufizimet kryesore dhe rreziqet potenciale të AML/CFT”, qershor 2014, fq. 7 dhe 8 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Virtual-currency-key-definitions-and-potential-aml-cft-risks.pdf>

Përdoruesit mund të pajisen me monedhën virtuale në disa mënyra. Për shembull, ata mund (1) të blejnë monedhë virtuale, duke përdorur para reale (nga një shkëmbyes ose, për disa monedha virtuale të centralizuara, drejtpërdrejt nga administratori/emetuesi); (2) të përfshihen në aktivitete specifike që prodhojnë pagesa në monedhë virtuale (p.sh., t'i përgjigjen një promovimi, të plotësojnë një anketë në internet, të ofrojnë një mall ose shërbim real ose virtual); (3) me disa monedha virtuale të decentralizuara (p.sh., Bitcoin), të vetë-gjenerojnë njësi të monedhës duke i "gërmuar" ato dhe mund t'i marrin ato si dhurata, shpërblime ose si pjesë e një shpërndarjeje fillestare falas.³⁴ Kështu, gërmuesit mund të jenë edhe përdorues, nëse ata vetë-gjenerojnë një monedhë virtuale të konvertueshme vetëm për qëllimet e tyre, p.sh., për ta mbajtur për investime ose për ta përdorur për të paguar një detyrim ekzistues ose për të blerë mallra dhe shërbime.

2.4. Shkëmbyesi

Shkëmbyes (nganjëherë quhet edhe shkëmbim i monedhës virtuale) është një person ose subjekt që ka biznes – rol në këmbimin e monedhës virtuale për monedhën reale, fonde ose forma të tjera të monedhës virtuale, e gjithashtu edhe për metale të çmuara, dhe anasjelltas, për një tarifë të caktuar (komision). Shkëmbyesit përgjithësisht pranojnë një spektër të gjerë pagesash, duke përfshirë paratë e gatshme (kesh), transferimet, kartat e kreditit dhe monedhat e tjera virtuale dhe mund të jenë të lidhur me administratorin, të pa lidhur me të ose ofruesi i shërbimeve të jetë si palë e tretë. Shkëmbyesit mund të veprojnë si bursë ose si një zyrë shkëmbimi. Individët zakonisht përdorin shkëmbyes për të depozituar dhe tërhequr para nga llogaritë e monedhës virtuale.³⁵

Gërmuesit gjithashtu mund të marrin pjesë në një sistem të monedhës virtuale si shkëmbyes, duke krijuar monedhën virtuale si biznes në mënyrë që ta shesin atë për monedhën fiat ose ndonjë monedhë tjetër virtuale.

Duhet të theksohet se ka një ndryshim midis **platformave të shkëmbimit** të monedhave virtuale të cilat janë tregje ku përdoruesit mund të gjejnë njëri-tjetrin për të shkëmbyer MV me para tradicionale ose MV të tjera dhe anasjelltas dhe shkëmbyesve. Ka shumë ndryshime në teknologji dhe në çështjet financiare midis platformave të shkëmbimeve dhe shkëmbyesve. Por, dallimi kryesor mes tyre është fakti se kur bëhet fjalë për një shkëmbyes, ju kryeni operacione tregtare me të, ndërsa në platformat e shkëmbimeve ju blini dhe shisni krypto-monedha, jo nga vetë platform e shkëmbimit (i cili ofron vetëm qasje në tregun e tregtimit), por duke punuar me pronarët privatë të krypto-monedhës dhe aseteve fiat.³⁶

34 Po aty.

35 Po aty.

36 <https://cryptocurrencyhub.io/exchanger-vs-exchange-which-one-to-choose-73af890dea0a>

II. Konceptet dhe përkufizimet

Qëllimi kryesor i platformave të shkëmbimeve të krypto-monedhave është luajtja me çmimin e asetit, jo operacioni i shkëmbimit të një monedhe në një tjetër. Ne flasim për sinjale tregtare, të cilat i gjeneron oferta e çmimeve të aseteve tuaja. Platformat e shkëmbimeve të krypto-monedhave duhet të licencohen në vendet ku punojnë dhe këto të dhëna të detajuara të klientëve janë kërkesë për rregullatorët.³⁷ Shumicën e shërbimeve të cilat i ofrojnë platformat e shkëmbimit kërkojnë nga ju që të kaloni regjistrimin e plotë duke përfshirë edhe detaje rreth pasaportës, adresën e banimit dhe shumë më tepër. Kur bëhet fjalë për shkëmbyesit, tek disa shkëmbyes, nuk kërkohet regjistrim. Në këto raste, shkëmbyesi nuk është i interesuar për vendin tuaj të punës dhe për emrin tuaj të vërtetë – është thjesht një opsion i shpejtë dhe i lehtë për të blerë ose shitur krypto-monedhën.³⁸

Siç u përmend më herët në këtë Doracak, në përpjekje për të zgjeruar sferën e përkufizimeve ekzistuese dhe për t'i përshtatur ato me zhvillimet e reja dhe të ardhshme teknologjike, FATF miratoi përkufizimin për asetet virtuale dhe rrjedhimisht sipas asaj edhe përkufizimin për **ofruesit e shërbimit të aseteve virtuale**. Kështu, një ofrues i shërbimit të aseteve virtuale nënkupton çdo person fizik ose juridik që nuk mbulohet diku tjetër në kuadër të Rekomandimeve, dhe si biznes kryen një ose më shumë nga aktivitetet ose operacionet e mëposhtme për ose në emër të një personi tjetër fizik ose juridik:

- a. shkëmbimin ndërmjet aseteve virtuale dhe monedhave fiat;
- b. shkëmbimin ndërmjet një ose më shumë formave të aseteve virtuale;
- c. transferimin e aseteve virtuale;
- d. ruajtjen dhe/ose administrimin e aseteve virtuale apo instrumenteve që mundësojnë kontroll mbi asetet virtuale; dhe
- e. pjesëmarrjen dhe ofrimin e shërbimeve financiare në lidhje me ofertën e një emetuesi dhe/ose shitjen e një aseti virtual.

Në këtë kontekst të aseteve virtuale, transferimi nënkupton kryerjen e një transaksioni në emër të një personi tjetër fizik ose juridik që e zhvendos një aset virtual nga një adresë ose llogari të një aseti virtual në një tjetër.³⁹

Është e qartë se, duke pasur parasysh përkufizimin e dhënë më sipër, platformat e shkëmbimit konsiderohen si ofrues të shërbimeve virtuale dhe në këtë mënyrë janë të obliguara me Rekomandimet e FATF-së. Nga pikëpamja e hetimit penal, të dhënat dhe shënimet që platformat shkëmbyese si ofrues të aseteve virtuale janë të detyruar t'i mbajnë dhe t'i ruajnë sipas rekomandimeve

37 Për shembull, Coinbase (CB Payments Ltd.) është i regjistruar në Mbretërinë e Bashkuar

38 <https://cryptocurrencyhub.io/exchanger-vs-exchange-which-one-to-choose-73af890dea0a>

39 Udhëzues për Qasjen e Bazuar në Rrezik ndaj Aseteve Virtuale dhe Ofruesve të Shërbimeve të Aseteve Virtuale i FATF, qershor 2019 fq.57 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/RBA-VA-VASPs.pdf>

të FATF-së, mund të rezultojnë të jenë një mjet i vlefshëm hetimor për organet e ndjekjes.

2.5. Platformat e tregimit

Përveç shkëmbimeve të krypto-monedhave, të ashtuquajturat “platforma të tregimit” luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në shkëmbimin e krypto-monedhave (dhe, më së shumti, u mundësojnë përdoruesve të krypto-monedhave të blejnë monedha me para të gatshme).⁴⁰ Platformat e tregimit funksionojnë si tregje, duke i bashkuar blerësit dhe shitësit e monedhave virtuale, duke u ofruar atyre një platformë në të cilën ata mund të ofrojnë dhe të kërkojnë ndërmjet tyre, gjegjësisht të tregtojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin. Megjithatë, ndryshe nga shkëmbimet (bursat), platformat e tregimit nuk përfshihen në blerjen dhe shitjen e tyre. Disa platforma të tregimit, të tilla si www.localbitcoins.com, u japin klientëve të tyre mundësinë për të gjetur klientë të mundshëm në afërsi të tyre.⁴¹

2.6. Portofoli për valutat virtuale

Portofoli i monedhës virtuale është një mjet (aplikacion softuerik ose mekanizëm/medie tjetër) për mbajtjen, ruajtjen dhe transferimin e bitcoin-eve ose monedhave të tjera virtuale.⁴² Disa portofola janë ndërtuar për një krypto-monedhë të vetme, disa mund të përdoren për më shumë se një monedhë, disa portofole do t’i menaxhoni vetë dhe disa (si ato që gjenden në platformat e shkëmbimit) do të kenë një palë të tretë si kujdestar.⁴³

Çdo lloj portofoli është paksa i ndryshëm, por në përgjithësi, çdo portofol i caktuar do të funksionojë me një ose më shumë krypto-monedha dhe do të jetë në gjendje të ruajë një ose më shumë “adresa publike” që lidhen për krypto-monedha të caktuara. Përveç adresave publike, portofoli i MV-së përmban çelësat publikë dhe privatë për secilën prej adresave publike.

40 R. HOUBEN dhe A. SNYERS, “Crypto currencies and blockchain, Legal context and implications for financial crime, money laundering and tax evasion”, Komisioni i Parlamentit Evropian për Çështjet Ekonomike dhe Monetare, Departamenti i Politikave për Politikat Ekonomike, Shkencore dhe të Cilësisë së Jetës, studimi i Drejtorisë së Përgjithshme për Politikat e Brendshme, korrik 2018, fq.27 (është në dispozicion në mënyrë elektronike nëpërmjet [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU\(2020\)648779_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU(2020)648779_EN.pdf)).

41 BQE, “Skemat e monedhave virtuale - një analizë e mëtejshme”, shkurt 2015, fq.8 <https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/other/virtualcurrencyschemesen.pdf>

42 FATF “Monedhat virtuale – Përkuftizimet kryesore dhe rreziqet potenciale të AML/CFT”, qershor 2014, fq.7 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Virtual-currency-key-definitions-and-potential-aml-cft-risks.pdf>

43 <https://cryptocurrencyfacts.com/what-is-a-cryptocurrency-wallet/>

II. Konceptet dhe përkufizimet

Adresat publike (të njohura edhe si adresat e monedhës virtuale) janë si numra specifik të llogarive për monedhën virtuale; ato mund të përdoren për të marrë një lloj të caktuar të monedhës virtuale (për shembull, për të marrë Bitcoin, ju nevojitet një adresë Bitcoin) dhe mund të ndahen publikisht. Çdo adresë publike udhëzon drejt të gjitha transaksioneve të lidhura me atë adresë në “blockchain”-in. Këto adresa janë të njohura nga të gjithë përdoruesit e “blockchain”-it dhe mund të krahasohen me një numër llogarie bankare, megjithëse të gjithë mund ta shohin edhe bilancin.⁴⁴ Adresat publike janë versione “hash” të çelësve publikë.

Çelësat publikë janë kode kriptografike që u mundësojnë përdoruesve të marrin mesazhe, monedha ose tokenë dhe përdoren kryesisht për shpërndarje. Duke i dërguar këto asete me një çelës publik, ato konvertohen në një format tjetër - i cili është i palexueshëm nga njerëzit që nuk janë paraparë të jenë marrës (ata që nuk e kanë çelësin privat). Çelësat publikë shpesh vijnë në formën e vargjeve të gjata të simboleve alfa numerike.⁴⁵ Çelësi publik është krijuar për të identifikuar përdoruesin dhe për të gjeneruar adresën e monedhës virtuale të përdoruesit, duke u mundësuar përdoruesve të marrin mesazhe, monedha ose tokenë. Çelësi publik po ashtu nxirret matematikisht në mënyrë të pakthyeshme nga çelësi juaj privat (në mënyrë të pakthyeshme pasi edhe super kompjuterit më të fortë në botë do t'i duhen shume trilion vite që përmes matematikës kundërshtuese të nxjerrë çelësin privat nga çelësi publik).⁴⁶

Çelësi privat është një kod shkronjash, numrash dhe/ose simbolesh që përdoren për të iniciuar transaksionet (transferimet) e monedhës virtuale. Çelësi privat vepron si një kyç për një adresë specifike të monedhës virtuale dhe është disi i ngjashëm me fjalëkalimin e një llogarie bankare. Pronari (ose përdoruesi) i këtij çelësi ka qasje në bilancin e monedhës virtuale të lidhur me një adresë specifike të monedhës virtuale, në mënyrë që personi që posedon çelësin privat të jetë i lirë të transferojë monedhën virtuale nga adresa me të cilën është i lidhur çelësi privat në cilëndo adresë tjetër. Meqenëse çelësi privat ofron qasje në adresën e monedhës virtuale dhe mundëson që monedhat virtuale të shpenzohen, është thelbësore që çelësi privat kurrë të mos humbet apo t'i zbulohet dikujt tjetër. Personi që e mban çelësin privat, i ka në dispozicion monedhat virtuale.⁴⁷

Në thelb, çelësi privat e deshifron përmbajtjen e çelësit publik, duke i mundësuar mbajtësit të çelësit privat të ketë qasje në përmbajtjen e deshifruar. Kështu, vërtetimi se e zotëroni adresën bëhet me anë të çelësit privat në portofol pa kujdestar. Në portofolat me kujdestar, kujdestari (një palë e tretë si platformë

44 Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RrEGJKK

45 <https://paxful.com/blog/what-are-public-keys-private-keys-wallet-address/>

46 Po aty.

47 Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RrEGJKK

shkëmbimi, ndërmjetësi, etj.) e mban çelësin për ju, dhe ju duhet vetëm ta futni fjalëkalimin tuaj në aplikacionin e tyre të portofolit.⁴⁸

Në mënyrë standarde, një portofol vjen me një adresë, e cila është e ndryshme nga adresat publike, të përshkruara më sipër.⁴⁹ Portofoli ju mundëson të shikoni bilancet e lidhura me adresën dhe ju lejon t'i lëvizni fondet në “blockchain” për sa kohë që jeni pronari i adresës.

Një portofol i kripto-monedhës mund të përbëhet nga një varg adresash të ndryshme publike. Fakti që quhet portofol mund të jetë pak mashtrues, sepse në fakt nuk i mban të gjitha kartat tuaja të kreditit, ashtu siç i mban Apple Pay, për shembull. Në vend të kësaj, një portofol i kripto-monedhës është më i ngjashëm me një unazë çelësash, sepse mban një kopje të çdo çelësi privat dhe adresën e tij përkatëse. Pra, pavarësisht se a zotëroni vetëm Bitcoin, ose Ethereum, apo një mori kripto-monedhash të ndryshme, gjithçka që duhet të bëni është të hapni portofolin tuaj për të fituar qasje në të gjitha adresat e ndryshme që gjenden brenda tij.⁵⁰

Ka mënyra të ndryshme për të hyrë në portofolin tuaj të kripto-monedhës: duke përdorur një kompjuter desktop, një shfletues ose duke përdorur një portofol fizik. Të njohura ndryshe si “ruajtje e ftohtë”, portofolat fizike janë më të sigurta sepse janë offline (nuk janë të lidhura në internet) dhe janë më pak të ndjeshme ndaj hakimeve. Portofolat në ueb dhe celular/desktop quhen gjithashtu portofola online ose të nxehta.

Portofoli në ueb do të thotë se qasja në MV (çelësi privat - adresa publike) rruhet online te një ofrues i caktuar i shërbimeve. Avantazhi është se kjo MV është menjëherë në dispozicion për përdoruesit. Disavantazhi është se nëse dikush fiton qasje të paligjshme në sistemin e ofruesit të shërbimit, ai ose ajo gjithashtu ka qasje në MV. Përveç kësaj, ekziston gjithashtu mundësia që një ofrues shërbimi mashtrues t'i përvetësojë MV-të e klientëve.⁵¹ Një lloj specifik i portofolit në ueb është “dark wallet”, i cili është një portofol i bazuar në shtesën që i instalohet shfletuesit, që kërkon të sigurojë anonimitetin e transaksioneve të Bitcoin duke përfshirë veçoritë e mëposhtme: auto-anonimizues (përzierës); tregti e decentralizuar; platforma të pa censuruar për finansimim nga grup njerëzish (crowd funding); platforma të aksioneve dhe tregje të zeza të informacionit; dhe tregje të decentralizuara.⁵²

48 <https://cryptocurrencyfacts.com/what-is-a-cryptocurrency-wallet/>

49 Për më shumë informacion mund të shihni <https://medium.com/hackernoon/crypto-wallet-vs-address-54f7fb980bd3>

50 <https://thenextweb.com/news/the-differences-between-a-bitcoin-wallet-and-an-address>

51 Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RrEGJKK

52 FATF “Monedhat virtuale – Përkufizimet kryesore dhe rreziqet potenciale të AML/CFT”, qershor 2014, fq. 7 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Virtual-currency-key-definitions-and-potential-aml-cft-risks.pdf>

II. Konceptet dhe përkufizimet

Portofoli celular ose desktop do të thotë se qasja në MV (çelësi privat - adresa publike) ruhet në sistemin e përdoruesit (smartfon/tabletë ose kompjuter desktop, respektivisht) nëpërmjet një aplikacioni ose programi, pavarësisht nëse është i mbrojtur ose jo me një fjalëkalim.⁵³

Portofolat fizike nënkuptojnë se qasja në MV nuk është e disponueshme në internet. Kjo ka avantazh, për arsye se MV-ja është e sigurt nga hakerët e mundshëm, por nga ana tjetër ka një rrezik në rritje për humbje të tyre nëse operatori fizik në të cilin janë ruajtur këta çelësa humbet ose vidhet. Një shembull i një sistemi të tillë është **portofoli harduerik**, ku çelësat privatë gjenden në një pajisje të veçantë.⁵⁴

Ekziston edhe **portofol prej letre**, ku adresa publike dhe çelësi privat janë në dispozicion në një medie prej letre. Kjo medie mund të kopjohet lehtësisht, ashtu që kushdo që e ka atë mund të hyjë në MV në adresën publike në fjalë. Megjithatë, ndonjëherë çelësi privat shtypet i koduar. Në atë rast, çelësi privat duhet së pari të bëhet i lexueshëm me një çelës të veçantë.⁵⁵

Njohja e llojit të portofolit konkret do të përcaktojë se si mund të fitohet qasja në MV. Këtu duhet theksuar se çelësi privat, i diskutuar më sipër, nuk përdoret për të hyrë në portofol, por për të hyrë në një adresë të monedhës virtuale që ruhet në portofol.

2.7. Ofruesi i portofolit

Ofruesi i portofolit është një subjekt që ofron portofol të monedhës virtuale gjegjësisht mjet - aplikacion softuerik ose mekanizëm/medie tjetër për mbajtjen, ruajtjen dhe transferimin e bitcoin-ëve ose monedhave të tjera virtuale).⁵⁶ Thënë thjesht, një portofol i mban çelësat privatë të përdoruesit të monedhës virtuale. Një ofrues i portofolit zakonisht e shndërron historinë e transaksioneve të një përdoruesi të monedhës virtuale në një format lehtësisht të lexueshëm, i cili duket shumë si një llogari e zakonshme bankare.⁵⁷ Ai gjithashtu ruan bilancin e

53 Po aty.

54 Po aty.

55 Po aty.

56 FATF "Monedhat virtuale – Përkufizimet kryesore dhe rreziqet potenciale të AML/CFT", qershor 2014, fq. 7 dhe 8 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Virtual-currency-key-definitions-and-potential-aml-cft-risks.pdf>

57 R. HOUBEN dhe A. SNYERS, "Crypto currencies and blockchain, Legal context and implications for financial crime, money laundering and tax evasion", Komisioni i Parlamentit Evropian për Çështjet Ekonomike dhe Monetare, Departamenti i Politikave për Politikën Ekonomike, Shkencore dhe të Cilësisë së Jetës, studimi i Drejtorisë së Përgjithshme për Politikën e Brendshme, korrik 2018, fq.27 (është në dispozicion në mënyrë elektronike nëpërmjet [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU\(2020\)648779_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU(2020)648779_EN.pdf)).

monedhës virtuale të përdoruesit dhe në përgjithësi ofron ruajtjen dhe sigurinë e transaksioneve.⁵⁸

Duke pasur parasysh se ekzistojnë lloje të ndryshme të portofolave, siç u shpjegua më lart, në realitet ekzistojnë disa lloje ofruesish të portofolave:

- Ofruesit e portofolit harduerik që u ofrojnë përdoruesve të kriptomonedhave zgjidhje specifike harduerike për t'i ruajtur privatisht çelësat e tyre kriptografikë (p.sh. Ledger Wallet, ...);
- Ofruesit e portofolit softuerik që u ofrojnë përdoruesve të kriptomonedhave aplikacione softuerike që u mundësojnë atyre të hyjnë në rrjet, të dërgojnë dhe të marrin monedha dhe t'i ruajnë në nivel lokal çelësat e tyre kriptografikë (p.sh. Jaxx);
- Ofruesit e portofolit me kujdestar që i marrin në dorëzim (online) çelësat kriptografikë të një përdoruesi të kripto-monedhës (p.sh. Coinbase).⁵⁹

Ofruesit e portofolit, si shkëmbimet (bursat), bien nën përkufizimin e FATF-së për ofruesit e shërbimeve virtuale.

2.8. Fara

Tek monedhat virtuale, fara e rikuperimit, ose shkurt fara (seed), është një listë fjalësh në një renditje specifike që e ruan të gjithë informacionin e nevojshëm për të rikuperuar qasjen tek një portofol të monedhës virtuale. Zakonisht, fara është një listë fjalësh të krijuara në mënyrë të rastësishme, zakonisht e përbërë nga 10 deri në 24 fjalë. Me farën e rikuperimit mund të hyni në portofol dhe të rikuperoni çelësat privatë dhe publikë që gjenden në portofol. Mbajtja private dhe e sigurt e farës së rikuperimit është kyçe për sigurinë afatgjatë të fondeve të monedhës virtuale të përdoruesit. Kështu, fara mund të ruhet në formë të shkruar ose të printuar ose në lloje të ndryshme skedarësh elektronikë (tekst, pdf, fotografi) në kompjuterin ose pajisjen elektronike të përdoruesit.⁶⁰

58 FATF "Monedhat virtuale – Përkufizimet kryesore dhe rreziqet potenciale të AML/CFT", qershor 2014, fq. 7 dhe 8 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Virtual-currency-key-definitions-and-potential-aml-cft-risks.pdf>.

59 R. HOUBEN dhe A. SNYERS, "Crypto currencies and blockchain, Legal context and implications for financial crime, money laundering and tax evasion", Komisioni i Parlamentit Evropian për Çështjet Ekonomike dhe Monetare, Departamenti i Politikave për Politikat Ekonomike, Shkencore dhe të Cilësisë së Jetës, studimi i Drejtorisë së Përgjithshme për Politikat e Brendshme, korrik 2018, fq.27 (është në dispozicion në mënyrë elektronike nëpërmjet [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU\(2020\)648779_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU(2020)648779_EN.pdf)).

60 Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RREGJKK

II. Konceptet dhe përkufizimet

2.9. Mundësuesit e pagesave

Mundësuesit e pagesave ofrojnë mundësinë për të paguar me MV për të blerë produkte ose mund ta ofrojnë shërbimin për të konvertuar MV-në në një monedhë tjetër dhe më pas të realizojnë pagesën tek shitësit (online). Ata shumë shpesh i mbajnë të gjitha të dhënat e përfshira.⁶¹

Mundësuesit e pagesave njësor si platformat e shkëmbimit, dhe ofruesit e portofolit, bien nën përkufizimin e FATF-së për ofruesit e shërbimeve virtuale

2.10. Anonimizuesi (mjete anonimizes)

Anonimizuesi i referohet mjeteve dhe shërbimeve, të tilla si darknet-et dhe përzierësit, të krijuar për ta fshehur burimin e një transaksioni të MV-së dhe për ta lehtësuar anonimitetin. (Shembuj: Tor (darknet); portofol i errët (darknet); Bitcoin Laundry (përzierës)).⁶²

2.11. Përzierësit dhe “tumblers”

Për shkak të teknologjisë “blockchain”, kripto-monedhat paraqesin një regjistër të dukshëm publik të të gjitha transaksioneve ku të gjitha rrjedhat e parave janë gjurmuese. Përzierësit dhe “tumblers” janë krijuar për të rritur anonimitetin dhe për t’u mundësuar përdoruesve ta rivendosin privatësinë e tyre financiare kur përdorin kripto-monedha.

Një përzierës (ose tumbler) është çdo shërbim që mundëson përzierjen e kripto-monedhave asetet dhe tokenet me qëllimpër të fshehur gjurmët e origjinës së tyre. Pronari i kripto-monedhës i transferon paratë në shërbimin e përzierjes, i cili i përzie ato me paratë e përdoruesve të tjerë dhe e transferon monedhën e përzier në adresën e dëshiruar, që do të thotë se nuk ka asnjë lidhje midis transaksionit origjinal dhe kësaj adrese.

Një përzierës ose “tumbler” i dërgon transaksionet përmes një serie komplekse, gjysmë të rastësishme të transaksioneve bedel që e bën jashtëzakonisht të vështirë lidhjen e monedhave (adresave) specifike virtuale me një transaksion të caktuar. Shërbimet e përzierjes funksionojnë duke marrë udhëzime nga një përdorues për të dërguar fonde në një adresë të veçantë bitcoin-i. Shërbimi i përzierjes më pas e “përzie” këtë transaksion me transaksionet e tjera të përdoruesve, në mënyrë që të bëhet e paqartë se kujt ka dashur t’ia dërgojë përdoruesi fondet. (Shembuj: Bitmixer.io; SharedCoin; Blockchain.info; Bitcoin Laundry; Bitlaunder; Easycoin).⁶³

61 Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RREGJJK

62 FATF “Monedhat virtuale – Përkufizimet kryesore dhe rreziqet potenciale të AML/CFT”, qershor 2014, fq. 6

63 Po aty.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të zgjidhjeve kur bëhet fjalë për përzierësit. Përzierësit e centralizuar janë shërbime në pronësi private që e pranojnë monedhën tuaj dhe kthejnë prapa monedha të ndryshme për një tarifë të caktuar.⁶⁴ Nëse shumë njerëz përdorin një shërbim të veçantë të përzierjes, bëhet gjithnjë e më e vështirë për një të huaj që të lidhë ndonjë nga monedhat “hyrëse” me ndonjë nga monedhat “dalëse”. Kjo i thyen gjurmët e transaksionit, duke ofruar privatësi për përdoruesit.⁶⁵

Përzierësit e centralizuar kanë qasje në adresat tuaja të Bitcoin-it dhe adresat tuaja IP. Ata në fund të fundit e dinë se cila adresë i dërgoi dhe i mori cilat monedha dhe ruajnë shënime dhe të dhëna. Nga këndvështrimi ligjor, informatat e tilla mund të kërkohen nga një përzierës.⁶⁶ Megjithatë, duhet të theksohet se disa platforma të centralizuara të përzierësve si BitcoinMix.org nuk mbajnë regjistra ose nuk mbledhin të dhëna personale rreth përdoruesit dhe janë plotësisht të automatizuara.

Përzierësit e decentralizuar janë shërbime të përzierjes “peer-to-peer” që janë në dispozicion në platforma më të avancuara të “blockchain”. Këta përzierës përpiqen t’i rregullojnë mangësitë e përzierjes së centralizuar. Individët bashkohen dhe i bashkojnë monedhat e tyre për të bërë një transaksion të rëndësishëm dhe monedhat u kthehen në mënyrë të rastësishme të gjithë anëtarëve që kanë marrë pjesë në grup. Sa më i madh të jetë numri i përdoruesve në grup, aq më e madhe është rastësia. Përzierësit më të njohur pa kujdestar përfshijnë Wasabi Wallet dhe Samourai Whirlpool.⁶⁷ Protokollin më të zakonshëm të cilën e përdorin përzierësit e decentralizuar njihet si CoinJoin. CoinJoin synon të përmirësojë privatësinë duke i koordinuar hyrjet e përdoruesve të shumtë në një transaksion të vetëm. Transaksioni merr rezultate të shumta që e fshehin origjinën e monedhave. Megjithatë, disa CoinJoin protokolle kanë modele që mund të dallohen me lehtësi në udhëzues në “blockchain” dhe shërbimet që ofrojnë analizë të “Blockchain” mund të deanonimizojnë një dërgues që ka përdorur CoinJoin.⁶⁸

64 <https://en.cryptonomist.ch/2020/08/15/bitcoin-mixers-centralized-decentralized/>

65 <https://bitcoinmagazine.com/guides/what-are-bitcoin-mixers>

66 Të gjitha ndërveprimet e kryera përmes platformës për përzierje mund të merren nga agjencitë e zbatimit të ligjit si adresat IP, detajet e transaksionit, adresat e bitcoin-it dhe mesazhet e bisedës. Një shembull i tillë ishte ndalesa e një prej shërbimeve udhëheqëse në botë për përzierjen e krypto-monedhave Bestmixer.io. Më shumë në: <https://www.europoL.europa.eu/newsroom/news/multi-million-euro-cryptocurrency-laundering-service-bestmixer-io-taken-down> Duhet theksuar se në SHBA përzierësi mund të mbahet përgjegjës për mundësimin e pastrimit të parave. Një shembull i tillë është rasti i përzierësit Helix. Më shumë në: <https://www.justice.gov/opa/pr/ohio-resident-pleads-guilty-operating-darknet-based-bitcoin-mixer-laundered-over-300-million>

67 Përzierësit pa kujdestar janë mjete softuerike të hostuara nga përdoruesi, e jo shërbime të palëve të treta që marrin kujdestarinë e fondeve të përdoruesit, ku shërbimet e përzierësit janë pjesë e portofolit.

68 <https://en.cryptonomist.ch/2020/08/15/bitcoin-mixers-centralized-decentralized/>

II. Konceptet dhe përkufizimet

2.12. Tor

Tor, që është shkurtesa për “The Onion Router” është një rrjet i shpërndarë nëntokësor i kompjuterëve në internet që i fsheh adresat e vërteta IP, dhe për rrjedhojë edhe identitetet e përdoruesve të rrjetit, duke i drejtuar komunikimet/transaksionet përmes kompjuterëve të shumtë në mbarë botën dhe duke i mbështjellë ato në shtresa të shumta të enkriptimit. Tor e bën shumë të vështirë gjetjen fizike të kompjuterëve që hostojnë ose qasen në ueb-faqet në rrjet. Kjo vështirësi mund të përkeqësohet nga përdorimi i “tumblers” ose i anonimizuesve shtesë në rrjetin Tor. Tor është një nga disa rrjete kompjuterike të shpërndara nëntokësore, shpesh të emërtuara si darknets, cypherspace, Deep web ose rrjete anonime, të cilat individët i përdorin për të hyrë në përmbajtje në një mënyrë të krijuar për ta fshehur identitetin e tyre dhe aktivitetin e lidhur në internet.⁶⁹

2.13. VPN

Një rrjet privat virtual (VPN) ju jep privatësi dhe anonimitet online duke krijuar një rrjet privat nga një lidhje publike në internet. VPN-të e maskojnë adresën tuaj të protokollit të internetit (IP) në mënyrë që veprimet tuaja në internet janë praktikisht të pagjurmueshme. Më e rëndësishmja, shërbimet VPN krijojnë lidhje të sigurta dhe të enkriptuara për të ofruar privatësi më të madhe se sa edhe një pikë e sigurt (hot-spot) Wi-Fi.⁷⁰

2.14. Bitcoin

Bitcoin-i ishte monedha e parë virtuale e konvertueshme e decentralizuar dhe kriptomonedha e parë. Bitcoin-et janë njësi llogarie të përbëra nga vargje unike numrash dhe shkronjash që përbëjnë njësi të monedhës dhe kanë vlerë vetëm për faktin se përdoruesit individualë janë të gatshëm të paguajnë për to. Bitcoin-et tregtohen në mënyrë digjitale midis përdoruesve me një shkallë të lartë anonimiteti dhe mund të shkëmbehen (të blihen ose të arkëtohen) në çdo monedhë fiat ose virtuale.⁷¹

69 FATF “Monedhat virtuale – Përkufizimet kryesore dhe rreziqet potenciale të AML/CFT”, qershor 2014, fq. 6

70 <https://us.norton.com/internetsecurity-privacy-what-is-a-vpn.html>

71 FATF “Monedhat virtuale – Përkufizimet kryesore dhe rreziqet potenciale të AML/CFT”, qershor 2014, fq. 5 dhe 6 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Virtual-currency-key-definitions-and-potential-aml-cft-risks.pdf>

2.15. Altcoin

Altcoin (alternative coins - monedha alternative) është një term që përdoret për të përshkruar të gjitha monedhat virtuale të konvertueshme të decentralizuara të bazuara në matematikë, përveç Bitcoin-it. Emri i tyre vjen nga fakti se ato janë alternativa ndaj Bitcoin-it dhe parave tradicionale fiat. Në varësi të funksionaliteteve të tyre dhe mekanizmave të konsensusit, altcoin-ët mund të renditen në kategori të ndryshme. Duhet të theksohet se është e mundur që një altcoin të bjerë në më shumë se një kategori. Llojet kryesore të altcoin-ëve përfshijnë kripto-monedha të bazuara në gjermim, stablecoins (kripto-monedha, çmimi i të cilave është i lidhur për asete rezerve “stabile”), tokene të sigurisë dhe tokene të shërbimeve.⁷²

Duhet të theksohet se ekziston një dallim midis kripto-monedhave dhe tokenëve. Tokenët janë ato kripto-asete që u ofrojnë zotëruesve të tyre të drejta të caktuara ekonomike dhe/ose të qeverisjes dhe/ose të shërbimeve/konsumit. Në përgjithësi, ato janë përfaqësime digjitale të interesave, ose të drejta për (të pasur qasje) në asete, produkte ose shërbime të caktuara. Tokenët zakonisht emetohen në një platformë ekzistuese ose “blockchain” për të mbledhur kapital për projekte të reja sipërmarrëse, ose për të financuar kompani fillestare (start-up) ose për zhvillimin e shërbimeve të reja (teknologjikisht) inovative.⁷³

2.15.1 Kripto-monedhat e bazuara në gjermim

Siç tregon emri i tyre, altcoin-ët e bazuar në gjermim gjenerohen duke gjermuar. Gjermuesit zgjidhin enigma komplekse matematikore që njëkohësisht të verifikojnë transaksionet, të krijojnë blloqe dhe të gjermojnë monedha të reja. Shumica e altcoin-ëve të bazuar në gjermim përdorin metodën Proof-of-Work (PoW) - provë e punës, një metodë në të cilën sistemet gjenerojnë monedha të reja duke zgjidhur probleme të vështira, me qëllim që të krijojnë blloqe. Lista kryesore e Altcoin-ëve të bazuara në gjermim përfshin Litecoin (LTC), Monero (XMR), Ethereum Classic (ETC) dhe DASH.⁷⁴

Alternativë e altcoin-ëve që bazohen në gjermim janë alkoinet të cilat përmbajnë monedhat të krijuara më parë. Monedhat e tilla nuk prodhohen përmes një algoritmi, por shpërndahen përpara se të shfaqen në tregun e kripto-monedhave. Një shembull i një monedhe të krijuar paraprakisht është XRP e Ripple.

72 <https://www.investopedia.com/terms/a/altcoin.asp>

73 “Crypto-assets, Key developments, regulatory concerns and responses”, Prof. Dr. Robby Houben dhe Alexander Snyers, Departamenti i Politikave për Politikat Ekonomike, Shkencore dhe të Cilësisë së Jetës, Drejtoria e Përgjithshme për Politikat e Brendshme, Parlamenti Evropian, prill 2020, fq. 18

74 <https://www.investopedia.com/terms/a/altcoin.asp>

II. Konceptet dhe përkufizimet

2.15.2 Monedhat stabile

Monedhat stabile janë monedha që janë të lidhura për një bashkësi të mirash, të tilla si monedhat fiat, metalet e çmuara, mallrat që tregtohen në bursë, letrat me vlerë ose kripto-monedha të tjera. Kjo bashkësi të mirash ka për qëllim të veprojë si një rezervë për t'i dëmshpërblyer poseduesit nëse kripto-monedha dështon ose përballet me probleme.

Monedhat stabile kanë paqëndrueshmëri të ulët të çmimeve, pasi vlera e tyre varet nga të mirat e jetës reale dhe luhatjet e çmimeve të monedhave stabile nuk duhet të tejkalojnë një rreth të ngushtë. Kështu, këto monedha sigurojnë stabilitet për sa i përket çmimit, gjë që i bën ato një opsion perfekt për tregtimin e kripto-monedhave.

Përderisa Tether (USDT) është stablecoin-i më i përdorur, monedha të tjera alternative në këtë kategori janë USDCoin (USDC), Maker (MKR) dhe DAI.

2.15.3. Tokenët e sigurisë

Tokenët e sigurisë janë të ngjashëm me letrat me vlerë të tregtuara në bursa, përveçse ato kanë origjinë digjitale. Këto monedha alternative veprojnë si letra me vlerë financiare digjitale të cilat investitorët mund t'i marrin përmes ofertave fillestare të monedhave (ICO). Duke investuar në to, poseduesit e tokenëve gëzojnë të drejtë për të votuar, për dividendë, për rritje të vlerës dhe për pjesë të pronësisë në kompani. Duhet të theksohet se këto monedha digjitale përputhen plotësisht me rregulloret e qeverive. Kështu, duke pasur parasysh perspektivën e rritjes së çmimit së një tokeni të tillë dhe karakteristikat e tyre, investitorët institucionalë besojnë dhe investojnë në këto tokenë.

Shembujt e tokenëve të sigurisë përfshijnë ASPD, EXOD, OSTKO dhe TZROP.

2.15.4 Tokenët e shërbimeve

Këto monedha alternative nuk janë për qëllime investimi, por u mundësojnë poseduesve të tokenit të blejnë produkte dhe shërbime ose të marrin shpërblime brenda një platforme të caktuar. Ndryshe nga tokenët e sigurisë, tokenët e shërbimeve nuk paguajnë dividendë ose nuk marrin pjesë në një pjesë të pronësisë, por u japin përdoruesve të drejtën për të votuar dhe të japin informata shtesë për produktet që ata i përdorin duke marrë pjesë në ekosistemin përkatës të "blockchain"-it. Filecoin, i cili përdoret për të blerë hapësirën e ruajtjes (storage space) në një rrjet, është shembull i një tokeni të shërbimeve.

3. Si zbatohet në praktikë koncepti i monedhave virtuale

Ka shumë udhëzime dhe grafikë që e shpjegojnë në detaje aspektin teknik se si koncepti i monedhave virtuale zbatohet në praktikë.⁷⁵

Megjithatë, duke pasur parasysh fokusin e këtij doracaku, në vazhdim do të fokusohemi vetëm në rolin e tyre në procedurat penale.

75 Një shembull i tillë është dhënë në grafik dhe mund të lexoni më shumë në Udhëzuesin e FATF-së për Qasjen e Bazuar në Rrezik ndaj Monedhave Virtuale, qershor 2015, fq.39 https://thumbnails-visually.netdna-ssl.com/bitcoin-infographic_5029189c9cbaf.jpg

III. Rëndësia e monedhave virtuale në procedurat penale

Nga pikëpamja e procedurave penale, monedhat virtuale mund të jenë mjete të përdorura për dhe mjete të dalura nga kryerja e një veprë penale, ato mund të jenë ndonjë pronë e fituar nga kryerja e veprës penale dhe mund të përdoren si provë.⁷⁶ Në cilindo nga këto raste, organet e ndjekjes fillimisht duhet t'i zbulojnë dhe më pas t'i sigurojnë monedhat virtuale. Rrjedhimisht, autoritetet e zbatimit të ligjit duhet të kenë njohuri dhe kuptim specifik mbi procesin e zbulimit dhe më pas procesit të vendosjes së kontrollit mbi MV-të.

Për qasje dhe kontroll në MV duhet patjetër posedimi i çelësit/adresës publike dhe çelësi privat përkatës. Pasi të keni siguruar këta, MV-të mund të sekuestrohen nga i dyshuari. Sekuestrimi është i plotë vetëm atëherë kur MV-ja është transferuar në një adresë tjetër, e cila nuk është nën kontrollin e të dyshuarit ose bashkëpunëtorëve të tij.⁷⁷

1. ZBULIMI I MONEDHAVE VIRTUALE NË PROCEDURAT PENALE DHE MARRJA E INFORMACIONIT DHE PROVAVE PËRKATËSE

Zbulimi i pranisë dhe i përdorimit të monedhave virtuale në procedurat penale është hapi i parë që duhet ta bëjnë autoritetet e zbatimit të ligjit. Por, pyetja kryesore është se çfarë duhet të kërkoni konkretisht?

Duke pasur parasysh se si funksionon teknologjia pas monedhave virtuale, **pajisjet për gjurmim, adresat/çelësat publikë të monedhës virtuale**, si dhe **çelësat privatë dhe listat ku janë shënuar fjalët e farës** janë me interes për autoritetet e zbatimit të ligjit. Kur bëhet fjalë për adresat publike, duhet theksuar se gjithashtu adresat publike mund të kontrollohen në çdo kohë edhe përmes burimeve të hapura.

Siç u shpjegua më lart, çelësat/adresat publike dhe private mund të gjenden në **portofolin** e monedhës virtuale të një personi. Duke pasur parasysh këtë, një

76 P.sh. siç u shpjegua në kapitullin e mëparshëm, ka MV që punojnë në teknologjinë "blockchain". Kjo teknologji përmban shumë informacione që në procedurat penale mund të përdoren si provë (p.sh. informacion në lidhje me transaksionet e mëparshme).

77 Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RREGJKK

nga informacionet kryesore që hetimi duhet të synojë të zbulojë është pamja e mundshme e një portofoli. Gjithashtu, duhet theksuar se disa portofola mund të mbrohen me PIN-e, kështu që përveç portofolit, kërkimi i **fjalëkalimeve dhe PIN-eve** është gjithashtu një domosdoshmëri. Nuk duhet të anashkalohen as **kodet QR**, ku mund të ruhen fjalëkalimet.

Ka aktivitete të ndryshme hetimore që mund të kryhen për të gjetur provat e nevojshme, siç janë bastisjet (bastisje e shtëpisë/lokalit, personave ose e sistemit kompjuterik), marrja në pyetje e të dyshuarit dhe e dëshmitarëve ose kryerja e hetimeve online.

Para kryerjes së ndonjë aktiviteti hetimor duhet të bëhet një planifikim i duhur hetimor dhe duhet të zhvillohet strategjia hetimore. Për shembull, fjalëkalimet ose PIN-et mund të gjenden në vende të ndryshme si p.sh. ndër tastierë, në një copë letre, në një agjendë, etj., prandaj është e rëndësishme të merret një urdhër për bastisje që do të mundësojë sekuestrimin e fjalëkalimeve, PIN-eve etj. së bashku me median ku janë ruajtur.

Qasja në kripto-monedha nëpërmjet çelësit(ave) privat(ë) ose një fraze (kombinim i shenjave) të farës mund të gjendet në vend, p.sh., në një kompjuter desktop (gjegjesisht në një portofol pa kujdestar siç është Electrum) ose mund të ruhet diku në internet në një portofol me kujdestar në juridiksionin e njëjtë ose ndonjë juridiksion tjetër.⁷⁸ Kështu, duke qenë se portofolat shfaqen në forma të ndryshme, është e nevojshme që organet e zbatimit të ligjit ta njohin llojin e portofolit në fjalë. Lloji i portofolit do të ndikojë në vendimin se çfarë veprimtarie hetimore duhet të kryhet në një rast konkret.⁷⁹ Kështu mund të ndodhë që kontrolli fillestar në një procedurë penale të japë informacion për ekzistencën dhe llojin e portofolit dhe mbi bazën e këtij informacioni mund të pasojnë aktivitete shtesë hetimore. Ndonjëherë, indikacionet se cilat monedha virtuale i përdor një i dyshuar mund të merren paraprakisht përmes një hetimi tashmë të nisur. Duke pasur parasysh këtë, është thelbësore që të vendoset një komunikim i mirë ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve të organeve të zbatimit të ligjit për të shmangur ose zvogëluar mundësinë e shkatërrimit të provave ose zhvendosjes së monedhave virtuale përpara se ato të sigurohen zyrtarisht.

78 “Udhëzues për sekuestrimin e kripto-monedhave”, Zyra e Programit të Krimin Kibernetik e Këshillit të Evropës, shkurt 2021, fq.21

79 Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RREGJKK përmban një përmbledhje grafike të aktiviteteve hetimore që mund të kryhen në varësi të llojit të portofolit dhe në varësi të faktit nëse portofoli është në pajisjen e personit të shënjestruar ose jo, duke marrë parasysh faktin se a është pajisja e lidhur në internet (online) ose jo (offline). Për shembull, në rast se në celularin e të dyshuarit gjendet një portofol celular dhe celulari është online, aktivitetet hetimore që janë në dispozicion janë kërkimi në kompjuter si dhe kërkimi në rrjet. Megjithatë, nëse gjendet një portofol letre që nuk ndodhet në asnjë pajisje të personit të shënjestruar dhe ai nuk është ruajtur në internet, atëherë sekuestrimi i përkohshëm është aktiviteti i duhur hetimor për marrjen e këtij portofoli.

III. Rëndësia e monedhave virtuale në procedurat penale

Informacioni përkatës lidhur me monedhat virtuale në një procedurë penale mund të merret nga një shkëmbyes ose platformë shkëmbimi. Këta subjekte mund të ruajnë: emrin; informacionin bazë të abonuesit (parapaguesit), duke përfshirë adresën IP; detajet e verifikuara të kontaktit; shënimet për aktivitetet; regjistrat e IP adresave; adresat e MV-së; mesazhet personale; informacionin e pagesës; një dëshmi të identifikimit, adresën e shtëpisë (pasaportën, dokumentin kombëtar të identifikimit, lejen e vozitjes...) etj. Ata gjithashtu mund të ngrijnë/sekuestrojnë MV-të në bazë të kërkesës.⁸⁰ Megjithatë, vështirësia këtu është se shkëmbyesit ose platformat shkëmbyese zakonisht ndodhen në juridiksione të huaja, kështu që për marrjen e informacionit mund të ketë nevojë për dërgimin e kërkesës për Ndhimë Ndërkombëtare Juridike (NNJ). Duhet theksuar se në disa raste, shkëmbyesit e veçanërisht platformat e shkëmbimit bashkëpunojnë drejtpërdrejt vullnetarisht me autoritetet e zbatimit të ligjit.⁸¹ Duhet të theksohet gjithashtu se bashkëpunimi duhet të vendoset vetëm me shkëmbyes dhe platforma shkëmbimi të besuara. Shkëmbyesit dhe platformat e shkëmbimit përdoren shpesh për pastrim parash, ndonjëherë janë mashtrim në vetvete ose kanë një politikë për ta paralajmëruar klientin e tyre se organet e zbatimit të ligjit po pyesin për ta. Prandaj, është e nevojshme të posedoni informatat përkatëse (nga njësia e specializuar e policisë ose Europoli) përpara se të kërkonit të dhëna mbi shkëmbyesin ose platformën e shkëmbimit.⁸² Duhet të theksohet se Europoli ka publikuar një listë të kontakteve të platformave të shkëmbimit të kriptomonedhave dhe subjekteve të tjera që veprojnë në përputhje me ligjin dhe se kjo listë është në dispozicion për organet e zbatimit të ligjit dhe organet gjyqësore.

Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RrEGJKK ofron shembull praktik se çfarë informacioni mund të kërkohe nga një shkëmbyes ose platformë shkëmbimi. Prandaj, rekomandohet fuqimisht që ky udhëzues të konsultohet në rastet e procedurave penale ku na paraqiten monedhat virtuale.

Shtojca I e këtij Doracaku përmban shembullin e një shablloni të kërkesës për të dhëna të ofruesit të shërbimit (shkëmbyes ose platformë shkëmbimi), ku janë përshkruar në hollësi llojet e informacionit që mund të merren nga këta subjekte.

80 Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RrEGJKK

81 Disa shkëmbime kriptomonedhash, si Binance, kanë ofruar formularë për të kërkuar ndihmë (kërkesa për informacion) nga organet e zbatimit të ligjit - <https://www.binance.com/en/support/law-enforcement>

82 Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RrEGJKK

Gjithashtu, ka pika dalje fizike (makineri/aparatura) që ofrojnë shërbime të arkëtimit ose tregtimit të MV-ve. Jo vetëm që nga ofruesit e shërbimit mund të kërkohet informacioni i disponueshëm në lidhje me një transaksion të caktuar ose një adresë të caktuar të MV-së, por në raste të tilla gjithashtu ekziston mundësia për sigurimin e dëshmive të cilat gjenden fare pranë pikës fizike të daljes (makinerisë, përkatësisht aparatit për tërheqjen e parave të gatshme ose për tregtim), siç janë provat nga kamerat e vëzhgimit (CCTV) që ndodhen në lagje ose janë vendosur në vetë pikën e daljes. Një paraqitje globale e pikëve të disponueshme të daljes mund të gjendet në <https://coinatmradar.com>.⁸³

Autoritetet e ndjekjes duhet të kenë parasysh se sipas AMLD5⁸⁴ përdoruesit që i posedojnë monedhat e tyre virtuale nëpërmjet një ofruesi të portofolit me kujdestar ose hyjnë në transaksione të monedhës virtuale nëpërmjet një platforme për shkëmbim të valutave virtuale, nuk mund të jenë më anonimë, për shkak të detyrimeve për analizë të thellë të klientëve të cilat i kanë ofruesit e portofolit me kujdestar dhe platformave për shkëmbim të monedhave virtuale. Kështu, në raste të caktuara aty mund të gjenden prova përkatëse.⁸⁵ Megjithatë, duhet të sqarohet se nuk mund të gjenden dëshmi të tilla të platformave të tregtimit, pasi ato nuk udhëhiqen nga një subjekt ose kompani që i mbikëqyr dhe i përpunon të gjitha transaksionet, por ato operohen ekskluzivisht nga softueri (gjegjësisht nuk ka asnjë pikë qendrore autoriteti).

2. VENDOSJA E KONTROLLIT MBI MONEDHAT VIRTUALE

Informacioni i mbledhur gjatë hetimit dhe i diskutuar në kapitullin e mëparshëm është thelbësor që autoritetet e zbatimit të ligjit të jenë në gjendje të vendosin kontrollin mbi MV-të. Për sekuestrimin e suksesshëm të MV-ve janë identifikuar disa hapa⁸⁶:

1. Identifikimi (gjetja) i MV-së
Identifikimi i MV-së përfshin marrjen e informacionit për llojin e MV-së në fjalë, sasinë e tyre dhe mundësinë për të hyrë në MV.
2. Identifikimi i lidhjes midis MV-së dhe përdoruesit
Kjo në të vërtetë është pjesa më e vështirë e hetimit. Megjithëse ka disa aktivitete që mund të ndihmojnë në krijimin e lidhjes midis MV-së dhe

83 Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RrEGJKK

84 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32018L0843>

85 Nuk duhet pritur asnjë dëshmi e tillë nga shkëmbyesit e MV-së që pranojnë vetëm kriptomonedha dhe në rastet kur janë përdorur kriptomonedha anonime.

86 Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RrEGJKK

III. Rëndësia e monedhave virtuale në procedurat penale

përdoruesit ⁸⁷, në shumicën e rasteve, kjo lidhje mund të krijohet në bazë të provave dhe fakteve të gjetura gjatë bastitjes.

3. Sigurimi i hyrjes (qasjes) në MV
Kjo mund të bëhet ose duke marrë qasje nga të dyshuarit/përdoruesite⁸⁸ ose duke i identifikuar portofolat, duke i marrë çelësat privatë dhe fjalëkalimet për rikuperimin e çelësave privatë⁸⁹. Pa siguruar qasje në MV, ato nuk mund të sigurohen.
4. Marrja e instrumentit ligjor për sekuestrim
Sekuestrimi i përkohshëm i valutave virtuale është i mundur vetëm nëse ekzistojnë baza ligjore dhe vetëm nëse organi kompetent e lëshon instrumentin e duhur ligjor për sekuestrimin nga organi kompetent.
5. Zbatimi i sekuestrimit
Sekuestrimi i valutave virtuale mund të zbatohet pasi të jetë marrë instrumenti ligjor për sekuestrim. Ekzistojnë dy mundësi kryesore për zbatimin e sekuestrimit: a. Nëpërmjet rruajtjes dhe sigurimit të MV-të (kjo bëhet duke i transferuar MV-të nga portofoli i përdoruesit në një portofol të sigurt të kontrolluar nga autoriteteve) dhe b. të konvertohen MV-të e sekuestruara (kjo bëhet duke i shitur MV-të).

Siç u përmend, sigurimi i MV-ve bëhet duke i transferuar MV-të nga portofoli i përdoruesit në një portofol të sigurt - të kontrolluar nga autoritetet. Një portofol i kontrolluar nga autoritetet është një portofol që është nën kontrollin e qeverisë ose shtetit. Më konkretisht, varësisht nga korniza ligjore, ky portofol mund të jetë nën kontrollin e një agjencie të zbatimit të ligjit, një gjykate, një gjykatësi (hetues), një prokurori publik, një organi të konfiskimit, një kompanie private që merret me menaxhimin e mjeteve, apo edhe një kompani ankandesh.⁹⁰

87 Siç thekson Udhëzuesi i Monedhave Virtuale për Autoritetet Gjyqësore i RreGjKK, kjo mund të bëhet me përdorimin e qasjes “ndiqni paratë”, kur analizohen transaksionet që normalisht janë publike dhe të verifikueshme, nëpërmjet inspektimit të librave apo blloqeve publike (p.sh. duke përdorur softuerin Chainalysis). Meqenëse përdoruesit e monedhave virtuale janë anonimë, qëllimi i kësaj qasjeje është zbulimi i identitetit të një autori të panjohur ose lidhja e një autori të njohur me përfitimet e paligjshme, gjë që mund të arrihet duke identifikuar ofruesin e portofolit elektronik të autorit; identifikimi i adresës IP të përdoruesit të një portofoli të caktuar elektronik dhe marrja e të dhënave të llogarisë për tregtim të autorit nga ofruesi i shkëmbimit online.

88 Nuk duhet të përjashtohet mundësia që i dyshuari/përdoruesit do të donin të ofronin vullnetarisht qasje në MV të organeve të ndjekjes. Nëse gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarit, i dyshuari pranon përdorimin e portofolit dhe jep pëlqim me shkrim për sekuestrimin e MV-së me anë të sistemit të tij kompjuterik, policia mund ta bëjë këtë menjëherë në përputhje me nenin 32 b) të Konventës së Budapestit për Krimin Kibernetik pa donjë kërkesë tjetër procedurale. Gjithashtu, në disa juridiksione, është e mundur të të dyshuarit të detyrohen t'i dorëzojnë disa fjalëkalime (çelësat e enkriptimit, çelësat privatë).

89 Ky informacion mund të gjendet në bazë të ekzaminimit të të dhënave digjitale, të ruajtura në pajisje elektronike ose të lidhura.

90 “Udhëzues për sekuestrimin e krypto-monedhave”, Zyra e Programit të Krimin Kibernetik e Këshillit të Evropës, shkurt 2021, fq.23

Nëse është e aplikueshme (d.t.th., duke e marrë parasysh kornizën ligjore përkatëse dhe procedurat e sekuestrimit), është praktikë e mirë që menjëherë posa të paraqitet mundësia për sekuestrimin potencial të valutave virtuale të përgatiten paraprakisht adresa(t) adekuate ku mund të transferohen valutat virtuale⁹¹. Varësisht nga kriptomonedhat që do të gjenden, mund të jetë e nevojshme të përgatiten disa portofola të kontrolluara nga autoritetet, si për shembull një për Bitcoin, një tjetër për Monero dhe kështu me radhë, ose në vend të këtyre portofolave të ndryshme mund të përdoret një portofol me shumë monedha. Kështu, nëse është e zbatueshme, krijimi i këtyre adresave/portofolave duhet të bëhet në një mjedis kompjuterik të sigurt dhe rekomandohet fuqimisht të keni një udhëzues të shkruar me instruksione të detajuara të rregullave të brendshme. Këshillohet që të përdoren adresa të veçanta për çdo sekuestrim apo konfiskim.⁹²

Në varësi të asaj se çfarë portofol i kontrolluar nga autoritetet dhe/ose procedurë do të përdoret, mundet që adresa e sekuestrimit të jetë përgatitur më parë si një kod QR për t'i shmangur gabimet e shtypit. Pikërisht përpara se të ekzekutohet një sekuestrim, kjo adresë sekuestrimi duhet të kontrollohet dy herë për të parë nëse adresa është ende e saktë. Rekomandohet që të zbatohet parimi i katër syve, në të cilin katër sy mund ta kontrollojnë saktësinë e adresës së sekuestrimit dhe kështu t'i mbrojnë personat që i sekuestrojnë asetet.⁹³

Një aspekt tjetër që duhet të merret parasysh në sekuestrimin e monedhave virtuale janë tarifat e transaksionit. Në fakt, për transferimin e MV-së në një portofol të sigurt, duhet të paguhet një tarifë për transaksionin. Kështu, është praktikë e mirë që të shqyrtohet paraprakisht kjo çështje, të vendoset se kush do ta paguajë tarifën e transaksionit dhe të vendoset për shumën e tarifave të transaksionit që do të paguhet.⁹⁴

Edhe në rastet kur ekziston opsioni për konvertimin e MV-së, duhet të theksohet se ky proces zakonisht vjen pasi që të sigurohen MV-të dhe të transferohen në një portofol të kontrolluar nga qeveria. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se i dyshuari më vonë mund të shpallet i pafajshëm dhe MV-ja e konvertuar do t'i kompensohet këtij individ.

91 Adresa e sekuestrimit është adresa ku do të dërgohen monedhat virtuale e sekuestruara.

92 “Udhëzues për sekuestrimin e kriptomonedhave”, Zyra e Programit të Krimin Kibernetik e Këshillit të Evropës, shkurt 2021, fq. 24

93 “Udhëzues për sekuestrimin e kriptomonedhave”, Zyra e Programit të Krimin Kibernetik e Këshillit të Evropës, shkurt 2021, fq.26

94 Duhet të kihet parasysh se tarifat e transaksionit mund të ndryshojnë dhe se mund të ofrohen tarifa më të larta për verifikimin e një transaksioni të caktuar, me qëllim që të fitojësiguri se transaksioni i tyre do të ketë përparësi ndaj transaksioneve të tjera të mundshme mbi të njëjtën MV.

IV. Legjislacioni i Republikës të Maqedonisë së Veriut lidhur me monedhat virtuale

Legjislacioni i Republikës të Maqedonisë së Veriut nuk i njeh monedhat virtuale si të tilla. Në momentin e botimit të këtij Doracaku, asnjë ligj që është në fuqi nuk e përcakton apo rregullon temën e monedhave virtuale. Megjithatë, ka analiza dhe përpjekje të vazhdueshme legjislative dhe institucionale për ta adresuar këtë temë.

Drejtoria Financiare e Zbulimit e Republikës të Maqedonisë së Veriut, si autoritet kombëtar përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të FATF-së, ka bërë një vlerësim të rrezikut të përdorimit të asetëve virtuale për pastrimin e parave (PP) dhe financimin e terrorizmit (FT). Vlerësimi i rrezikut është një nga dokumentet e pakta zyrtare që e trajton temën e monedhave virtuale nga perspektiva e parandalimit të pastrimit të parave / financimit të terrorizmit.

Gjithashtu, në momentin e publikimit të Doracakut, Ministria e Financave është duke punuar në një Ligj të ri për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit. Një nga çështjet që i prek ky ligj i ri është çështja e monedhave virtuale. Propozim-ligji i ri përfshin përcaktime për mjetet virtuale; ofruesi i shërbimeve të lidhura me mjetet virtuale; shërbimet ose aktivitetet e lidhura me mjetet virtuale; ruajtja dhe administrimi i mjeteve virtuale ose instrumenteve që mundësojnë kontrollin mbi mjetet virtuale; organizimi i një platforme për tregtimin e mjeteve virtuale; ekzekutimi i urdhrave të mjeteve virtuale në emër të palëve të treta; pjesëmarrja dhe ofrimi i shërbimeve në lidhje me ofertën e emetuesit dhe/ose shitja e mjeteve virtuale; menaxhimi i portofolit të mjeteve virtuale; pranimi dhe transmetimi i porosive për mjetet virtuale; botuesi i mjeteve virtuale; ofrimi publik i mjeteve virtuale; ofrimi i këshillave për mjetet virtuale; kriptomatet; portofoli i hostuar elektronik për mjetet virtuale; portofoli elektronik i pahostuar për mjetet virtuale dhe transaksionet e mjetet virtuale. Përkufizimet e përdorura në këtë propozim-ligj janë ato që përdoren dhe përcaktohen nga FATF-ja.

Gjithashtu, në momentin e botimit të këtij Doracaku, Ministria e Drejtësisë është duke punuar në tekste të reja ligjore të Kodit Penal dhe Ligjit të Procedurës Penale të Maqedonisë së Veriut. Grupet e punës janë të vetëdijshme për nevojën e përkufizimit të monedhave virtuale dhe rregullimit të rolit të tyre në procedurën penale, por në momentin e botimit të këtij Doracaku nuk është miratuar asnjë draft tekst zyrtar.

Ministria e Drejtësisë është duke punuar edhe në ndryshimet në Ligjin për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, Dobinë Pronësore dhe Sendet e Konfiskuara në Procedurën Penale dhe Kundërvajtëse. Në këtë Propozim-ligj, ligjvënësi përmend termin “para elektronike” dhe parasheh rregulla se si do të veprojnë Agjencia për Pronat e Konfiskuara në rast se paratë elektronike sekuestrohen përkohësisht. Në pjesën ku jepet përkufizimi i termave, nuk jepet përkufizimi se çfarë konsiderohen paratë elektronike. Nëse analizojmë më tej zgjidhjen ligjore, mund të konstatohet se dispozita ligjore ku përmenden paratë elektronike ka pasur për qëllim trajtimin e rastit të sekuestrimit dhe konfiskimit të monedhave virtuale dhe se termi “para elektronike” është përdorur gabimisht. Duke pasur parasysh se ky është vetëm një propozim-ligj, ka kohë të mjaftueshme për të bërë ndryshimet e duhura, që do të përfshijnë përdorimin e terminologjisë së saktë dhe që do të përfshijë përcaktimin ligjor të termave.

Zhvillimet e momentale ligjore në Maqedoninë e Veriut do të ndikojnë në mënyrën se si praktikuesit merren me monedhat virtuale në raste konkrete. Megjithatë, bazat ekzistuese ligjore për konfiskimin dhe masat e përkohshme për sigurimin në thelb do të mbeten të njëjta dhe zgjidhjet e reja do të ofrojnë një formë përmirësimi që do ta lehtësojë punën e praktikuesve.

1. BAZA LIGJORE KOMBËTARE PËR TRAJTIMIN E MONEDHAVE VIRTUALE NË PROCEDURAT PENALE

Në lidhje me procedurat penale, sipas legjislacionit aktual ekziston mundësia teorike në një procedurë penale përkohësisht të sekuestrohen ose konfiskohen e më vonë edhe plotësisht të konfiskohen monedhat virtuale nëse plotësohen të gjitha kushtet ligjore. Legjislacioni kryesor që mundëson trajtimin e MV-ve në procedurat penale është Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut⁹⁵ dhe Ligji i Procedurës Penale të Republikës të Republikës të Maqedonisë së Veriut.⁹⁶ Ligji përkatës që mund t’u ndihmojë praktikuesve në hetime dhe që mund të përdoret në lidhje me monedhat virtuale është Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit⁹⁷, si dhe Ligji për Menaxhimin e Pronës së

95 Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 139/2004 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014, 196/2015, 226/2015, 97/2017 dhe 248/2018

96 Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 150/10, 100/12 dhe 198/18

97 Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 120/18, 275/19 dhe 317/20

Konfiskuar, Dobinë Pronësore dhe Sendet e Konfiskuara në Procedurën Penale dhe Kundërvajtëse.⁹⁸ Megjithatë përdorimi i kësaj mundësie teorike shoqërohet me vështirësi të caktuara praktike.

1.1. Sekuestrimi dhe konfiskimi i përkohshëm i monedhave virtuale si sendeve të përdorura gjatë veprës penale dhe sendeve të dala nga kryerja e veprës penale

Siç u përmend, MV-të mund të jenë sende të përdorura gjatë veprës penale dhe sende të dala nga kryerja e veprës penale. Neni 100-a i Kodit Penal të Republikës të Maqedonisë së Veriut parashikon se askush nuk mund t'i mbajë ose përvetësojë sendet që janë fituar nga kryerja e veprës penale. Nga kryerësi i veprës penale do të merren edhe sendet që kanë qenë të dedikuara ose janë përdorur për kryerjen e veprës penale pa marrë parasysh se a janë pronë e tij ose pronë e personave të tretë nëse atë e kërkojnë interesat e sigurisë së përgjithshme, shëndeti i njerëzve ose arsyet e moralit. Po ashtu, sendet që janë përdorur ose kanë qenë të përdorura për kryerjen e veprës penale mund të merren nëse ekziston rrezik përsëri të përdoren për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale.

Përkufizimi i termit “sende” është dhënë edhe në Kodin Penal⁹⁹, kështu që me sendet nënkuptohet sendet e tundshme dhe të patundshme që janë përdorur plotësisht ose pjesërisht ose duhet të ishin përdorur ose të ishin përfituar nga kryerja e një vepre penale. Kështu, në rastet kur MV-të janë fituar nëpërmjet kryerjes së një vepre penale¹⁰⁰ se janë dedikuar ose janë përdorur për të kryer një vepër penale¹⁰¹ ekziston mundësia për t'i sekuestruar përkohësisht dhe për t'i konfiskuar më vonë MV-të. Termi “sende” është gjerësisht i përkufizuar, duke u fokusuar vetëm në përdorimin ose përdorimin e mundshëm të sendeve, jo në karakteristikat e sendeve, andaj dispozitat ligjore në KP mund të përdoren si bazë juridike për sekuestrimin e përkohshëm dhe konfiskimin e MV-ve si sende që janë përdorur ose janë fituar nga kryerja e veprës penale.

Në përcaktimin e termit “para” ligji e përmend termin “para elektronike”. Kështu, para janë mjetet për pagesë në para të gatshme, në vlerë ose në para elektronike, të cilat në bazë të ligjit janë në përdorim në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në një shtet të huaj. Këtu duhet nënvizuar se paraja elektronike dhe monedhat virtuale janë dy koncepte të ndryshme. Paraja elektronike është vlera monetare e ruajtur në mënyrë elektronike, duke përfshirë edhe magnetikisht,

98 Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 98/08, 145/10, 104/13, 187/13, 43/14, 160/14, 97/15, 148/15 dhe 64/18

99 Neni 122 paragrafi 39 i KP-së

100 P.sh. MV-të janë gërmuar për qëllime të financimit të terrorizmit

101 P.sh. MV-të e përdorura për qëllime të pastrimit të parave

siç përfaqësohet nga një pretendim ndaj emetuesit, që lëshohet me marrjen e mjeteve për qëllime të kryerjes së transaksioneve të pagesave dhe që pranohet nga një person fizik ose juridik i ndryshëm nga emetuesi i parasë elektronike¹⁰². Për rrjedhojë, ruhet lidhja ndërmjet parasë elektronike dhe formatit tradicional të parasë dhe ka një bazë ligjore, pasi mjetet e ruajtura shprehen në të njëjtën njësi të llogarisë (p.sh. dollarë amerikanë, euro, etj.)¹⁰³ Për rrjedhojë, ruhet lidhja ndërmjet parasë elektronike dhe formatit tradicional të parasë dhe ka një bazë ligjore, pasi mjetet e ruajtura shprehen në të njëjtën njësi të llogarisë (p.sh. dollarë amerikanë, euro, etj.)¹⁰⁴ Rregullat për sekuestrimin e përkohshëm dhe konfiskimin e mëvonshëm të mjeteve të veprës penale janë të përcaktuara në Ligjin e Procedurës Penale të Maqedonisë së Veriut.

1.1.1. Sekuestrimi i përkohshëm i monedhave virtuale si sende të përdorura ose sende të fituara nga kryerja e veprës penale

Sipas LPP-së¹⁰⁵ sendet e përdorura dhe sendet e fituara nga kryerja e veprës penale mund të sekuestrohen përkohësisht, konfiskohen ose mund të shqiptohet ndonjë masë tjetër e përkohshme për të parandaluar përdorimin, transferimin dhe menaxhimin e tyre. Kur bëhet fjalë për MV-të, duket se sekuestrimi i përkohshëm është masa e përkohshme më e përshtatshme për sigurimin e tyre gjatë procedurës penale, pasi sekuestrimi do të mundësojë përbushjen e qëllimit për të cilin është shqiptuar masa e përkohshme dhe do të parandalojë përdorimin, transferimin dhe menaxhimin e mëtejshëm të MV-ve.

Sekuestrimi i përkohshëm i MV-ve mund të bëhet në të gjitha fazat e procedurës penale, madje edhe në fazën para-hetimore. Rregulla e përgjithshme është se sekuestrimi i përkohshëm bëhet në bazë të aktvendimit të gjykatës që është lëshuar me kërkesë të prokurorit publik.

Kërkesa e prokurorit duhet t'i përmbajë të gjitha elementet e detyrueshme që i përcakton LPP-ja. Në rastet e sekuestrimit të përkohshëm të MV-ve janë disa elemente dalluese që prokurori duhet t'i përfshijë në kërkesën për caktimin e masave të përkohshme të sigurimit (në rastin konkret kërkesën për sekuestrim të përkohshëm të monedhave valutore). Kështu, kërkesa për sekuestrimin të përkohshëm të MV-ve duhet të përfshijë:

- Një përkrahje të shkurtër të veprës penale dhe emërtimin e saj ligjor

102 Neni 2 i Direktivës 2009/110/KE të Parlamentit Evropian dhe i Këshillit të Evropës të datës 16 shtator 2009 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32009L0110-&from=en>

103 Banka Qendrore Evropiane "Skemat e monedhave virtuale", tetor 2012, faqja 16 <https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/other/virtualcurrencymes201210en.pdf>

104 Kjo u diskutua në nënkapitullin 2 të kapitullit III të këtij Doracak

105 Neni 202 i LPP-së

- Përshkrim të MV-së që e ka origjinën ose lidhet me veprën penale duke përfshirë llojin e MV-së, sasinë/vlerën e MV-së dhe vendndodhjen e MV-së – identifikuesin e portofolit. Përshkrimi i MV-së duhet të përfshijë vlerën e MV-së në momentin e kërkesës, pasi gjykata është e detyruar ta tregojë vlerën në vendimin e gjykatës.
- Informacion mbi përdoruesin e MV-së duke shënuar emrin dhe mbiemrin e përdoruesit, të dhënat e tij/saj personale
- Provat mbi të cilat bazohet dyshimi se MV-të janë përdorur ose janë fituar nga kryerja e një vepre penale
- Shkaqet e probabilitetit që sekuestrimi i MV-së mund të vështirësohet ose të pamundësohet deri në fundin e procedurës penale. Kur i përshkruan këto arsye, duhet të merret parasysh se MV-ja mund të qaset nga distanca nga pajisje të ndryshme dhe se sekuestrimi i një pajisjeje ku janë gjetur monedhat virtuale pa e sekuestruar vetë MV-në nuk është i mjaftueshëm.
- Propozimin të cilin autoritetit kompetent do të kryejë sekuestrimin e përkohshëm – kjo pjesë e përmbajtjes të kërkesës nuk është e detyrueshme, por mund të jetë e dobishme, veçanërisht në rastet kur prokuroria preferon që sekuestrimin ta bëjë ndonjë autoritet tjetër kombëtar, në vend të Agjencisë për Menaxhimin e Pronave të Konfiskuara.
- Adresa publike e një portofoli të sigurt ku do të transferohen MV-të.

Kërkesa për caktimin e masave të përkohshme për sigurimin, përkatësisht për sekuestrimin e përkohshëm mund të parashtrohet në procedurën paraprake ose pas ngritjes së aktakuzës. Nëse kërkesa është parashtruar para fillimit dhe gjatë procedurës paraprake, gjyqtari i procedurës paraprake do të jetë organi kompetent që do të merret me kërkesën dhe nëse kërkesa është dërguar pas ngritjes së aktakuzës do të jetë gjykatësi i

Procedura për caktimin e masave të sigurimit (sekuestrimin e përkohshëm) - është urgjente. Gjyqtari i procedurës paraprake vendos menjëherë dhe jo më vonë se 12 orë nga marrja e kërkesës së prokurorit. Nëse gjyqtari i procedurës paraprake nuk e pranon kërkesën e prokurorit publik, pa shtyrje do të kërkojë që vendim të sjellë këshilli penal pranë Gjykatës. Këshilli penal do të vendosë në afat prej 24 orëve nga momenti i marrjes së kërkesës. Pavarësisht afateve të shkurtra kohore, duhet theksuar se kur bëhet fjalë për MV-të, organet e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjykatat duhet të veprojnë me urgjencë të madhe, për shkak të rrezikut të lartë të transferimit të mëtejshëm të MV-së nga përdoruesi ose një person që ka qasje në MV-të në fjalë.¹⁰⁶

106 Duhet pasur parasysh faktin se nëse përdoruesi është pjesë e një organizate kriminale, ai/ajo mund të mos jetë personi i vetëm që ka qasje në MV-të. Informacioni për arrestimin e tij/saj mund të shkaktojë alarm dhe anëtarët e tjerë të grupit të organizuar që gjithashtu kanë qasje në MV-në në fjalë mund ta zhvendosin MV-në në një vend tjetër.

Në vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës së prokurorit për sekuestrimin e MV-së, përveç informacionit të përfshirë në kërkesën e prokurorit për sekuestrimin, gjykata duhet të përfshijë edhe bazën ligjore të sekuestrimit¹⁰⁷, vlerën e MV-së, periudhën kohore për të cilën sekuestrohet MV-ja dhe autoritetet të cilave duhet t'u dërgohet vendimi i gjykatës.

Vlera e monedhave virtuale nuk është e lidhur me sjelljen e një ekonomie të caktuar dhe varet nga oferta dhe kërkesa e një monedhe të caktuar virtuale. Kjo vlerë është shumë dinamike dhe ndryshon çdo ditë. Kështu, kur deklarohet vlera e MV-së, duhet të shënohet dita dhe ora e saktë kur është përcaktuar vlera. Vlera e monedhave virtuale është në dispozicion online falas dhe gjykata mund ta shohë këtë vlerë në momentin e marrjes së vendimit. Platformat e shkëmbimit si Coinbase gjithashtu ofrojnë informacion në lidhje me vlerën e MV-së në një moment të caktuar.

LPP-ja përmban rregulla procedurale në lidhje me periudhën kohore për të cilën sekuestrimi i përkohshëm mund të jetë në fuqi. Nëse sekuestrimi i përkohshëm bëhet gjatë procedurës para-hetimore, kjo masë përfundon jo më vonë se tre muaj nga dita sjelljes të vendimit me të cilin është caktuar, përveç nëse zyrtarisht nuk është hapur hetimi. Në të gjitha rastet e tjera, sekuestrimi i përkohshëm mund të zgjasë deri në përfundimin e procedurës penale në gjykatën e shkallës së parë. Domethënë, në procedurën paraprake në të cilin është shqiptuar si masë e përkohshme sekuestrimi i monedhave virtuale, prokurorët duhet të veprojnë me urgjencë, pasi afati prej tre muajsh nuk është i gjatë dhe nuk mund të zgjatet. Brenda tre muajve prokurori duhet të sigurojë prova të mjaftueshme që do të rezultojnë ose me një hetim ose me mbylljen e rastit. Në të kundërtën, pavarësisht se rasti nuk do të hetohet plotësisht, prokurori rrezikon që masa e përkohshme të anulohet dhe MV- të lirohen, kjo i jep hapësirë përdoruesit të monedhave virtuale që t'i përdorë lirisht, t'i menaxhojë dhe t'i transferojë ato.

Vendimi i gjykatës për sekuestrimin e përkohshëm të MV-së duhet t'i dërgohet pa vonesë autoritetit kompetent për sigurimin e MV-së.¹⁰⁸ Kështu, në vendimin e saj, gjykata duhet ta trajtojë çështjen e autoritetit kompetent që do ta zbatojë sekuestrimin e përkohshëm. Si rregull i përgjithshëm, autoriteti kombëtar kompetent që informohet pa vonesë për vendimin e gjykatës për sekuestrimin e përkohshëm të pronës, dobisë pronësore ose sendeve, është Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar.¹⁰⁹ Nëse i shikojmë nga afër përkufizimet e

107 Bazat ligjore që i mundësojnë gjykatës sekuestrimin e MV-së janë ato të përcaktuara në nenin 202 të LPP-së.

108 Neni 202, paragrafi 12 i LPP-së

109 Neni 24 i Ligjit për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, Dobisë Pronësore dhe Sendeve të Konfiskuara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse.

termave “pronë, dobi pronësore dhe sende” të dhëna në Ligjin për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, Dobisë Pronësore dhe Sendeve të Konfiskuara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse, është e qartë se këto terma e ndjekin kuptimin e përcaktuar në Kodin Penal. MV-të bëjnë pjesë në këtë kategori dhe si rregull i përgjithshëm, Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar është autoriteti kompetent për sekuestrimin e përkohshëm të tyre. Megjithatë, ligji ofron mundësinë që Gjykata të vendosë ndryshe dhe të tregojë se cili autoritet kombëtar do të jetë përgjegjës për trajtimin e pronës, dobisë pronësore ose sendeve të sekuestruara. Prandaj, këshillohet që prokurorët, përpara se të kërkojnë sekuestrimin e përkohshëm, të dinë se cili autoritet kombëtar do ta zbatojë sekuestrimin e përkohshëm dhe ta cekin emrin e institucionit në kërkesën për sekuestrim të përkohshëm, së bashku me adresën publike ku duhet të transferohen MV-të.

Përveç rregullit të përgjithshëm që masat e përkohshme të sigurimit, me atë edhe sekuestrimi i përkohshëm kërkohet nga prokurori publik, në rastet kur ekziston rreziku i shtyrjes, anëtarëve të policisë gjyqësore u jepet mundësia të sekuestrojnë përkohësisht MV-të që janë instrumente të veprës penale.¹¹⁰ Duhet theksuar se në këtë rast rregullat nga LPP-ja që parashikojnë kompetencën e policisë gjyqësore për sekuestrimin e MV-së janë ligj i përveçëm (lex specialis) në lidhje me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, Dobisë Pronësore dhe Sendeve të Konfiskuara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse, që përcaktojnë kompetencën e Agjencisë kur është fjala për implementimin e sekuestrimit të përkohshëm.

Kjo mundësi që i jepet policisë gjyqësore për të vepruar menjëherë pa ndërhyrjen paraprake të prokurorit apo të gjykatës ka rëndësi të jashtëzakonshme kur bëhet fjalë për MV-të, pasi mundëson reagimin në kohë dhe të menjëhershëm të organeve për zbatimin e ligjit. Por, nëse masat e tilla ndërmerren nga policia gjyqësore, menjëherë duhet të njoftohet prokurori publik dhe në atë rast masat duhet të miratohen nga gjyqtari paraprak brenda 72 orëve nga momenti i zbatimit të tyre. Nëse gjyqtari i procedurës paraprake nuk jep miratim, masat e marra nga policia gjyqësore duhet të ndërpriten dhe çdo MV e sekuestruar përkohësisht duhet t'i kthehet menjëherë personit prej të cilit janë sekuestruar përkohësisht.

Në Shtojcën II të Doracakut ka në përmbajtje një shabllon të kërkesës për shqiptimin e masave të përkohshme për sigurimin e MV-të që janë përdorur ose janë të fituara nga kryerja e veprës penale.

1.1.2. Konfiskimi (sekuestrimi i përhershëm) i monedhave virtuale që janë përdorur ose janë të fituara nga kryerja e veprës penale

Ekzistojnë dy lloje kryesore të sekuestrimit të përhershëm (konfiskimit) të sendeve të përdorura ose të fituara nga kryerja e veprës penale në Maqedoninë e Veriut: 1) një i detyrueshëm dhe 2) një diskrecional (opsional).

Baza ligjore për konfiskimin e detyrueshëm gjenden si në pjesën e përgjithshme ashtu edhe në atë të veçantë të Kodit Penal të Maqedonisë së Veriut. Kështu, sipas pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, nuk mund t'i mbajë ose t'i përvetësojë sendet që janë fituar nga kryerja e veprës penale. Sendet që kanë qenë të dedikuara ose të përdorura për kryerjen e veprës penale pa marrë parasysh se a janë pronë e kryerësit ose pronë e personave të tretë do të sekuestrohen nga ai nëse atë e kërkojnë interesat e sigurisë së përgjithshme, shëndeti i njerëzve ose arsytet e moralit.¹¹¹ Pjesa e posaçme e Kodit Penal parashikon konfiskimin e sendeve të përdorura ose që janë fituar me kryerjen e veprës penale për vepra konkrete penale.

Sekuestrimi diskrecional (opsional) i sendeve të përdorura ose të fituara nga kryerja e veprës penale rregullohet në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal, ku thuhet se sendet e përdorura ose që synohen të përdoren për kryerjen e një vepre penale mund të sekuestrohen nëse ekziston rreziku që ato të përdoren përsëri për të kryer një vepër tjetër penale.¹¹²

MV-të mund t'i nënshtrohet si konfiskimit të detyrueshëm ashtu edhe atij diskrecional, në varësi të fakteve të rastit. Konfiskimi në procedurë penale, si rregull i përgjithshëm bëhet nga gjykata, me aktgjykim dënues. Kur parashikohet konfiskimi i detyrueshëm, MV-të do të sekuestrohen edhe në rast se procedura penale nuk ka përfunduar me dënimin e të pandehurit.¹¹³ Gjithashtu, vendimin për sekuestrimin e sendeve do ta sjell gjykata, edhe nëse me aktgjykim dënues është lëshuar që të sjellët një vendim të tillë.¹¹⁴ Kjo do të thotë se në rastet e konfiskimit të detyrueshëm të MV-ve që janë përdorur ose janë të fituara nga kryerja e veprës penale, gjykata vepron sipas detyrës zyrtare. Gjithashtu ligji parashikon që kur ekzistojnë pengesa faktike dhe ligjore për zhvillimin e procedurës penale kundër kryerësit të veprës penale, me propozim të prokurorit publik, gjykata duhet të zhvillojë procedurë të veçantë për konfiskimin e instrumenteve të veprës penale, nëse janë plotësuar kushtet e parapara në Kodin Penal.¹¹⁵

111 Neni 100-a, paragrafët 1 dhe 2 të KP-së

112 Neni 100-a, paragrafi 3 i KP-së

113 Neni 529, paragrafi 1 i LPP-së

114 Neni 529, paragrafi 3 i LPP-së

115 Neni 540, paragrafi 1 i LPP-së

Pra, bazat ligjore për konfiskimin e MV-ve që janë përdorur ose janë të fituara nga kryerja e veprës penale gjenden qoftë në nenin 100-a të Kodit Penal, qoftë në nene të veçanta që kanë të bëjnë me vepra të veçanta penale. Gjithashtu, bazat ligjore për konfiskimin e detyrueshëm sipas detyrës zyrtare gjenden në nenin 529 të LPP-së. Në rastet kur konfiskimi nuk është i detyrueshëm dhe gjykata nuk ka të drejtë të veprojë sipas detyrës zyrtare, është e padiskutueshme se prokurori duhet të kërkojë konfiskimin. Duhet theksuar se terminologjia e përdorur në ligj është jokonsekuente dhe krijon probleme në praktikë. Kështu, gjykatat në raste të caktuara përdorin termin “konfiskim”, ndërsa në raste të tjera termin “sekuestrim” dhe “sekuestruar”.

Në rastet kur me aktvendimin është shqiptuar edhe masa e veçantë për sekuestrimin e sendeve, me saktësisht në rastet kur me aktvendimin konfiskohen sendet që janë përdorur ose janë të fituara nga kryerja e veprës penale, gjykatës i jepet mundësia të vendos nëse këta sende që konfiskohen do të shiten sipas dispozitave të vlefshme për përbarim ose do t’ju dorëzohen organeve shtetërore, muzeut kriminalistik ose institucioneve tjera ose do të shkatërrohen. Të ardhurat nga një shitje e tillë do të shkojnë në buxhetin e shtetit të Maqedonisë së Veriut.¹¹⁶ Kështu, nëse MV-të konfiskohen, gjykata mund të vendosë t’i shesë ato. Problemi këtu është se dispozitat e vlefshme për procedurën përbaruese nuk e rregullojnë shitjen e MV-ve, andaj është e diskutueshme se si do të kryhet shitja në praktikë, në lidhje me respektimin e këtij kushti ligjor për shitjen e MV-ve.

Organi kompetent që duhet ta zbatojë vendimin e gjykatës për konfiskimin e MV-ve sipas Ligjit për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, Dobisë Pronësore dhe Sendeve të Konfiskuara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse është Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar.¹¹⁷ Nëse MV-të sekuestrohen përpara konfiskimit të tyre, ato do të jenë tashmë në një portofol të sigurt. Nëse MV-të nuk janë sekuestruar përkohësisht para vendimit përfundimtar të gjykatës, konfiskimi i tyre do të vihet në pikëpyetje pasi rreziku që të mos jenë më në vendin e përhershëm është mjaft i lartë. Legjislacioni aktual nuk jep një përgjigje të qartë se çfarë duhet të bëjë Agjencia me MV-të e konfiskuara. Siç u përmend, gjykata është ajo që vendos për shitjen e MV-ve, andaj në rastet kur nuk ka vendim të gjykatës për shitjen e MV-ve është e paqartë se çfarë duhet të bëjë Agjencia.

116 Neni 135, paragrafët 7 dhe 8 të LPP-së

117 Neni 28 i Ligjit për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, Dobisë Pronësore dhe Sendeve të Konfiskuara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse, thotë se vendimi për sekuestrimin e pronës, dobisë pronësore apo sendeve të veprës penale zbatohet nga Agjencia. Agjencia mund të kërkojë ndihmë nga Ministria e Punëve të Brendshme për ekzekutimin e vendimit.

1.2. Sekuestrimi i përkohshëm dhe konfiskimi i monedhave virtuale të cilat paraqesin dobi pronësore të fituara nga kryerja e veprës penale

Në legjislacionin e Maqedonisë së Veriut, bazat për sekuestrimin e dobisë pronësore të veprës penale janë të rregulluara në Kodin Penal, ku thuhet se askush nuk mund ta mbajë dobinë pronësore, indirekte ose të drejtpërdrejtë, të përfituara nga vepra penale, i cili parasheh konfiskimin e përfitimit të drejtpërdrejt¹¹⁸ dhe indirekt¹¹⁹, si dhe konfiskimin e zgjeruar.¹²⁰ Përveç konfiskimit të dobisë pronësore nga i akuzuari, ligji parashikon mundësinë e konfiskimit të dobisë pronësore edhe nga pala e tretë.¹²¹

Sipas ligjit, objekt i konfiskimit janë paratë, sendet e tundshme dhe të patundshme me vlerë, si dhe çdo pronësi tjetër, pasuri ose aktive, të drejta materiale ose jo materiale, e nëse konfiskimi i tyre nuk është i mundur do të konfiskohet pasuri tjetër e cila korrespondon me vlerën e dobisë së fituar.¹²²

Pra, sipas këtyre përcaktimeve, është e mundur të konfiskohen monedhat virtuale që janë dobi pronësore, pasi ato janë lloj i pronësisë dhe i sjellin të drejta materiale pronarit të tyre. Për rrjedhojë, MV-të mund t'i nënshtrohen masave të përkohshme për sigurim në procedurën penale.

1.2.1. Sekuestrimi i përkohshëm i monedhave virtuale të cilat paraqesin dobi pronësore e fituar nga kryerja e veprës penale

LPP-ja përmban rregulla procedurale për shqiptimin e masave të përkohshme për sigurimin që mund të ndihmojnë në sigurimin e MV-ve që paraqesin dobi pronësore të fituara nga kryerja e veprës penale me qëllim të konfiskimit të mëvonshëm. Masat e përkohshme mbrojtëse për sigurimin mund të shqiptohen ndaj të pandehurit ose ndaj palëve të treta, të cilët ekziston dyshimi se drejt tyre është kaluar prona ose dobia pronësore e fituar nga kryerja e veprës penale, pa kompensimin përkatës.¹²³ LPP-ja përmban rregulla procedurale për shqiptimin e masave të përkohshme për sigurimin që mund të ndihmojnë në sigurimin e MV-ve që paraqesin dobi pronësore të fituara nga kryerja e veprës penale me qëllim të konfiskimit të mëvonshëm. Masat e përkohshme mbrojtëse për sigurimin mund të shqiptohen ndaj të pandehurit ose ndaj palëve të treta, të

118 Neni 97 i Kodit Penal

119 Neni 97-a i Kodit Penal

120 Neni 98-a i Kodit Penal

121 Neni 98, paragrafët 2 dhe 3 dhe neni 98-a, paragrafët 2 dhe 3 të Kodit Penal.

122 Neni 98, paragrafi 1 i Kodit Penal

123 Neni 535 i LPP-së

cilët ekziston dyshimi se drejt tyre është kaluar prona ose dobia pronësore e fituar nga kryerja e veprës penale, pa kompensimin përkatës.¹²⁴

Kështu, masa më e përshtatshme e përkohshme për sigurimin e MV-ve siç është dobia pronësore e fituar nga vepra penale do të jetë sekuestrimi i MV-ve. MV-të mund t'i sekuestrohen si nga i akuzuari, ashtu edhe nga një palë e tretë. Duhet të theksohet se një përdorues i MV-ve mund t'i transferojë MV-të nga portofoli i tij, drejtpërdrejt në portofolin e një përdoruesi tjetër të MV-ve. Ky transferim mund të bëhet pa kompensimin përkatës që u mundëson autoriteteve për zbatimin e ligjit të kërkojnë sekuestrimin e MV-ve edhe nga pala e tretë. Vlera e kompensimi përkatës për transferimin e MV-ve është i lehtë për t'u përcaktuar pasi transaksioni për transferim të monedhave valutore përmban të dhëna në vete se kur është kryer transferimi, ndërsa vlera e MV-së në atë moment të saktë mund të shihet online falas. Dhurimi i MV-ve nuk është i panjohur, andaj nëse një palë e tretë merr si dhuratë MV që paraqesin një dobi pronësore të veprës penale, kjo MV mund të sekuestrohen përkohësisht si një masë e sigurimit.

Masat e përkohshme i lëshon gjykata me kërkesë të prokurorit publik. Dispozitat ligjore për masat e përkohshme për sigurimin e sendeve që janë përdorur ose janë të fituara nga kryerja e veprës penale zbatohen në përputhje me rrethanat, në rastet e masave të përkohshme për sigurimin e dobisë pronësore të veprës penale. Dallimi i vetëm kur shqiptohen masat të përkohshme për sigurimin e MV-ve si dobi pronësore të veprës penale kundrejt MV-ve si instrumente të veprës penale janë afatet e ankimit kundër vendimit të gjykatës.

Për rrjedhojë e kësaj, kur kërkohen masa të përkohshme për sigurimin e MV-ve të cilat paraqesin dobi pronësore e fituar nga vepra penale, prokurori publik duhet që t'i ketë gjithë informatat e nevojshme për parashtrimin e kërkesës për sekuestrimin të përkohshëm të MV-ve që janë përdorur ose janë fituar nga kryerja e veprës penale. Gjithashtu, vendimi i gjykatës për sekuestrimin e përkohshëm të MV-ve të cilat paraqesin dobi pronësore e fituar nëpërmjet veprës penale duhet t'i përmbajë të njëjtat elemente sikurse edhe vendimi i gjykatës për sekuestrimin e përkohshëm të MV-ve që janë përdorur të veprës penale. Sipas asaj, për vendimin e gjykatës dhe organin kompetent për ekzekutimin e vendimit gjyqësor vlejné të njëjtat vërejtje që u dhanë në kapitullin paraprak të këtij.

Nga pikëpamja praktike, MV-të në një segment mund të jenë përdorur ose të jenë fituar nga kryerja e veprës penale, si dhe pjesë e dobisë pronësore të veprës penale. Për shembull – i dyshuari posedon pajisje për gjerim të kripto valutave, por ai me qëllim që ta anashkalojë shpenzimet për energjinë elektrike, është

124 Pavarësisht se neni 535 i LPP-së përmban gabim teknik dhe e revokon nenin 194 të LPP-së, është e qartë se synimi është revokimi i masave të përkohshme mbrojtëse të parashikuara në nenin 202 të LPP-së. Një qasje e tillë po pranohet në praktikë.

kyçur në mënyrë të drejtpërdrejtë në rrjetin e furnizimit të energjisë elektrike, në atë mënyrë në një periudhë nj vjeçare ka vjedhur energjinë elektrike me qëllim të gërmimit të kriptovalutave. Gjatë asaj periudhe ja ka dalë që me sukses të gërmojë një sasi të caktuar të kriptovalutave, të cilat në kuptimin juridik të fjalës do të thotë që paraqesin sende të fituara nga kryerja e veprës penale. Vlera e kriptovalutave gjatë periudhës kohore është rritur. Kështu që i dyshuari ka filluar të tregtojë me kriptovalutat në platformën e shkëmbimit, në atë mënyrë që kriptovalutat e gërmuara i ka shitur dhe ka blerë kriptovaluta të reja. Kriptovalutat e reja paraqesin dobi pronësore indirekte të cilën i pandehuri e ka fituar me kryerjen e veprës penale. Në raste të tilla, është e parëndësishme se cilat baza ligjore do t'i përdorë prokurori për sekuestrimin e përkohshëm të MV-së, pasi rregullat procedurale për sekuestrimin janë të njëjta dhe ligji parashikon mundësinë e shqiptimit të masave të përkohshme të mbrojtjes për të dyja situatat.

Shembulli i dhënë në Shtojcën II të Doracakut mund të përdoret edhe si shabllon për kërkesën për shqiptimin e masave të përkohshme për sigurimin e MV-të që janë dobi pronësore e veprës penale, duke i përshtatur bazat ligjore.

1.2.2. Konfiskimi i monedhave virtuale që paraqesin dobi pronësore të fituara nga kryerja e veprës penale

Procedura e konfiskimit të dobisë pronësore e fituar me vepër penale është e përcaktuar në LPP¹²⁵, ku thuhet se prona dhe dobia pronësore të fituara nga kryerja e një veprë penale përcaktohen në procedurë penale. Prokurori publik është i obliguar gjatë procedurës penale të mbledhë prova dhe t'i shqyrtojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për përcaktimin e pronës dhe dobisë pronësore të fituara nga kryerja e veprës penale. Kështu, nëse duket se janë dobi pronësore të veprës penale, prokurori publik duhet të mbledhë prova që e mbështesin këtë dhe duhet të jetë në gjendje të dëshmojë se MV-të në fjalë janë me të vërtetë dobi pronësore të veprës penale, duke kërkuar konfiskimin e tyre.

Në rastet kur MV-të paraqesin dobi pronësore e fituar me kryerjen të veprës penale, përdoruesi i MV-ve thirret për t'u marrë në pyetje gjatë procedurës paraprake dhe në shqyrtimin kryesor, por procedura mund të zhvillohet edhe në mungesë të tij. Përdoruesi ka të drejtë të propozojë prova dhe me autorizimin e Kryetarit të Këshillit Gjyqësor ta marrë në pyetje të akuzuarin, dëshmitarët dhe ekspertët.

Konfiskimi i dobisë pronësore të fituar me kryerjen e veprës penale, gjykata zakonisht e kryen në aktgjykimin e të akuzuarit. Në shpalljen e aktgjykimit, gjykata duhet të përshkruajë MV-në që do të konfiskohet.

Gjithashtu edhe për konfiskimin e mjeteve të përdorura për ose të fituara nga kryerja veprës penale, ligji përcakton se kur ekzistojnë pengesa faktike dhe ligjore për zhvillimin e procedurës penale kundër kryerësit të veprës penale, me propozim të prokurorit publik, gjykata duhet të zhvillojë procedurë të veçantë për konfiskimin e dobisë pronësore të veprës penale, nëse janë plotësuar kushtet e parapara në Kodin Penal.¹²⁶ Kështu, për shembull, nëse përdoruesi i MV-ve vdes gjatë procedurës penale, prokurori mund të paraqesë kërkesë për zbatimin e procedurës së veçantë të konfiskimit për konfiskimin e MV-ve që duket se janë dobi pronësore të fituara nga kryerja e veprës penale.

Kur bëhet fjalë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për konfiskimin e MV-ve të cilat paraqesin si dobi pronësore të fituara me kryerjen e veprës penale, ligji parashikon që fletë urdhëresën për zbatim e lëshon gjykata që ka marrë vendimin e shkallës së parë.¹²⁷ Duke pasur parasysh dispozitat aktuale ligjore dhe organet e përfshira të zbatimit të ligjit, në urdhrin për ekzekutim gjykata duhet të caktojë organin kompetent që do ta kryejë konfiskimin, çka në thelb u shpjegua më lartë, Agjencinë për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar. Gjatë lëshimit të urdhrin për ekzekutim gjykata duhet të ketë parasysh 1) nëse MV-të janë siguruar me masë të përkohshme për sigurim dhe nëse janë transferuar në portofol të sigurt dhe 2) çfarë masë parandaluese është shqiptuar. Nëse MV-të janë siguruar me masë të përkohshme dhe janë transferuar në portofol të sigurt, gjykata në urdhrin për ekzekutim mund të vendosë për shitjen e MV-ve. Nëse MV-të janë siguruar dhe shitur, gjykata mund të vendosë që shuma e marrë nga shitja të transferohet në buxhetin e Maqedonisë së Veriut, e nëse MV-të nuk janë siguruar, atëherë mund të vendosë që MV-të të transferohen në një portofol të sigurt dhe të shiten nëse kjo është ende e mundur duke marrë parasysh fazën e procedurës.

1.3. Monedhat virtuale si provë në procedurat penale

MV-të jo vetëm që kanë vlerë, por duke pasur parasysh teknologjinë ku bazohen, ato mund të jenë burim shumë i dobishëm i të dhënave. Teknologjia “blockchain” që përdoret për shumicën e monedhave virtuale mundëson gjurmimin e historisë së transaksioneve dhe vendosjen e lidhjeve midis të dyshuarve, bashkëpunëtorëve dhe mbështetësve të tyre. Meqenëse MV-të përdoren shpesh për qëllime të pastrimit të parave, analiza e të dhënave që i mbajnë MV-të mund ta tregojë mënyrën e punës (modus operandi), më

126 Neni 540, paragrafi 1 i LPP-së

127 Neni 541 i LPP-së

saktësisht mënyrën e kryerjes të veprës penale në këto raste.¹²⁸ Sipas asaj MV-të mund të përdoren si provë edhe në procedurat penale.

Ky dallim është i rëndësishëm nga pikëpamja juridike pasi që LPP-ja e Republikës të Maqedonisë së Veriut parashikon rregulla të ndryshme procedurale për sekuestrimin e sendeve që mund të shërbejnë si provë në procedurat penale. Sipas nenit 194 të LPP-së, sendet që duhet të sekuestrohen ose që mund të përdoren si provë në procedurën penale do të sekuestrohen përkohësisht dhe do t'i dorëzohen për tu ruajtur nga ana e prokurorit publik ose organit tjetër të përcaktuar me ligj ose ruajtja e tyre do të sigurohet në ndonjë mënyrë tjetër. Urdhri për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve jepet nga gjykata sipas propozimit të prokurorit ose të policisë gjyqësore. Urdhri për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve duhet të përmbajë: a) emrin e gjykatës; b) bazën ligjore për sekuestrimin e përkohshëm, përcaktimin me përkrim të detajuar të sendeve që duhen sekuestruar; c) emrin dhe mbiemrin e personit të cilit duhet t'i sekuestrohen përkohësisht sendet; d) vendin në të cilin duhet që përkohësisht të sekuestrohet sendi; e) afatin në të cilin duhet të bëhet sekuestrimi dhe f) këshillë mbi mjetet juridike në dispozicion kundër urdhrin të gjykatës. Urdhri për sekuestrimin e përkohshëm duhet të përfshijë edhe adresën publike ku do të transferohen MV-të dhe autoritetin kombëtar kompetent që do ta zbatojë sekuestrimin e përkohshëm.

LPP-ja e obligon çdo person që mban sende që duhen sekuestruar sipas KP-së ose sende që mund të përdoren si provë në procedurën penale duhet t'i dorëzojë këto sende. Nëse personi që mban sende të tilla nuk ia dorëzon sendet personit zyrtar që i kërkon ato, mund t'i shqiptohet gjobë në të holla.¹²⁹ Kjo dispozitë mund të përdoret për t'i kërkuar një përdoruesi të MV-ve ta dorëzojë çelësin privat ose portofolin ku janë të vendosura MV-të. Megjithatë, nëse përdoruesi i MV-së është i dyshuari, dënimi në të holla i parashikuar në këtë nen nuk mund t'i shqiptohet atij.

Një dispozitë tjetër që mund të jetë e dobishme për zbulimin e MV-ve është dispozita e nenit 181, paragrafi 2 dhe 184 të LPP-së, që kanë të bëjnë me kërkimin e sistemit kompjuterik dhe të dhënave kompjuterike. Përkufizimi se çfarë është

128 Europol i ka mbështetur Spanjën në shkatërrimin e një organizate kriminale që ofronte shërbime në shkallë të gjerë të pastrimit të krypto-monedhave për organizata të tjera kriminale. Kriminelët zbatuan disa skema të pastrimit të parave që përfshinin transferimin nga monedha fiat në mjete virtuale për të fshehur origjinën e paligjshme të të ardhurave. Disa nga mënyrat e identifikuar të punës përdorën bankomate për krypto-monedha dhe të ashtuquajturin “smurfing”, një metodë kriminale që përdoret për t'i ndarë të ardhurat e paligjshme në shumë më të vogla dhe për t'i vendosur këto shumë të vogla në sistemin financiar për të shmangur njoftimin për transaksionete dyshimta. Më shumë në: <https://www.europol.europa.eu/newsroom/news/cryptocurrency-laundering-service-members-of-criminal-organisation-arrested-in-spain>

129 Neni 194, dhe 195 i LPP-së

sistemi kompjuterik dhe çfarë janë të dhënat kompjuterike është dhënë në KP¹³⁰. Pra, përveç kontrollit shtëpisë dhe personave, gjykata mund të lëshojë urdhër bastisjeje për kontroll të sistemit kompjuterik dhe të dhënave kompjuterit në bazë të kërkesës së arsyetuar të prokurorit publik, edhe nëse ekziston rreziku i zvarritjes së kërkesës së policisë gjyqësore.¹³¹ Kur kryhet kontrolli i një sistemi kompjuterik dhe i të dhënave kompjuterike, me kërkesën e personit që ekzekuton urdhrin për bastisje, personi që e përdor ose që ka qasje në kompjuter ose në një pajisje tjetër ose bartës të të dhënave është i detyruar të sigurojë qasje në to dhe ta japë informacionin e nevojshëm të kërkuar për përmbushjen e papenguar të qëllimeve të kontrollit. Gjithashtu, personi që e përdor kompjuterin ose që ka qasje në të dhe në pajisje të tjera ose bartës të të dhënave është i obliguar që menjëherë t'i ndërmarrë masat për të parandaluar shkatërrimin ose ndryshimin e të dhënave.¹³² Kështu, duke përdorur këtë dispozitë dhe duke pasur parasysh kuptimin e termave, organet e zbatimit të ligjit mund t'i kërkojnë përdoruesit ose mbajtësit të "portofolit të ftohtë" që t'u japin fjalëkalimin për të hyrë në portofol.

Megjithatë, duhet theksuar se nëse bëhet kontrolli i sistemit kompjuterik dhe i të dhënave kompjuterike, që të mund të bëhet sekuestrimi i MV-ve, në kërkesën për lëshimin e urdhrin të kontrollit duhet të përfshihet edhe një kërkesë për sekuestrimin e MV-ve, duke ofruar informacion mbi adresën publike ku do të dërgohen MV-të, autoritetin kombëtar që do ta zbatojë sekuestrimin dhe sasinë e MV-ve që pritet të sekuestrohen. Nëse kjo nuk është bërë dhe urdhri për kontroll nuk përfshin kërkesën dhe informacionin përkatës për sekuestrimin e MV-ve, atëherë duhet të merret një vendim i veçantë i gjykatës për sekuestrimin e MV-ve. Siç u përmend më lart, MV-të mund të sekuestrohen menjëherë edhe nga policia gjyqësore, por duhet të ketë pëlqim shtesë gjyqësor.

Në procedurat penale që përfshijnë MV-të është e diskutueshme nëse prokurorët duhet të përdorin dispozitën e nenit 198 të LPP-së për marrjen e të dhënave përkatëse. Në fakt, neni 198 i LPP-së ka të bëjë me sekuestrimin e përkohshëm të të dhënave kompjuterike dhe kjo dispozitë ka të bëjë me çdo të dhënë të ruajtur në kompjuter dhe në pajisje të ngjashme për përpunimin automatik, gjegjësisht elektronik të të dhënave, pajisjet të cilat shërbejnë për mbledhjen dhe transferimin e të dhënave, bartësit e të dhënave dhe informacionet për parapaguesit që janë në dispozicion të ofruesit të shërbimit.

130 Neni 122, paragrafët 26 dhe 27 të KP-së Gjithashtu, për të kuptuar diapazonin e përkufizimit për "sistemin kompjuterik" mund të shihen edhe Shënimet udhëzuese të Komitetit të Konventës për Krimet Kibernetike (T-CY) mbi termin "sistem kompjuterik" sipas konventës së Budapestit <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016802e79e6>

131 Neni 181 i LPP-së

132 Neni 184, paragrafët 1 dhe 2 të LPP-së

Prokurori ka të drejtë të kërkojë që këto të dhëna të dorëzohen në afatin që ai/ajo e ka caktuar. Prapëseprapë, kjo dispozite është e lidhur me dorëzimin vullnetar të të dhënave, se kur janë në pyetje MV-të, rreziku më i madh është që MV-të të zhvendosen në ndonjë vend tjetër, menjëherë sapo përdoruesi të kuptojë se organet e zbatimit të ligjit tregojnë interes , për këtë arsye është e diskutueshme nëse kjo dispozitë do të mundësojë qasje efektive në të dhënat e kërkuara.

Gjithsesi, neni 198 mund të përdoret për t'u kërkuar ofruesve të shërbimeve - në rastet e MV-ve ata janë platformat e shkëmbimit ose ofruesit e portofolave, të dhëna siç janë p.sh. informacionet e parapagimit që i kanë në dispozicion. Duhet theksuar se ky proces në shumicën e rasteve do të ndiqet nga kërkesa për Ndihmë Ndërkombëtare Juridike, pasi shumica e platformave të shkëmbimeve dhe ofruesve të portofolave ndodhen jashtë vendit. Gjithsesi arsyet ligjore që prokurorët të kërkojnë informacionet e përmendura gjenden në këtë nen. Prokurori ka autorizimin për të përcaktuar afatin në të cilin duhet të dorëzohen të dhënat.

Në Shtojcën I të Doracakut është dhënë një shabllon se çfarë informacioni mund të kërkohet nga platformat e shkëmbimit. Ky shabllon mund të përdoret për marrjen e informacionit nga ofruesit e shërbimeve sipas nenit 198 të LPP-së. Këtu duhet theksuar se kur kërkohet informacion nga ofruesit e shërbimeve, është e dobishme që të kontrollohet politika e privatësisë dhe kushtet për hapjen e një llogarie të përdoruesit tek ofruesit e shërbimeve, pasi atje mund të gjenden të dhëna se cilat janë informacionet e detyrueshme që ofruesit e shërbimeve i kërkojnë nga përdoruesit e tyre, çfarë informacioni ato ruajnë dhe për sa kohë.

Në Shtojcën II të Doracakut është dhënë një shabllon për kërkesën për shqiptimin e masave të përkohshme për sigurimin e MV-ve dhe ky shabllon mund të përdoret për të parashtruar kërkesë për sekuestrimin të përkohshëm të MV-ve në rastet kur MV-të janë gjetur në bazë të fletë urdhëresës për kontrollit të sistemit kompjuterik.

Në Shtojcën III të Doracakut është dhënë shablloni i kërkesës për lëshimin e urdhrit për kontroll të kompjuterit dhe të dhënave kompjuterike, i shoqëruar me kërkesën për sekuestrim të përkohshëm të MV-ve.

2. BAZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE PËR SEKUESTRIMIN E PËRKOHSHËM DHE KONFISKIMIN E MONEDHAVE VIRTUALE QË JANË OBLIGUESE PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË TË VERIUT

Ekzistojnë disa instrumente juridike ndërkombëtare që Republika e Maqedonisë së Veriut i ka ratifikuar, të cilat praktikuesit duhet t'i kenë parasysh kur gjatë procedurave penale hasin me MV.

Një nga instrumentet ndërkombëtare është Konventa e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik e datës 23.11.2001¹³³, e njohur edhe si Konventa e Budapestit për Krimin Kibernetik që është nënshkruar nga Maqedonia e Veriut më 23.11.2001, është ratifikuar më 15.09.2004 dhe ka hyrë në fuqi më 01.01.2005. Republika e Maqedonisë së Veriut nuk ka vendosur asnjë rezervë në lidhje me Konventën dhe ka siguruar vetëm informacione për organin kompetent për implementimin e obligimeve që dalin nga Konventa si dhe pikat e kontaktit të rrjetit 24/7.

Konventat e Budapestit parashikojnë detyrimin për shtetet që të kriminalizojnë veprat kundër sistemeve kompjuterike (qasjen e paligjshme, përgjimin e paligjshëm, ndërhyrjet në të dhënat dhe sistemet etj.) dhe veprat të kryera me anë të kompjuterëve (si mashtrimi, pornografia e fëmijëve dhe shkeljet e të drejtave të pronësisë intelektuale)¹³⁴, të sigurojnë garanci procedurale dhe mjete për sigurimin e provave elektronike (kërkimin dhe sekuestrimin, ruajtjen e menjëhershme të të dhënave etj.)¹³⁵ dhe të angazhohen në bashkëpunim efikas ndërkombëtar përmes një kombinimi të masave të menjëhershme, të përkohshme dhe ndihmës reciproke formale, si dhe pikave për kontakt 24/7.¹³⁶

Nga këndvështrimi i monedhave virtuale, në rastet e marrjes në pyetje të të dyshuarit, kur i dyshuari pranon përdorimin e portofolit dhe jep pëlqim me shkrim për sekuestrimin e MV-së me anë të sistemit të tij kompjuterik, Konventa e Budapestit i mundëson policisë ta bëjë këtë menjëherë, në përputhje me nenin 32 b) të Konventës së Budapestit për Krimin Kibernetik, pa donjë kërkesë tjetër procedurale.

- a) lloji i shërbimit të komunikimit të përdorur, dispozitat teknike të ndërmarra për të dhe periodha e shërbimit;

133 <https://rm.coe.int/1680081561>

134 Kapitulli II, seksioni 1 i Konventës së Budapestit

135 Kapitulli II, seksioni 2 i Konventës së Budapestit

136 Kapitulli III i Konventës së Budapestit

- b) identiteti i parapaguesit, adresa postare ose gjeografike, numri i telefonit dhe numri tjetër për qasje, informacioni për faturën dhe pagesën, që janë në dispozicion në bazë të marrëveshjes ose kontratës së shërbimit;
- c) çdo informacion tjetër në vendin e instalimit të pajisjeve të komunikimit, që është në dispozicion në bazë të marrëveshjes ose kontratës së shërbimit.

Paragrafi 177 nga Raportit Shpjegues i Konventës së Budapestit¹³⁷ më tej vë në dukje se informatat parapaguese u referohen çdo informacioni të mbajtur nga administrata e ofruesit të shërbimit në lidhje me një parapagues të shërbimeve të tij. Informatat parapaguese mund të përmbahet në formën e të dhënave kompjuterike ose në çdo formë tjetër, siç janë regjistrimet në letër. Duke qenë se informacionet parapaguese përfshin forma të tjera të dhënash përveç të dhënave kompjuterike, në nen është përfshirë një dispozitë e veçantë për të trajtuar këtë lloj informacioni. “Parapaguesi” synon të përfshijë një spektër të gjerë klientësh të ofruesit të shërbimeve, duke filluar nga personat që kanë parapagime me pagesë, tek ata që paguajnë mbi bazën e përdorimit, e deri tek ata që marrin shërbime falas. Informatat parapaguese përfshijnë informacion në lidhje me personat që kanë të drejtë të përdorin llogarinë e parapaguesit.

Konventa e Budapestit gjithashtu i përkufizon ofruesit e shërbimeve¹³⁸, duke deklaruar se nën “ofrues i shërbimit” nënkuptohet:

- a) çdo subjekt publik ose privat që u ofron përdoruesve të shërbimit të tij mundësinë për të komunikuar me anë të një sistemi kompjuterik, dhe
- b) çdo subjekt tjetër që përpunon ose ruan të dhëna kompjuterike në emër të këtij shërbimi të komunikimit ose përdoruesve të këtij shërbimi.

Nga këndvështrimi i MV-ve, të gjithë ofruesit e shërbimeve, si ofruesit e portofolave dhe platformat e shkëmbimit, janë të detyruar ta japin informacionin për parapaguesin që e posedojnë, kështu që dispozitat e Konventës së Budapestit mund të përdoren si bazë ligjore për të kërkuar informatat parapaguese.¹³⁹

Duhet të theksohet gjithashtu se Konventa e Budapestit mund të përdoret si bazë për të kërkuar dhe ofruar ndihmë ndërkombëtare juridike në marrjen e informacionit dhe provave të rëndësishme për hetimin penal që përfshin monedha virtuale.¹⁴⁰

Sa i përket instrumenteve të tjera ndërkombëtare që i obligojnë autoritetet e Maqedonisë së Veriut, vlen të përmendet se të gjitha instrumentet ndërkombëtare

137 <https://rm.coe.int/16800cce5b>

138 Neni 1 i Konventës së Budapestit

139 Më shumë detaje në lidhje me urdhrat për informacionin për parapaguesit mund të gjenden në Shënimin Udhëzues të T-CY nr.10 <https://rm.coe.int/16806f943e>

140 Kapitulli III i Konventës së Budapestit

që vendosin detyrimin për hetimin dhe ndjekjen penale të aktiviteteve kriminale që bëjnë pjesë në diapazonin e konventave dhe parashikojnë sekuestrimin dhe konfiskimin e sendeve të përdorura ose të dala nga kryerja e veprës penale si dhe dobive pronësore të fituar nga kryerja e veprës penale¹⁴¹, në fakt vendosin detyrimin edhe për sa i përket MV-ve, pasi, siç shpjegohet, MV-të mund të paraqiten në cilën do nga vetitë e përmendura. Pra, të gjitha këto instrumente ndërkombëtare mund të referohen edhe si baza ligjore për ndërmarrjen e veprimeve hetimore, parandaluese dhe represive në procedurat penale në lidhje me MV-të.

3. SFIDAT PRAKTIKE LIDHUR ME SEKUESTRIMIN E PËRKOHSHËM DHE KONFISKIMIN E MONEDHAVE VIRTUALE NË PROCEDURAT PENALE DHE PYETJET E HAPURA

Organet e zbatimit të ligjit në Maqedoninë e Veriut (policia gjyqësore dhe prokurorët publikë) kanë mundësi ligjore të kërkojnë sekuestrimin e përkohshëm dhe konfiskimin e monedhave virtuale, ndërsa gjykatat kanë bazën ligjore për t'i lejuar masat e tilla. Megjithatë, edhe përkundër mundësisë për përdorimin e dispozitave aktuale ligjore për ballafaqimin me monedhat virtuale në procedurat penale, mbetet pa përgjigje pyetja se si do të veprohet në praktikë.

Pra, praktikuesit përballen me dilemën a) kush do ta zbatojë vendimin e gjykatës për sekuestrimin e përkohshëm ose konfiskimin e monedhave virtuale dhe b) si do të bëhet kjo.

Sipas kornizës ekzistuese ligjore, organi kompetent për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës për sekuestrim ose për konfiskim të sendeve ose pasurisë në përgjithësi, duke përfshirë edhe MV-të, siç u shpjegua më lartë, është Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar. Gjykata mund të caktojë

141 Konventa e Strasburgut - Konventa për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Dobive Pronësore nga Vepra Penale (CETS nr. 141) <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treaty-num=141>; Konventa e Varshavës - Konventa për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Dobive Pronësore nga Vepra Penale dhe Financimin e Terrorizmit <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treaty-num=198>; Konventa e së Drejtës Penale për Korrupsionin (CETS nr. 173) - <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treaty-num=173>; Konventa e OKB-së Kundër Krimit të Organizuar Transnacional - https://www.unodc.org/documents/mid-dleeastandnorthafrica/organised-crime/UNITED_NATIONS_CONVENTION_AGAINST_TRANSNATIONAL_ORGANIZED_CRIME_AND_THE_PROTOCOLS_THERETO.pdf etj.

një autoritet tjetër nëse e sheh më të përshtatshme, por rregulli i përgjithshëm është se, Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar është kompetente për sekuestrimin e përkohshëm dhe konfiskimin e MV-ve. Gjithsesi, përsëri duhet të referohet se kur bëhet fjalë për sekuestrimin e përkohshëm të MV-ve, kompetencë për sekuestrimin e përkohshëm të MV-ve, ka edhe policia gjyqësore.

Edhe nëse pranojmë se këtë dilemë e ka zgjedhur ligjvënësi, përkatësisht se është përgjigjur në pyetjen e organit kompetent për zbatimin e sekuestrimit dhe konfiskimit, mbetet e hapur pyetja se si do të zbatohet në praktikë vendimi i gjykatës për sekuestrimin e përkohshëm apo konfiskimin e monedhave virtuale.

Për të zbatuar në mënyrë efektive vendimin e gjykatës për sekuestrimin e përkohshëm ose konfiskimin e MV-ve, MV-të duhet të ruhen dhe të sigurohen. Kjo bëhet duke i transferuar MV-të nga portofoli i përdoruesit në një portofol të sigurt. Problemi kryesor për momentin është se nuk ka asnjë organ për zbatimin e ligjit që posedon portofol të sigurt ku mund të transferohen MV-të, e as që është parashikuar hapja e portofolit. Nëse MV-të nuk transferohen në një portofol të sigurt, duke pasur parasysh se ato mund të qasen nga distanca, nga pajisje të ndryshme, përdoruesi ka të ngjarë t'i heqë ato në një portofol tjetër ose t'i shesë, duke i bërë të kota përpjekjet e organeve për zbatimin e ligjit.

Duhet të theksohet se sekuestrimi i një kompjuteri (që përmban portofol softuerik), një pajisjeje për portofol harduerik dhe një portofoli prej letre, për shembull, nuk është i mjaftueshëm. Gjithashtu, kopjimi i një skedari DAT (që përmban një portofol) nga një kompjuter nuk do të jetë i mjaftueshëm. Sekuestrimi i një kompjuteri, apo i një portofoli harduerik, ... nuk është i barabartë me sekuestrimin e kripto-monedhave.¹⁴²

Ruajtja dhe sigurimi i MV-ve nuk është pjesë e ndonjë strategjie kombëtare ose ndonjë lloj tjetër dokumenti të politikave që përcakton llojin e portofolit të kontrolluar nga organet që duhet të hapet dhe do të duhet të përdoret si portofol i sigurt. Kështu, organet e zbatimit të ligjit kanë një spektër të gjerë të mundësive kur bëhet fjalë për hapjen dhe menaxhimin e portofolit të sigurt.

Përveç ruajtjes dhe sigurimit, MV-të mund edhe të konvertohen. Siç u shpjegua më lartë, konvertimi i MV-ve do të thotë që ato duhet të shiten dhe paratë duhet të vendosen në një llogari të veçantë. Nëse analizojmë dispozitat aktuale ligjore, Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, me pëlqimin paraprak të gjykatës, mund të marrë vendim për shitjen e sendeve të tundshme të sekuestruara nëse vlerëson se ruajtja e sendit ia zvogëlon vlerën ose shpenzimet për ruajtjen e tyre

142 "Udhëzues për sekuestrimin e kripto-monedhave", Zyra e Programit të Krimin Kibernetik e Këshillit të Evropës, shkurt 2021, fq. 24

janë në mënyrë disproporcionale të larta.¹⁴³ Duke pasur parasysh se sipas Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore, sende të tundshme janë ato që mund të zhvendosen nga një vend në tjetrin, pa e dëmtuar thelbin e tyre¹⁴⁴, MV-të mund të konsiderohen sende të tundshme dhe sipas asaj mund të shiten edhe nëse janë të sekuestruara përkohësisht.

Megjithatë, këto dispozita nuk i kapërcejnë vështirësitë që rrjedhin nga nevoja për t'i siguruar MV-të. Në rastet kur merret vendim për shitjen e MV-ve, fillimisht MV-të duhet të transferohen në një portofol të sigurt dhe më pas të shiten. Në fakt, Agjencia mund të vendosë t'i shesë MV-të e sekuestruara përkohësisht, por për këtë duhet pëlqimi i Gjykatës. Kjo do të thotë se Agjencia duhet të bëjë kërkesë në gjykatë për të kërkuar pëlqimin për shitjen e MV-ve në rastet kur janë plotësuar kushtet ligjore. Duhet të theksohet se këto aktivitete ndodhin pasi MV-të të jenë sekuestruar përkohësisht dhe të jenë transferuar në një portofol të sigurt.

Përkundër faktit se nuk ka dispozita të veçanta ligjore për hapjen dhe menaxhimin e një portofoli të sigurt, secili nga organet e përfshira të zbatimit të ligjit, mund të marrë vendim për hapjen e një portofoli të këtillë me qëllim të plotësimit të kompetencës së tyre ligjore. Në fakt, sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, çdo gjë që nuk është e ndaluar me Kushtetutë dhe ligj është e lejuar¹⁴⁵, kështu që organet e zbatimit të ligjit janë të lira t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, të cilat nuk janë të ndaluara me Kushtetutë apo ligj, për të siguruar ekzekutimin e plotë të kompetencës së tyre. Për më tepër, instrumentet juridike ndërkombëtare që i ka pranuar Maqedonia e Veriut kërkojnë nga autoritetet kombëtare që t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që do të sigurojnë zbatimin e plotë të tyre. Kështu, secili prej organeve të zbatimit të ligjit mund të zgjedhë të hapë portofol të sigurt dhe t'i zbatojë procedurat/protokollet e brendshme që e rregullojnë hapjen dhe menaxhimin e portofolit të sigurt. Në hartimin e procedurave/protokolleve të brendshme vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet çështjes së llojit të portofolit të sigurt, qasjes në portofol, tarifave të transaksionit dhe menaxhimit të mëtejshëm të MV-ve.

Pyetja që duhet t'ju drejtohet nga ligjvënësi është se çfarë ndodh me MV-të pas sekuestrimit përfundimtar të tyre. Sipas legjislacionit ekzistues, gjykata është autoriteti kompetent që vendos për shitjen e MV-ve, por kjo është vetëm

143 Neni 48 i Ligjit për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, Dobisë Pronësore dhe Sendeve të Konfiskuara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse.

144 Neni 13 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore (Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 18/01, 92/08, 139/09, 35/10)

145 Neni 8 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 1/92, 31/98, 91/01, 84/03, 107/05, 3/09, 49/11, 6/19, 39/19)

kompetencë diskrecionale e gjykatës dhe shitja nuk është e detyrueshme. Në rastet kur nuk ka vendim gjykatë për shitjen e MV-ve, është e paqartë se çfarë duhet të bëjë Agjencia. Kështu, do të ishte me rëndësi të madhe për praktikuesit nëse do të ekzistonte një rregull i përgjithshëm që do ta përcaktonte fatin e MV-ve pas konfiskimit të tyre. Për më tepër, mungesa e rregullave mund të shihet si një mundësi që Agjencia t'i mbajë MV-të dhe të vendosë t'i shesë ato më vonë, gjë që mund të lërë hapësirë për keqpërdorime dhe mund të çojë në humbje financiare.

V. Përvoja e Republikës së Sllovenisë në trajtimin e monedhave virtuale në procedurat penale

Meqenëse nuk ka dispozita të veçanta që do të rregullonin trajtimin e MV-ve në procedurat penale në Slloveni, Prokurori i Përgjithshëm i Shtetit të Republikës së Sllovenisë miratoi Vendimin nr. VDT-Tu-15-5/4/2019 për formimin e një grupi punues përgjegjës për hartimin e udhëzimeve për veprim në rastet penale që lidhen me monedhat virtuale. Grupi punues përbëhej nga një prokuror, dy këshilltarë ligjorë dhe dy hetues policorë. Grupi i punës ka studiuar literaturën e specializuar që ishte në dispozicion në këtë fushë, si dhe shembujt praktik ekzistues lidhur me monedhat virtuale, dhe ka përgatitur një rekomandim jodetyrues për prokurorët. Udhëzuesi për hetimin e veprave penale në lidhje me monedhat virtuale (në tekstin e mëtejme: Udhëzuesi) është miratuar në nëntor të vitit 2019¹⁴⁶. Seksionet relevante të Udhëzimit janë shpjeguar më poshtë.

1. KORNIZA LIGJORE

Monedha virtuale si e tillë përcaktohet në nenin 3, pika 48 e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit (më tej ZPPDFT-1B)¹⁴⁷:

“- monedha virtuale është një përfaqësim digjital i vlerës që nuk është emetuar ose garantuar nga një bankë qendrore ose autoritet publik, nuk është domosdoshmërisht e lidhur me një monedhë të përcaktuar ligjërisht dhe nuk e ka statusin ligjor të monedhës ose parasë, por që pranohet nga personat fizikë ose juridikë si mjet këmbimi dhe që mund të transferohet, ruhet dhe tregtohet në mënyrë elektronike.”

Ky përkufizim i Direktivës (EU) 2018/843 (AMLD V) u transportua në rendin ligjor slloven me ndryshimin e ZPPDFT-1B, që vlen nga 11 korriku i vitit 2020.

146 Udhëzuesi për hetimin e veprave penale në lidhje me monedhat virtuale, ref. nr. Ktr-zb-9/11/2019/AF-nf, Zyra e Prokurorit Suprem të Shtetit të Republikës së Sllovenisë, nëntor 2019

147 Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 68/16, 81/19, 91/20 dhe 2/21

Monedhat virtuale nuk konsiderohen mjete financiare në Republikën e Sllovenisë. Siç përcaktohet në pikën pesë të nenit 4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, Shërbimet e Emetimit të Parasë Elektronike dhe Sistemeve të Pagesave (në tekstin e mëtejshëm: ZPLASSIED)¹⁴⁸, mjetet financiare i përfshijnë kartë-monedhat, monedhat, para të llogarive (book money) dhe paratë elektronike. Meqenëse monedhat në fjalë, siç do të sugjeronte emri i tyre, janë virtuale (më konkretisht shënime digjitale të vlerës monetare analoge), ndërsa kartë-monedhat dhe monedhat emetohen nga Banka e Sllovenisë (në tekstin e mëtejshëm: BS) dhe Banka Qendrore Evropiane (BQE), monedhat virtuale nuk mund të përcaktohen në përputhje me këtë, edhe pse vlera e tyre mund të ruhet në një medie të krahasueshme me një kartë-monedhë ose monedhë (p.sh., letër [portofol letre] ose monedhë). Në mënyrë të ngjashme, ato nuk mund të përkufizohen si para të llogarive, gjegjësisht si para të futura në llogaritë e institucioneve të pagesave. Siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 24 të ZPLASSIED, institucionet e pagesave janë persona juridikë të themeluar në Republikën e Sllovenisë që kryejnë të paktën një pjesë të aktiviteteve të tyre të pagesave në Republikën e Sllovenisë dhe kanë marrë autorizimin e duhur nga BS-ja; Megjithatë, kompanitë që emetojnë, menaxhojnë ose operojnë monedha virtuale, zakonisht nuk i plotësojnë këto kushte. Paraja elektronike i referohet vlerës monetare të ruajtur në formën e pretendimit të poseduesit të parasë elektronike ndaj emetuesit të parasë elektronike, emetohet nga emetuesi i parasë elektronike në bazë të pranimit të mjeteve financiare me qëllim të kryerjes së transaksioneve të pagesave dhe pranohet si mjet pagese nga një person i ndryshëm nga emetuesi i parasë elektronike (pika 11 e nenit 4 të ZPLASSIED). Prandaj, monedhat virtuale nuk mund të përkufizohen si para elektronike, pasi zotëruesit e tyre nuk kanë pretendime ndaj emetuesve të tyre (ata kanë një pretendim ndaj përdoruesve të panjohur të monedhës virtuale), e po ashtu edhe meqenëse kompanitë që emetojnë, menaxhojnë ose operojnë monedhat virtuale nuk janë emetues të parasë elektronike, siç përcaktohet në nenin 158 të ZPLASSIED.

Monedhat virtuale gjithashtu nuk mund të përkufizohen si para të huaja të gatshme, siç përcaktohet në nenin 4 të Ligjit për Punë Devizore (ZDP-2)¹⁴⁹, pasi ato nuk janë kartë-monedha dhe monedha në valutë të huaj, të emetuara nga një bankë qendrore ose shtet. Për më tepër, monedhat virtuale nuk janë letra me vlerë të pa materializuara (neni 4 i Ligjit për Letrat me Vlerë të Pa materializuara - ZNVP-1)¹⁵⁰, duke qenë se prej tyre nuk rrjedh asnjë detyrim,

148 Ligji për Shërbimet e Pagesave, Shërbimet e Emetimit të Parave Elektronike dhe Sistemeve të Pagesave, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 68/16, 7/18, 9/18 dhe 102/20

149 Ligji për Punë Devizore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 81/08, 85/09 dhe 109/12

150 Ligji për Letrat me Vlerë të Pamaterializuara, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr.75/15, 74/16 – ORZNPV48, 5/17, 15/18 dhe 43/19

emetuesit e tyre nuk janë të obliguar me asnjë detyrim dhe ato nuk krijohen me futjen në regjistrin qendror të letrave me vlerë të pa materializuara. Së fundmi, monedhat virtuale, siç përcaktohet në pikën 48 të nenit 3 të ZPPDFT-1, nuk janë instrumente financiare, siç përcaktohet në paragrafin dy të nenit 7 të Ligjit për Tregun e Instrumenteve Financiare (ZTFI-1)¹⁵¹, pasi nuk janë letra me vlerë të transferueshme, instrumente të tregut të parave ose instrumente financiare derivative.

Që nga miratimi i euros, mjet i ligjshëm për pagesë në Republikën e Sllovenisë janë kartë-monedhat dhe monedhat në euro (neni 3 i Ligjit për Futjen e Euros - në tekstin e mëtejshëm: ZUE¹⁵²), që nuk e përjashton përdorimin e monedhave virtuale për qëllime biznesi. Meqenëse ZUE nuk e ndalon në mënyrë eksplicite një përdorim të tillë, personat mund të bien dakord t'i përdorin monedhat virtuale si mjet pagese. Në fakt, përmbushja është ekzekutimi i asaj që është përmbajtje e obligacionit (paragrafi 1 i nenit 282 të Ligjit për Obligacionet - në tekstin e mëtejshëm: OZ)¹⁵³, kurse obligacioni mund të jetë i tillë që dikush të japë diçka (paragrafi 1 i nenit 34 të tij). Meqenëse shprehja “të japë diçka” është e papërcaktuar dhe mund të realizohet në mënyra të ndryshme, dhe meqenëse transferimi i një monedhe virtuale nuk është i pamundur, i palejueshëm, i paspecifikuar ose i papërcaktuar (neni 35 i OZ), përfundimi logjik do të ishte se monedhat virtuale mund të përdoren për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nëse palët kanë rënë dakord për një përdorim të tillë. Ky përfundim mund të arrihet edhe në bazë të pikës 48 të nenit 3 të ZPPDFT-1, e cila parashikon se monedhat virtuale mund të përbëjnë një mjet të drejtpërdrejtë pagese ndërmjet subjekteve që e miratojnë atë. I tillë është edhe qëndrimi i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GjDBE) në Rastin C-264/14 (Skatteverket kundër David Hedqvist), duke vendosur se Bitcoinin është një mjet i ligjshëm pagese, por jo pronë materiale.

Në Udhëzues sugjerohej se për nga karakteristikat juridike të veprës penale, monedhat virtuale nuk mund të konsiderohen si pasuri e tundshme ose objekt fizik i pavarur. (Neni 15 i Ligjit për Pronësinë – në tekstin e mëtejshëm: SPZ¹⁵⁴ dhe paragrafi gjashtë i nenit 99 të Kodit Penal – në tekstin e mëtejshëm: KZ-1¹⁵⁵), meqenëse ato nuk mund të materializohen (p.sh., të futen në kartë-monedha ose monedha me një vlerë të atribuar), që është parakushti bazë për përcaktimin e “një sendi”.

151 Ligji për Tregun e Instrumenteve Financiare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 77/18, 17/19, 66/19 dhe 123/21)

152 Ligji për Miratimin e Euros, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 114/06)

153 Ligji për Obligacionet, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 97/07, 64/16 dhe 20/18 – OROZ631)

154 Ligji për Pronësinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 87/02, 91/13 dhe 23/20)

155 Kodi Penal, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 50/12, 6/16, 54/15, 38/16, 27/17, 23/20, 91/20 dhe 95/21)

Megjithatë, Udhëzuesi thekson se monedhat virtuale meritojnë një status të veçantë (sui generis), të ngjashëm me të drejtat pronësore, pasi ato janë të transferueshme, kanë një vlerë ekonomike objektivisht të identifikueshme që mund të shprehet në para dhe mund të arkëtohen ose të përdoren ndryshe për qëllime biznesi. (neni 22 i SPZ). Për sa i përket parimit të sigurisë juridike të ligjit penal (**lex certa**), ligjvënësi do të duhej ta ndryshonte KZ-1 dhe të jepte një përkufizim më specifik të monedhave virtuale, sipas shembullit të energjisë së prodhuar ose të akumuluar për qëllime të ndriçimit, ngrohjes, rrezatimit, vozitjes, lëvizjes ose transmetimit të zërit, fotografisë ose tekstit në distanca (paragrafi 6 i nenit 99 të KZ-1); klasifikimi ligjor i vjedhjes (neni 204 dhe nenet e tjera të tij) nuk do të ishte i mundur.

Megjithatë, pas miratimit të Udhëzuesit, Gjykata Supreme e Republikës së Sllovenisë procedoi një rast ku i akuzuari ishte dënuar për veprën penale të Përvetësimit, në bazë të nenit 208 të KZ-1, ku i akuzuari kishte përvetësuar në mënyrë të paligjshme paratë të llogarisë të palës së dëmtuar. Gjykata Supreme e Republikës së Sllovenisë vendosi¹⁵⁶ se pamja e jashtme e parave në formë materiale ose jo materiale nuk mund të jetë vendimtare për mbrojtjen e saj penale, pasi siç është e qartë edhe nga titujt e Kapitullit 23 të Kodit Penal, që përmbajnë vepra të këtij lloji, pasuria e mbrojtur është pronë e huaj dhe akti kryesor i ekzekutimit të tij është privimi i tij nga zotërimi i shfrytëzuesit ose përvetësimi i tij. Pasuria që ndikohet dhe mbrohet nga ligji penal është pasuria në kuptimin e pronësisë, si e drejtë themelore e pronës, të cilën autori ia privon shfrytëzuesit, qoftë duke përvetësuar para të gatshme ose duke përvetësuar para të llogarisë, ose në të dyja rastet duke i mbajtur ato. Prandaj, është e nevojshme të biem dakord se nuk është në përputhje me ligjin të bëhet dallimi midis koncepteve të parasë «materiale» (të prekshme) dhe parasë së llogarisë në mënyrën e përdorur në aktgjykimin e ankimit¹⁵⁷, dhe se një interpretim i tillë do ta bënte të pamundur ofrimin e mbrojtjes ligjore efektive dhe gjithëpërfshirëse kundër tjetërsimit dhe veprave të tjera të lidhura me to. Edhe pse ky aktgjykim nuk ka të bëjë me monedhat virtuale, interpretimi i “prekshmërisë” mund të zbatohet edhe për monedhat virtuale, duke sugjeruar se edhe vepra penale e vjedhjes do të ishte e mundur pa ndryshimin e dispozitave aktuale të KZ-1.

156 Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Sllovenisë, ref. nr. I Ips 21072/2014 i datës 15 tetor 2020.

157 Aktgjykimi i Gjykatës së Lartë në Maribor, ref. nr. IV Kp 21072/2014 - aktgjykimi u bazua në interpretimin se duhet kushtuar vëmendje dallimit ndërmjet rasteve në të cilat paratë në kartë-monedha dhe monedha mund të jenë materiale (të prekshme) dhe, rrjedhimisht, mund të lëvizin pa e dëmtuar thelbin e tyre, dhe rasteve në të cilat një prekshmëri e tillë nuk është e mundur. Aktgjykimi vuri në dukje se thelbi i gjërave, përveç imagjinimeve të përmendura në nenin 99, pika 6, të KZ-1, qëndron në aspektin trupor të tyre, duke iu referuar përkufizimit të konceptit të sendit në nenin 15 të Kodit Civil, që nuk ndodh me disa lloje parash (para të llogarisë). Ai shpjegoi se, sipas përshkrimit të veprës penale, paratë në fjalë në rastin konkret ishin para të përvetësuara në formën e dërgesës, pra para të llogarive si të dhëna, dhe jo një gjë e prekshme në formë fizike, të cilat ato para nuk i kanë në pamje.

2. HETIMI DHE SIGURIMI I INFORMACIONIT

Duke marrë parasysh që transaksionet e monedhave virtuale janë zakonisht publike dhe të verifikueshme (përjashtimet përfshijnë Monero [XMR], ZCash [ZEC] dhe disa monedha të tjera më pak të njohura), hetimi i veprave penale mund të përdorë metoda tradicionale si dhe qasjen “ndiqi paratë”, nëpërmjet inspektimit të librave të llogarive ose blloqeve publike (p.sh. duke përdorur softuerin Chainalysis). Meqenëse përdoruesit e monedhave virtuale janë anonimë, qëllimi i kësaj qasjeje është zbulimi i identitetit të një autori të panjohur ose lidhja e një autori të njohur me përfitimet e paligjshme, gjë që mund të arrihet: **a) duke identifikuar ofruesin e portofolit elektronik të autorit, b) duke identifikuar adresën IP të përdoruesit të një portofoli të caktuar elektronik dhe c) sigurimin e të dhënave për tregtimin nga e llogaria e kryerësit nga ofruesit e shërbimeve për shkëmbim online (platformat e shkëmbimit).**

Qëllimi i **masës së parë (a)** është të sigurohen sa më shumë të dhëna që është e mundur, që janë krijuar përmes përdorimit të një portofoli elektronik për monedhat virtuale. Disa ofrues të shërbimeve mbledhin një spektër të gjerë të informatave për përdoruesit, si: emri personal, adresa gjeografike ose elektronike, numri i telefonit, kopje të skenuar letërnjoftimit ose një faturë që e vërteton vendbanimin, llogaria e transaksionit ose numri i kartës së debitit, adresat IP dhe koha e qasjes në portofol, lloji dhe versioni i pajisjes, sistemi i saj operativ dhe shfletuesi i internetit (për portofolat elektronike). Nëse transaksionet e monedhës virtuale janë të lidhura me një adresë specifike të portofolit për të zbuluar ofruesin e saj, disa nga informacionet e përmendura më sipër mund të merren në bazë të dispozitave të neneve 149b dhe 149ç të Ligjit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejshëm: ZKP¹⁵⁸). Nenet e përmendura përbëjnë bazën ligjore për sigurimin e të dhënave nga rrjeti i komunikimit elektronik.¹⁵⁹ Para kësaj, kushtet e përgjithshme ose politika e privatësisë së ofruesit të një portofoli elektronik (d.t.th. ofruesit të shërbimit të informacionit) duhet të shqyrtohen për të konstatuar nëse ofruesi mbledh të dhëna personale dhe të dhëna të trafikut për përdoruesit e tyre, cilat të dhëna i mbledh dhe për sa kohë i ruan ato (p.sh. duke e kontrolluar ueb-faqen e tyre). Vetëm në rast se vërtetohet se ofruesi i shërbimeve mbledh ndonjë nga informatat e nevojshme mund të jenë caktuar masa specifike (p.sh. në bazë të nenit 149ç të ZKP-së për emrin personal, adresën gjeografike ose elektronike, numrin e telefonit, kopjen e skenuar letërnjoftimit ose një faturë që e vërteton vendbanimin, llogarinë e transaksionit ose numrin e kartës së debitit; nenit 149b të tij për adresat IP,

158 Ligji i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 32/12, 47/13, 87/14, 8/16, 64/16, 65/16, 66/17 – ORZKP 153,154, 22/19, 55/20, 89/20, 191/20, 200/20 dhe 105/21)

159 Duhet të theksohet se Ligji i Procedurës Penale i Republikës së Sllovenisë nuk i përmend fare monedhat virtuale, kështu që dispozitat ekzistuese të ligjit përdoren në rastet e monedhave virtuale.

kohën e qasjes në portofol, llojin dhe versionin e pajisjes, sistemin operativ dhe shfletuesin e internetit ose të kërkohet ruajtja paraprake e të dhënave të kërkuara (nenit 149e të tij). Në të kundërt këto masa nuk janë të përshtatshme pasi nuk mund të arrihen qëllimet e tyre.

Përderisa i ndjek paratë në “blockchain”, një softuer i përshtatur në disa raste mund ta zbulojë drejtpërdrejt adresën IP të portofolit elektronik që i përmban njësitë e marra të monedhës virtuale (**masa b**). Në këtë rast, mjete softuerik WHOIS mund të përdoret për të përcaktuar ofruesin ose operatorin që e menaxhon adresën IP, i cili më pas e transmeton identitetin e përdoruesit aktual. Nëse mjete softuerik tregon se adresa IP menaxhohet nga një VPN ose ofrues shërbimi VPS, termat dhe kushtet e tyre të përgjithshme ose politika e tyre e privatësisë duhet të shqyrtohen (p.sh. duke e vizituar ueb-faqen e tyre) për të konstatuar nëse ata mbledhin të dhëna personale për përdoruesit e tyre dhe për sa kohë i ruajnë ato. Në raste të tilla, rekomandohet që këto të dhëna të kërkohen nga ofruesi i shërbimit ose operatori i informacionit duke i zbatuar masat e përcaktuara në nenin 149b të ZKP-së, si dhe nenin 220 të tij në lidhje me nenet 29 dhe 31 të Konventës për Krimin Kibernetik. (p.sh. për kopjet identike (mirror images) të serverëve virtualë privatë të marrë me qira ose kopjet identike (mirror images) të mediave të të dhënave), përndryshe (ose në rastet kur adresat IP drejtohen përmes rrjeteve Tor, I2P ose Freenet) kjo masë nuk është e përshtatshme pasi identitetet e përdoruesve nuk mund të përcaktohen në mënyrë efektive.

Mjete më optimal për mbledhjen e provave ofrohet nga **masa e tretë (c)**. Nëse një inspektim i “blockchain”-it tregon se njësitë e monedhës virtuale janë transferuar në një adresë të një portofoli elektronik të siguar nga një shkëmbim online, - platformë shkëmbimi - atëherë, duke i kombinuar masat e përcaktuara në nenet 149b (149e në rastet urgjente) dhe 156 të ZKP-së, nga platformat e shkëmbimit mund të kërkohet që t’i transmetojë të gjitha të dhënat personale, të dhënat e trafikut dhe ato financiare të krijuara nga përdoruesit përderisa i kanë përdorur shërbimet e platformës të shkëmbimit. Prandaj ne propozojmë që në rastet kur njësitë e monedhës virtuale janë transferuar në një adresë të një portofoli elektronik të ofruar nga një shkëmbim (bursë) online, të shqyrtohen termat dhe kushtet e përgjithshme ose politika e privatësisë së kësaj të fundit (p.sh. duke e vizituar ueb-faqen) dhe më pas, varësisht nga grupi i të dhënave të ruajtura, të zgjidhet një masë e përshtatshme. Në bazë të paragrafit 5 të nenit 156 të ZKP-së, policia do të mund t’i kërkojë të dhënat personale (më së shpeshti emrin personal, adresën gjeografike ose elektronike, numrin e telefonit, kopjen e skenuar letërnjoftimit ose një faturë që e vërteton vendbanimin, llogarinë e transaksionit ose numrin e kartës së debitit) nga kompanitë që emetojnë, menaxhojnë ose operojnë monedha virtuale. Në raste të tjera, gjyqtari hetues do të duhet të lëshojë një urdhër gjykatë për marrjen e të dhënave të trafikut (adresat IP, kohën e qasjes në portofol, llojin dhe versionin

e pajisjes, sistemin operativ dhe shfletuesin e internetit) në bazë të nenit 149b të tij dhe/ose për marrjen e të dhënave financiare sipas paragrafit 1 dhe 3 të nenit 156 të tij.

3. SIGURIMI I KËRKESAVE DHE KONFISKIMI I PASURISË

Meqenëse monedhat virtuale janë të krahasueshme me të drejtat pronësore, dobisë pronësore në formë të monedhave virtuale mund të konfiskohen nga autorët e veprave penale. Siç parashikohet në paragrafin 1 të nenit 75 të KZ-1, dobisë pronësore të fituara nëpërmjet ose për shkak të kryerjes së një veprave penale do të konfiskohen (ndër të tjera, por kryesisht) nga autori ose marrësi i përfitimit. Kjo masë për nga natyra është më e afërt me një sanksion civil sesa me një sanksion penal, pasi qëllimi i saj është arritja e kthimit, gjegjësisht rikthimi i pronës (mjeteve) dhe kthimi në gjendjen para kryerjes së veprës penale¹⁶⁰. Kjo mund të arrihet në emër të palës së dëmtuar edhe me konfiskimin e monedhave virtuale nga autori ose marrësi. Në raste të tilla, procedura penale mund të përfshijë sigurimin e përkohshëm të kërkesave për konfiskimin e dobisë pronësore (neni 109, paragrafi 1 i nenit 502 të ZKP-së), pasi që monedhat virtuale e lejojnë atë.

Siç u përmend më lart, njësitë e monedhës virtuale mund të konsiderohen si pronë e një individi, veçanërisht për shkak të vlerës së tyre; masat specifike mund të shqiptohen duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Zbatimin dhe Sigurimin e Kërkesave (ZIZ). Nëse konstatohet se autori ose marrësi ka një llogari përdoruesi të hapur në një kompani që emeton, menaxhon ose operon me monedha virtuale (d.t.th. një organizatë për transaksione të pagesave), gjykata mund ta urdhërojë kompaninë që të parandalojë autorin ose çdo person të autorizuar nga autori, që t'i përdorë njësitë e monedhës së tyre virtuale.

Masa e përmendur është e zbatueshme vetëm nëse mjetet financiare janë deponuar në një llogari tregtare platformë shkëmbimi të identifikueshëm në internet ose të një kompanie që emeton, menaxhon ose operon monedha virtuale. Në raste të tjera, kur njësitë e monedhës virtuale depozitohen në portofolin elektronik të autorit ose të marrësit, dhe policia ka sekuestruar pajisje elektronike ose portofola fizike (neni 220 i ZKP-së), nuk do të thotë domosdoshmërisht se edhe njësitë në fjalë janë sekuestruar. Në fakt, mënyra e tillë e konfiskimit paraqet rrezik sigurie, pasi dikush që vepron në emër të autorit të veprës penale mund të hyjë në portofolin elektronik të këtij të fundit, të

¹⁶⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Sllovenisë, ref. nr. VSRS I Ips 19290/2017.

sekuestruar në formën e tij fizike, dhe të transferojë në mënyrë të pakthyeshme para prej tij. Prandaj ne rekomandojmë që policia të kërkojë menjëherë leje nga përdoruesit e njohur dhe ata që janë në dispozicion të një portofoli elektronik ose një urdhër paraprak me shkrim (paragrafi dy i nenit 219a të ZKP) ose një urdhër urgjent me gojë (paragrafi pesë i nenit 219a të tij) nga gjyqtari hetues, pasi kjo është mënyra e vetme për të hyrë ligjërisht në sistemin elektronik të portofolit. Më pas, janë në dispozicion dy opsione, zgjedhja e të cilave duhet të varet nga portofoli elektronik që e ka zgjedhur përdoruesi.

Opsioni i parë

Në bazë të paragrafit 1 të nenit 223a të ZKP-së, monedhat virtuale mbrohen duke i ruajtur në një medie tjetër të përshtatshme, me ç'rast media dhe çelësi privat që mundësojnë përdorimin e tij ruhen së bashku, ndërsa skedari përkatës mbahet në një arkë të mbyllur për arsye sigurie dhe për të parandaluar qasjen e paautorizuar.

Opsioni i dytë

Në bazë të dispozitave të nenit 502 dhe asaj që pason të ZKP-së, prokurori publik do të kërkojë nga gjyqtari hetues, pas sekuestrimit të portofolit elektronik, një urdhër për kompaninë e licencuar që emeton, menaxhon ose operon me monedha virtuale për të transferuar njësi të monedhës virtuale, për t'i shitur ato dhe për të paguar shumën ekuivalente në euro në nën-llogarinë për depozitat gjyqësore të Republikës së Sllovenisë në Drejtorinë për të Hyra Publike (në tekstin e mëtejshëm: DHP) në pronësi të gjykatës që e ka lëshuar urdhrin. Nëse përdoruesit nuk vendosin për metodën e sigurisë, do të konsiderohet se i pranojnë rreziqet që lidhen me monedhat virtuale, prandaj në raste të tilla duhet të veprohët në përputhje me opsionin e parë.

Monedhat virtuale janë gjithashtu të lidhura në mënyrë të pakëputshme me rreziqet ekonomike, pasi shumat e tyre ekuivalente në euro ose monedha të tjera ndryshojnë me shpejtësi. Nëse vlera e njësisë të monedhës virtuale të siguruar ulet, prokurori publik mund t'i propozojë gjykatës që të lëshojë një urdhër për shitjen e të gjitha njësisë të monedhës virtuale (neni 506a i ZKP-së) dhe transferimin e shumës ekuivalente në euro në nën-llogarinë për depozitat gjyqësore të Republikës së Sllovenisë në DHP në pronësi të gjykatës që e ka lëshuar urdhrin. Para marrjes së një vendimi të tillë, gjykata duhet të marrë mendimin e pronarit të pronës (nëse autori ose i dëmtuari është i njohur) ose ta dërgojë thirrjen për të dhënë mendim (nëse autori ose pronari i njësisë të monedhës virtuale është i panjohur - paragrafi 2 i nenit 506 të ZKP-së), nëse prokurori i shtetit duhet të propozojë shitjen e pronës apo jo. Nëse vlera e një monedhe virtuale rritet, në procedurën penale prokurori publik duhet të thotë se njësisë të sekuestruara të monedhës virtuale do t'iu atribuohet vlera e tyre

bruto. Kjo e fundit, në praktikën gjyqësore sllovene njihet si “parimi bruto” që do të thotë se autorët e veprave penale nuk mund të mbështeten në zbritjen e shpenzimeve që vetvetiu janë të paligjshme, pasi janë të lidhura në mënyrë të pandashme me veprimtari të mëparshme të paligjshme ose rrjedhin nga një veprimtari e tillë.¹⁶¹ Instrumenti i konfiskimit të dobisë pronësore të përfituar me ose për shkak të kryerjes së veprës penale nuk i dedikohet vetëm kthimit, ose me fjalë të tjera - rikthimit të gjendjes financiare/të pronës si para kryerjes së veprës penale, por gjithashtu synon të parandalojë të aktivitetet e mundshme të paligjshme të autorit në të ardhmen.

Meqenëse veprat penale dhe rrethanat e tyre janë të ndryshme, hetimet mund të përdorin qasje të tjera dhe t'i përcaktojnë ndryshe veprat e autorëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë. Prandaj, rekomandimet aktuale përfaqësojnë vetëm një mjet pune për të lehtësuar hetimet e veprave penale që përfshijnë monedha virtuale dhe nuk duhet të konsiderohen si ligjërish të detyrueshme.

4. DISPOZITAT PENALE PËRMBAJTËSORE NË KORNIZËN LIGJORE SLLOVENE¹⁶²

Veprat penale të lidhura me monedhat virtuale mund të ndahen në dy grupe kryesore (në bazë të rasteve të shqyrtuara dhe të regjistruara nga prokuroritë publike): Grupi i parë lidhet me monedhat virtuale si cak për shkak të vlerës së tyre (p.sh. mashtrimi, siç përcaktohet në nenin 211 të KZ-1), ndërsa grupi i dytë i përfshin monedhat virtuale si mjet për kryerjen e veprave të tjera penale (p.sh. pagesa në kontekst të tregtimit të paligjshëm të substancave të paligjshme, siç përcaktohet në nenin 186 të tij).

Grupi i parë i veprave penale (monedhat virtuale si caqe për shkak të vlerës së tyre) përbëhet nga të paktën katër nëngrupe, në varësi të mënyrës së kryerjes së veprës penale:

- a) Nëngrupi i parë përfshin vepra në të cilat autori paraqet fakte në mënyrë të rreme dhe e mashtron të dëmtuarin, në mënyrë që ky i fundit t'i transferojë një numër njësisish të monedhës virtuale në portofolin elektronik të të parit. Për shembull, autorët pretendojnë se mbledhin fonde për investime të mëtejshme ose se fonde shtesë do t'iu ndahen përdoruesve të një monedhe virtuale dhe e bindin palën e dëmtuar të gjenerojë fitim shtesë (të lehtë) dhe të transferojë në mënyrë të pakthyeshme një numër njësisish të monedhës virtuale tek ata, por nuk

161 Shihni Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Sllovenisë, ref. nr. I Ips 19290/2017.

162 Udhëzuesi për hetimin e veprave penale në lidhje me monedhat virtuale, ref. nr. Ktr-zb-9/11/2019/AF-nf, Prokuroria Supreme e Shtetit të Republikës së Sllovenisë, Nëntor 2019

i përmbushin detyrimet e tyre. Sipas mendimit tonë, një veprim i tillë i autorit i shfaq të gjitha shenjat e mashtrimit të përcaktuara në nenin 211 të KZ-1.

- b) Nëngrupi i dytë përfshin një kombinim veprimesh në të cilat autorët e marrin me mashtrim çelësin privat, emrin e përdoruesit ose fjalëkalimin e palës së dëmtuar (zakonisht me një e-mail “phishing” - mashtrues), i përdorin këto të dhëna për të hyrë në portofolin elektronik të të dëmtuarit dhe për ta sekuestruar atë, ose për të transferuar njësi të monedhës virtuale në llogarinë e tyre. Duke qenë se autorët e dinë se cilat të dhëna u nevojiten për të përvetësuar njësitë e monedhës virtuale të palës së dëmtuar, veprimet e tyre të mashtrimit të palës së dëmtuar shfaqin disa karakteristika mashtrimi, siç përcaktohet në nenin 211 të KZ-1. Megjithatë, ky veprim është vetëm një fazë paraprake (dhe thelbësore) e një sulmi të mëpasshëm ndaj sistemeve të informacionit siç përcaktohet në nenin 221 të KZ-1. Autorët hyjnë ilegalisht në një sistem informacioni, i ndryshojnë të dhënat (p.sh. futin informacionin e tyre për të hyrë dhe sekuestruar portofolin e të dëmtuarit), shpenzojnë mjete financiare pa autorizim (p.sh. për pagesa) ose i transferojnë ato (gjegjësisht i zhvendosin njësitë e monedhës virtuale në portofolat e tyre elektronike). Në raste të tilla, për shkak të raportit të subsidiaritetit (përputhje ideale në dukje) ose përjashtimit nga dënimi i një veprë të mëparshme (përputhje reale në dukje), varësisht nga korrelacioni kohor dhe hapësinor ndërmjet dy veprave, autorët akuzohen vetëm për veprën penale të sulmit ndaj sistemeve të informacionit siç përcaktohet në nenin 221 të KZ-1 (ose, në lidhje me specialitetin, neni 237 i tij).
- c) Nëngrupi i tretë përfshin veprat penale në të cilat autorët vjedhin një portofol fizik që përmban çelësa privatë, i përdorin ato për të hyrë në sistemin e informacionit (portofolin elektronik të të dëmtuarit dhe rrjedhimisht sistemin e monedhës virtuale), për t'i ndryshuar të dhënat (p.sh. e futin informacionin e tyre për të hyrë dhe sekuestruar portofolin e të dëmtuarit), për të shpenzuar mjete financiare pa autorizim (p.sh. për pagesa) ose për t'i transferuar ato (gjegjësisht për t'i zhvendosur njësitë e monedhës virtuale në portofolat e tyre elektronike). Një veprim i tillë në emër të autorëve i shfaq vetëm shenjat e sulmit ndaj sistemeve të informacionit, siç përcaktohet në nenin 221 të KZ-1 (ose, në lidhje me specialitetin, neni 237 i tij), pasi vjedhja e një portofoli fizik është tashmë e nënkuptuar (lidhja e subsidiaritetit – përputhje ideale në dukje) ose korrespondon me një vepër paraprake të padënueshme (përputhje reale në dukje), varësisht nga korrelacioni kohor dhe hapësinor midis dy veprave. Ky nëngrup përfshin modalitete të ndryshme të veprave penale, varësisht nga qëllimi i autorit (për shembull, nëse autorët nuk e dinë se portofoli përmban çelësa personale dhe mendojnë se është vetëm një

çelës i rregullt USB, të cilin ata më pas e mbishkruajnë, veprimi i tyre i shfaq vetëm karakteristikat e vjedhjes, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 204 të KZ-1).

- d) Së fundi, nëngrupi i katërt përbëhet nga veprime në të cilat autorët hyjnë në sistemin e informacionit (portofolin elektronik të të dëmtuarit dhe rrjedhimisht në sistemin e monedhës virtuale) në mënyrë të pajustificueshme (p.sh. me hakim), i ndryshojnë të dhënat (p.sh. e futin informacionin e tyre për të hyrë dhe sekuestruar portofolin e palës së dëmtuar), shpenzojnë mjete financiare pa autorizim (p.sh. për pagesa) ose i transferojnë ato (gjegjesisht i zhvendosin njësitë e monedhës virtuale në portofolat e tyre elektronike), veprimi i tyre i shfaq vetëm karakteristikat e një veprë të rëndë penale të sulmit ndaj sistemeve të informacionit, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 221 të KZ-1 (ose, në lidhje me specialitetin, neni 237 i tij).

Grupi i dytë lidhet me veprat penale në të cilat monedhat virtuale përbëjnë mjet pagese ose pronë të fituar në kontekstin e tregtisë së paligjshme të substancave të paligjshme, armëve, mallrave të vjedhura etj. Në këtë kuptim, monedhat virtuale sjellin vetëm dobi pronësore të paligjshme dhe nuk përbëjnë sende penale të mbrojtura nga këto vepra penale.

Megjenëse monedhave virtuale mund t'u atribuohet një vlerë ekuivalente monetare, është e mundur të vërtetohet dëmi i shkaktuar ose dobia pronësore e fituar nga autori nëpërmjet kryerjes së një veprë penale (paragrafi 9 i nenit 99 të KZ-1). Sipas mendimit tonë, për shkak të luhatjeve në vlerën e monedhave virtuale, dëmi ose dobitë pronësore të paligjshme duhet të vendosen në vlerën përkatëse në momentin kur autorët kanë arritur qëllimin e tyre duke kryer një veprë penale, gjegjesisht t'i marrin njësitë e monedhës virtuale. Në këtë moment, autorët zakonisht marrin njësi të monedhës virtuale si "pagesë" ose e pengojnë të dëmtuarin t'i përdorë njësitë e tilla (p.sh. me një transferim të pakthyesëm në portofolin e tyre elektronik).

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet veprës penale të pastrimit të parave, siç përcaktohet në nenin 245 të KZ-1. Siç përkufizohet më lartë, sistemet e monedhës virtuale lejojnë përzierjen e njërive të monedhës virtuale në mënyrë që të rritet anonimiteti. Përzierja ofrohet më shpesh nga përdorues të tjerë të një sistemi të veçantë të monedhës virtuale; për një përqindje të caktuar të transaksionit, ata transferojnë njësi të një monedhe të ndryshme virtuale në një adresë të re publike të një portofoli elektronik të caktuar, duke e thyer kështu zinxhirin e transaksioneve të kryera dhe të gjurmuara. Kjo korrespondon me krijimin shtresave, gjegjesisht fshehjen e burimit dhe të pronësisë së një monedhe. Megjithatë, subjektet të cilat mundësojnë përzierjen dhe krijimin e shtresave nuk kanë përgjegjësi penale sipas nenit 245 të KZ-1. Madje edhe nëse dikush do të punonte me zell dhe do ta inspektonte "blockchain"-in për të

zbuluar burimin e njësive të monedhës virtuale, nuk mund dhe nuk do të dinte nëse këto njësi ishin blerë në mënyrë të paligjshme. Megjithatë, ajo që u tha më sipër nuk vlen për: 1) autorët e veprave penale të cilët e dinë se njësitë e tyre të monedhës virtuale janë marrë në mënyrë të kundërligjshme; 2) ofruesit e përzierjes që e dinë ose duhet ta dinë (për shembull, pas marrjes së njoftimit nga policia) se njësitë e monedhës virtuale që janë përzier prej tyre janë marrë në mënyrë të paligjshme (paragrafi pesë i nenit 245 të KZ-1).

5. PËRVOJA PRAKTIKE – STUDIM RASTI

Në pjesën në vijim do ta paraqesim rastin e parë penal në Slloveni në të cilin janë përdorur monedha virtuale për pagesën e shërbimeve të paligjshme, të ofruara nga autorët. Prandaj, monedhat virtuale të përfituara përbënin dobi pronësore nga vepra penale që duhet sekuestruar dhe konfiskuar.¹⁶³

Në mungesë të rregullimit ligjor të monedhave virtuale dhe rrjedhimisht edhe rregullimit të mënyrave të pranueshme ligjërisht të trajtimit të monedhave virtuale, prokurori përgjegjës dhe policia u përballën me pyetje të rëndësishme lidhur me ekzekutimin e masave të duhura të cilat do të siguronin prova të pranueshme.

Gjendja faktike

Prokuroria e Specializuar Shtetërore e Republikës së Sllovenisë (në tekstin e mëtejshëm: SSPO) mori një kërkesë për ndihmë juridike nga kolegët austriakë që kërkonin fillimin e hetimeve të fshehta paralele kundër shtetasve sllovenë në territorin e Sllovenisë. Në Austri u ngrit procedurë penale kundër shtetasit të tyre, i akuzuar se ka blerë drogë disa herë, duke përdorur një platformë të veçantë interneti të njohur në mbarë botën. Si pasojë e veprimtarisë së tij kriminale janë ndërmarrë masa të posaçme për identifikimin e administratorëve të platformës së internetit. Autoritetet austriake kanë zbatuar masa të ndryshme hetimore të fshehta dhe klasike, që nga maji i vitit 2014.

Dy shtetas sllovenë kanë administruar platformën online, e cila u krijua për shitjen e substancave të paligjshme. Në ueb-faqe, klientëve iu ofrua një listë e substancave që ishin në dispozicion dhe çmimet e tyre. Megjithëse ueb-faqja ishte e qasshme për publikun, blerësit duhej të regjistroheshin para se të blinin. Ueb-faqja funksiononte në serverin me adresë IP që i përkiste një kompanie nga Hongkongu. Blerësve nga vende të ndryshme nga e gjithë bota iu ofruan mënyra të ndryshme pagese; monedha virtuale (Bitcoins), transferim i parave

¹⁶³ Sipas nenit 74 të KZ-1 askush nuk mund t'i mbajë dobitë pronësore të përfituara nga ose që rrjedhin nga një vepër penale. Kjo dobi pronësore do të sekuestrohet në bazë të vendimit të gjykatës që e vërteton ekzistimin e veprës penale në kushtet e parashikuara në Kodin Penal.

me Western Union, e në fillim edhe pagesa direkte në llogarinë e kompanisë në Slloveni – kjo e fundit u mbyll shpejt dhe u krijua një llogari bankare në një vend të huaj (offshore). Dërgesat vinin nga Sllovakia, Republika Çeke, Spanja dhe Holanda. Ueb-faqja nuk ofronte asnjë informacion në lidhje me kompaninë dhe përfaqësuesit e saj ligjorë. Pas regjistrimit, klientët mund të bënin porosi. I gjithë komunikimi i mëtejshëm kryhej përmes e-mailit.

Masat e posaçme hetimore

Janë kryer këto masa të posaçme (të fshehta) hetimore: vëzhgimi sekret, marrja e të dhënave të komunikimit elektronik, përgjimi i komunikimit, operacione të fshehta dhe marrja e informacionit bankar. Të gjitha provat e marra në atë mënyrë, e konfirmuan faktin se autorët kishin marrë pagesa në Bitcoin.

Në procedurën paraprake u formua Grupi i Specializuar Hetimor. Ai përbëhej nga Prokuroria e Posaçme Shtetërore e Republikës të Sllovenisë, Njësia për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe hetues të policisë. Njësia për Parandalimin e Pastrimit të Parave kërkoi informacion nga Njësitë e Kundërzbulimit Financiare (FIU) në të gjithë BE-në dhe mori informacion nga FIU e Luksemburgut, duke konfirmuar se të akuzuarit kishin Bitcoin-e në portofolet e tyre. Në të njëjtën kohë, FIU e Luksemburgut dërgoi një raport të transaksioneve me Bitcoin-e që ishin kryer në llogaritë tregtare të dy autorëve të platformës Bitstamp. Të gjitha transaksionet u analizuan më tej nga Njësia për Parandalimin e Pastrimit të Parave. U konfirmua se pjesa dërrmuese e hyrjeve ishin bërë nga persona të tjerë, të identifikuar si blerës të substancave të paligjshme dhe në këtë kontekst mjetet financiare përfaqësonin një vlerë të fituar nga kryerja e veprës penale.

Sekuestrimi i përkohshëm dhe konfiskimi i Bitcoin-eve

Gjatë hetimit u identifikuan disa adresa Bitcoin-i, të përdorura nga dy të akuzuarit kryesorë për marrjen e pagesave në Bitcoin-e. Disa nga mjetet financiare u depozituan në një llogari tregtare të operuar nga Bitstamp S.A. nga Luksemburgu. Për këtë, gjykata ka urdhëruar masën e përkohshme me të cilën sigurohet kërkesa për konfiskimin e dobisë pronësore, pas propozimit të arsyetuar paraprak të prokurorit publik. Kërkesa e prokurorit përfshinte arsyetimin e detajuar të dyshimit të bazuar se autorët kanë kryer veprë penale, ekzistencën e vlerave të fituara në mënyrë të paligjshme dhe rrezikun që i akuzuari vetëm ose nëpërmjet personave të tjerë të mund t'i përdorte këto dobi pronësore për veprimtari të mëtejshme kriminale, ose mund t'i fshehte, tjetërsonte, shkatërronte ose t'i hiqte qafe në ndonjë mënyrë tjetër me qëllim që të parandalojë ose të vështirësojë në mënyrë të konsiderueshme konfiskimin e tyre pas përfundimit të procedurës penale. Gjithashtu, u shpjegua mirë edhe proporcionaliteti i masës.

U identifikuan edhe katër adresa të tjera në bazë të analizës së transaksioneve të llogarive bankare dhe gjatë kryerjes së masave të posaçme hetimore (vëzhgimi sekret dhe agjenti i fshehtë që ka kryer blerje të rreme). Sipas rezultateve të analizës, njëri prej autorëve i arkëtonte rregullisht Bitcoin-et (merrte para të gatshme) në bankomatet për Bitcoin në një qytet slloven. Kjo u konfirmua me faturat në letër të gjetura gjatë kontrollit të një vendbanimi, vëzhgimit sekret dhe mesazheve të shkurtra me kode nga bankomatet për Bitcoin, të marra në telefonin celular të autorit. Kjo tregoi se jo të gjitha vlerat e fituara në mënyrë të paligjshme të marra përmes pagesës në Bitcoin-e mbetën gjithashtu në Bitcoin.

U zbulua gjithashtu se të gjitha adresat ishin të lidhura me të njëjtin portofol të Bitcoin-it. Gjatë ekzaminimit të parë të pajisjeve elektronike të sekuestruara, u zbulua se disa prej tyre kishin të instaluar aplikacionin e portofolit për Bitcoin - BlockChain. Pas analizës së re, prokurori përsëri i propozoi gjyqtarit (pasi ishte ngritur aktakuza) të lëshojë një urdhër tjetër për ekzaminim - propozimi i referohej atyre adresave të Bitcoin-it. Edhe pse pritej që të gjenden më shumë Bitcoin-e ose monedha të tjera virtuale, prokurori priste që me ekzaminimin e pajisjeve të reja të zbuluara të fitoheshin edhe prova të reja të forta, duke vërtetuar se ato adresa të Bitcoin-it ishin përdorur vërtet nga të akuzuarit, në këtë rast për të marrë pagesat për shërbimet e tyre në Bitcoin-e. Me të njëjtin propozim, prokurori kërkoi gjithashtu sekuestrimin e të dhënave elektronike që përfaqësonin dobitë pronësore të fituara nga aktiviteti kriminal - të gjitha Bitcoin-e. Kishte shumë gjasa që ekzaminimi i pajisjeve elektronike dhe i portofolit të zbulonte se kishte edhe më shumë mjete financiare të ruajtura në portofol. Për qëllimin e transferimit të monedhave virtuale që mund të zbuloheshin, u krijua një portofol i ri përpara propozimit. Adresa e portofolit u përfshi në propozim dhe iu dërgua gjykatës. Gjykata e pranoi propozimin dhe lëshoi urdhër.

Hetuesit nga Departamenti i Hetimit Kompjuterik ekzaminuan dy "iPhone" dhe dy "iPad"-e që u përkisnin dy të akuzuarve kryesorë. Ata arritën të hynin në portofol dhe të transferonin 34,08752292 Bitcoin-e në portofolin e vendosur më parë.

Pyetje të hapura

Kishte pyetje të shumta se si të veprohet me Bitcoin-et në këtë rast të veçantë, të cilave duhej t'u jepej përgjigje e duhur për të siguruar:

- a) Si të përcaktohen siç duhet MV-të në kërkesë që gjykata të mund të lëshojë urdhër të zbatueshëm;
- b) Marrjen e provave që do të ishin të pranueshme para gjykatës në fazat e mëvonshme të procedurës penale;
- c) Sekuestrimin e përkohshëm, sigurimin dhe trajtimin e monedhave virtuale në një mënyrë të qëndrueshme në aspekt ligjor.

Sekuestrimi i përkohshëm i Bitcoin-eve

Urdhri i parë i lëshuar nga gjykata ishte një urdhër drejtuar “Bitsamp”-it, i cili më parë i kishte bllokuar llogaritë e personave të akuzuar pas komunikimit me Njësinë Sllovene për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Ata i ngrinë të gjitha mjetet financiare dhe i konvertuan Bitcoin-et dhe dollarët amerikanë në euro, kurse shumata u transferua në Thesarin e Luksemburgut.

Pyetja e hapur ishte se si të sekuestrohen dhe të sigurohen monedhat virtuale që ishin të lidhura me portofolat që ishin në posedim ekskluziv të autorëve - nuk ka asnjë institucion financiar apo platformë shkëmbimi ku mund të dërgohet një urdhër për t'u ekzekutuar. Pyetja shtesë që u ngrit ishte se si të përcaktohen siç duhet dobitë pronësore që ishin transformuar në monedhë virtuale, që nuk është përcaktuar nga Ligji i Procedurës Penale apo Kodi Penal.

Prokurori përgjegjës për këtë rast bëri një kërkesë të arsyetuar për kontrollin e pajisjeve elektronike të sekuestruara për të cilat u konfirmua se përmbanin “Blockchain – Bitcoin Wallet” – një aplikacion që mundësonte qasje në portofolin e autorëve përmes “iPad”-ëve dhe “iPhone”-ëve të sekuestruar. Me qasjen e fituar gjatë ekzaminimit të pajisjeve, hetuesit synonin të merrnin prova për përdorimin e adresave të njohura publike për transaksione dhe në të njëjtën kohë të sekuestronin dhe të transferonin monedhat virtuale që përfaqësonin dobi pronësore të fituara nga aktiviteti kriminal.

Për shkak të statusit të parregulluar të MV-ve, prokurori kërkoi **sekuestrimin e të dhënave elektronike** (Bitcoin-eve). Në të njëjtën kërkesë, prokurori i propozoi gjykatës të urdhëronte transferimin e monedhave virtuale që pritej të gjendeshin në portofol. Për arsye të sekuestrimit paraprak dhe transferimit të monedhave virtuale të gjetura, policia paraprakisht krijoi një portofol të ri. Në kërkesë, prokurori e përfshiu edhe adresën publike për transferim që i ishte komunikuar nga policia. Gjykata e pranoi propozimin dhe lëshoi urdhër. Gjatë kërkimit të pajisjeve elektronike, specialistët e policisë për kërkimin kompjuterik arritën të sekuestrojnë dhe të transferojnë 34,07755074 Bitcoin-e në portofolin e ri.

Sigurimi i një niveli të lartë sigurie

Siç u shpjegua tashmë, monedhat virtuale të sekuestruara duhet të transferohen dhe të sigurohen siç duhet në mënyrë që të parandalohet qasja e paautorizuar dhe keqpërdorimi i mundshëm i mjeteve financiare të sekuestruara. Pas ekzekutimit të urdhrin u krijua portofoli i letrës. Çelësi publik dhe çelësi privat u shtypën në fletë të veçanta letre. Deri tek gjykata u dërgua një dokumenti që përmbante vetëm çelësin publik. Për të garantuar sigurinë dhe për të parandaluar keqpërdorimin, çelësi privat është ruajtur, për arsye sigurie, në një mjedis shumë të mbrojtur në polici.

Manaxhimi i monedhave virtuale të sekuestruara përkohësisht

Në këtë rast i akuzuari kërkoi që Bitcoin-et e sekuestruara të shiteshin. Gjyqtari zhvilloi një seancë të posaçme ku avokati mbrojtës i shpjegoi argumentet për një kërkesë të tillë. Argumenti kryesor ishte frika e vërtetë nga humbja e vlerës. Avokati mbrojtës deklaroi se në momentin e dërgimit të kërkesës në gjykatë, vlera e Bitcoin-it ishte e lartë dhe se pritej një rënie e vlerës së kësaj monedhe virtuale në të ardhmen e afërt. Gjykata e ndoqi propozimin e të akuzuarit dhe vendosi (sipas paragrafit 2 të nenit 506.a të CPA) t'i shesë Bitcoin-et e sekuestruara përkohësisht. Në arsyetim thuhej se për shkak të luhatshmërisë së kësaj monedhe virtuale, ishte e vështirë të bëheshin parashikime afatgjata dhe se në përputhje me nenit 8 të Dekretit për procedurën e trajtimit të sendeve dhe pronës së sekuestruar ishte e nevojshme të sigurohet siguria dhe përfitimi, në përputhje me kushtet e tregut. U urdhërua që shitja të bëhej nëpërmjet Bitstamp, e cila kishte licencën e Bankës Qendrore të Luksemburgut për të kryer shërbime financiare. Përgjegjësia dhe detyrimi për t'i shitur Bitcoin-et e sekuestruara iu delegua Komisionit për Dobitë Pronësore të Sekuestruara. Përfundimisht, Bitcoin-et e sekuestruara u shitën në shkëmbimin Bitstamp Limited dhe shuma prej 210.404,10 euro u transferua në nën-llogarinë e gjykatës. Në fund, u konfiskuan gjithsej 306.841,09 euro.

Mësimet e nxjerra

Bashkëpunimi i mirë ndërkombëtar, veprimet e shpejta dhe të koordinuara të homologëve të ndryshëm dhe njohuritë për funksionimin e sistemit të monedhave virtuale janë vendimtare për sekuestrimin, transferimin dhe sigurimin e duhur dhe në kohë të dobive pronësore të përfituara nga aktiviteti kriminal. Dispozitat ligjore ekzistuese mund të jenë të mjaftueshme, nëse interpretimi i pranueshëm ligjërish të lejon këtë. Në rastin slloven nuk ka pasur nevojë të përshtaten dispozitat ligjore që zbatohen në rast të masës së përkohshme që siguron kërkesën për konfiskimin e dobive pronësore të përfituara ose që rezultojnë nga një vepër penale.

VI. Përfundime dhe rekomandime

Legjislacioni ekzistues në Republikën e Maqedonisë së Veriut mundëson sekuestrimin përkohshëm dhe konfiskimin e monedhave virtuale. Ashtu si në Republikën e Sllovenisë, dispozitat ligjore ekzistuese nga ligji material dhe procedural janë përcaktuar gjerësisht duke lejuar sekuestrimin e përkohshëm dhe konfiskimin e monedhave virtuale pa miratimin e dispozitave ligjore shtesë.

Megjithatë, kur bëhet fjalë për monedhat virtuale, zbatimi praktik i dispozitave të përgjithshme ligjore në Maqedoninë e Veriut përcillet me sfida dhe vështirësi të ndryshme. Megjithëse legjislacioni aktual lejon që organet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore të hapin portofola të sigurta me qëllim të sigurimit të sekuestrimit përkohshëm dhe sigurimin e MV-ve, ka shumë pyetje të hapura si:

- cili organ do ta hapë portofolin e sigurt;
- çfarë lloji i portofolit të sigurt do të hapet;
- si do të gjenerohen dhe menaxhohen fjalëkalimet dhe qasja në portofolin e sigurt;
- kur do të hapet një portofol i sigurt (për qëllimet e çdo hetimi të posaçëm, për çdo MV, për çdo të akuzuar);
- si do të rregullohen tarifat e transaksioneve;
- kush do të ketë qasje në portofol dhe cilët do të jenë mekanizmat e kontrollit;
- kush do ta menaxhojë transferimin e monedhave virtuale në portofolin e sigurt;
- kush do t'i menaxhojë monedhat virtuale pasi ato të transferohen në portofolin e sigurt;
- çfarë do të ndodhë pas sekuestrimit, a mund të shiten monedhat virtuale, si, kur dhe nga kush, etj.

Prandaj, është e këshillueshme që të miratohen rregulla specifike që e rregullojnë sekuestrimin e përkohshëm dhe konfiskimin e MV-ve. Këto rregulla mund të zbatohen ose në Ligjin e Procedurës Penale ose mund të jenë pjesë e një udhëzimi të përgjithshëm dhe akteve nënligjore, siç tregon shembulli i Sllovenisë. Për momentin, duke pasur parasysh legjislacionin ekzistues, miratimi i udhëzimeve dhe i rregulloreve të brendshme do të ishte mënyra më e shpejtë dhe më efektive për t'i trajtuar të gjitha pyetjet e hapura.

Rregullat që duhet të miratohen duhet t'i trajtojnë të gjitha pyetjet e lartpërmendura dhe pyetje të tjera që janë të rëndësishme për sekuestrimin dhe konfiskimin e suksesshëm të monedhave virtuale. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përmbajtjes së kërkesës së prokurorit dhe urdhrin të gjykatës kur bëhet fjalë për monedhat virtuale, për shkak të karakteristikave specifike të procesit teknologjik të sekuestrimit të MV-ve.

Siç tregojnë praktikatat më të mira, këshillohet që portofolat e sigurta të hapen rast pas rasti. Për më tepër, portofolat e sigurta duhet të hapen veçmas për çdo MV dhe për çdo të akuzuar, duke mundësuar një adresë të vetme për çdo sekuestrim të përkohshëm apo konfiskim. Është praktikë e mirë të përgatitet paraprakisht konfiskimi adekuat i adresës(ave) dhe portofolit(eve) të kontrolluara nga organet sapo të paraqitet mundësia për sekuestrim të monedhave virtuale. Portofoli i sigurt duhet të jetë i hapur më së voni përpara se prokurori t'i dërgojë gjykatës kërkesën për sekuestrimin e MV-ve, pasi në kërkesën drejtuar gjykatës duhet të përfshihet edhe adresa publike.

Po ashtu, nëse është e zbatueshme, krijimi i adresave dhe i portofolave të sigurta duhet të bëhet në një mjedis kompjuterik të sigurt dhe rekomandohet fuqimisht të ekzistojnë udhëzues të shkruar në mënyrë të detajuar si një pasqyrë të rregullave të brendshme. Në varësi të asaj se çfarë portofoli dhe/ose procedurë e kontrolluar nga autoritetet do të përdoren, adresa e konfiskimit duhet të jetë regjistruar në mënyrë paraprake si një kod QR për të shmangur gabimet e shtypit. Pikërisht përpara se të ekzekutohet një sekuestrim i përkohshëm, adresa e sekuestrimit duhet të kontrollohet dy herë për të parë nëse adresa është e saktë. Një sugjerim është që të përdoret parimi me katër sy, në të cilin katër sy mund ta kontrollojnë saktësinë e adresës së sekuestrimit dhe kështu t'i mbrojnë personat që i sekuestrojnë mjetet.

Një pyetje shumë e rëndësishme që nuk duhet anashkaluar është pyetja se çfarë ndodh me MV-të pas sekuestrimit të përkohshëm? A mund të shiten MV-të dhe nëse po, kur dhe në çfarë kushtesh? Kush do të mund ta miratojë shitjen dhe cilat janë aspektet ligjore që duhet të merren parasysh? Duke qenë e qartë se kjo pyetje i prek të drejtat pronësore të të akuzuarve në fazat kur fajësia e tyre nuk është vërtetuar përfundimisht, këshillohet që në Ligjin procedural të përfshihen rregulla specifike. Duke pasur parasysh këtë, duhet të merret parasysh mundësia e kompensimit të të dyshuarit në një fazë të mëvonshme nëse i njëjti shpallet i pafajshëm.

Gjithashtu, duhet të miratohen rregulla të qarta se çfarë ndodh me MV-të pas konfiskimit përfundimtar të tyre. Këshillohet që nëse ato nuk janë shitur ende, kjo të bëhet pas konfiskimit, pasi mbajtja dhe trajtimi i mëtejshëm i MV-ve mund të sjellë deri tek një humbje financiare dhe mund t'i dëmtojë të gjitha përpjekjet e bëra në procedurën penale. Pra, këshillohet që në ligjin që ka të bëjë me

VI. Përfundime dhe rekomandime

menaxhimin e pronës së konfiskuar të jenë të përfshirë disa rregulla shumë të përgjithshme në lidhje me konfiskimin dhe shitjen e MV-ve.

Po ashtu, duhet të miratohen rregulla për shitjen e MV-ve në procedurën penale. Siç u përmend, gjykata mund të vendosë për shitjen e MV-ve të konfiskuara, por Ligji për Procedurën Përmbarimore nuk ka rregulla se si të shiten MV-të. Prandaj, është e nevojshme të përfshihen rregullat e përgjithshme për shitjen e MV-ve, pasi shitja e tyre është mjaft e ndryshme nga shitja e sendeve tjera dhe vlejné rregulla të tjera të tregut.

Si përfundim, tema e MV-ve në procedurat penale në Maqedoninë e Veriut është mjaft e re. Meqenëse pjesa më e madhe e legjislacionit që ka të bëjë me këtë çështje është në fazën e zhvillimit, tani është koha e vërtetë për t'i bashkuar përpjekjet dhe për ta trajtuar këtë çështje në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të njëtrajtshme. Shembulli praktik dhe pozicioni ligjor në Republikën e Sllovenisë ofron njohuri për autoritetet në Maqedoninë e Veriut se si ta trajtojnë këtë çështje në mënyrë efikase, duke u siguruar që ajo të jetë në përputhje me të gjitha standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Siç e përjetuan kolegët sllovenë, bashkëpunimi i mirë ndërkombëtar, veprimet e shpejta dhe të koordinuara të homologëve të ndryshëm dhe njohuritë për funksionimin e sistemit të monedhave virtuale janë vendimtare për sekuestrimin, transferimin dhe sigurimin e duhur dhe në kohë të dobive pronësore të përfituara nga aktiviteti kriminal. Kështu, përveç përmirësimeve në legjislacion, përpjekjet e mëtejshme për forcimin e kapaciteteve institucionale të organeve për zbatimin e ligjit dhe të atyre gjyqësore, janë thelbësore për sekuestrimin dhe konfiskimin efikas të MV-ve në procedurat penale.

BIBLIOGRAFIA

LITERATURA:

1. Doracaku Bazë për Zbulimin dhe Hetimin e Pastrimit të të Ardhurave nga Veprat Penale duke Përdorur Monedha Virtuale – UNDOC, qershor 2014 https://www.imolin.org/pdf/imolin/FULL10-UNODCVirtualCurrencies_final.pdf
2. Banka Qendrore Evropiane “Skemat e monedhave virtuale”, tetor 2012, <https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/other/virtualcurrencyschemes201210en.pdf>
3. Shënim nga diskutimi i stafit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, “Monedhat virtuale dhe përtej: Konsideratat fillestare”, janar 2016, <https://www.imf.org/external/pubs/ft/sdn/2016/sdn1603.pdf>
4. Distributed Ledger Technology (DLT) dhe Blockchain, Shënimi nr.1 i FinTech, Grupi i Bankës Botërore, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, 2017 - <https://documents1.worldbank.org/curated/en/177911513714062215/pdf/122140-WP-PUBLIC-Distributed-Ledger-Technology-and-Blockchain-Fintech-Notes.pdf>
5. FATF “Monedhat virtuale – Përkufizimet kryesore dhe rreziqet potenciale të AML/CFT”, qershor 2014, <http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Virtual-currency-key-definitions-and-potential-aml-cft-risks.pdf>
6. Udhëzuesi për Qasje të Bazuar në Rrezik ndaj Monedhave Virtuale i FATF, qershor 2015 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Guidance-RBA-Virtual-Currencies.pdf>
7. Udhëzuesi për Qasjen e Bazuar në Rrezik ndaj Mjeteve Virtuale dhe Ofruesve të Shërbimeve të Mjeteve Virtuale i FATF, qershor 2019 <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/RBA-VA-VASPs.pdf>
8. R. HOUBEN dhe A. SNYERS, “Crypto-assets, Key developments, regulatory concerns and Respons”, Komisioni i Parlamentit Evropian për Çështjet Ekonomike dhe Monetare, Departamenti i Politikave për Politikat Ekonomike, Shkencore dhe të Cilësisë së Jetës, studimi i Drejtorisë së Përgjithshme për Politikat e Brendshme, prill 2020, (është në dispozicion në mënyrë elektronike nëpërmjet [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU\(2020\)648779_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/648779/IPOL_STU(2020)648779_EN.pdf)).
9. BOE, “Skemat e monedhave virtuale - një analizë e mëtejshme”, shkurt 2015, <https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/other/virtualcurrencyschemesen.pdf>

10. R. HOUBEN dhe A. SNYERS, “Crypto currencies and blockchain, Legal context and implications for financial crime, money laundering and tax evasion”, Komisioni i Parlamentit Evropian për Çështjet Ekonomike dhe Monetare, Departamenti i Politikave për Politikat Ekonomike, Shkencore dhe të Cilësisë së Jetës, studimi i Drejtorisë së Përgjithshme për Politikat e Brendshme, korrik 2018, (është në dispozicion në mënyrë elektronike nëpërmjet <https://www.europarl.europa.eu/cmsdata/150761/TAX3%20Study%20on%20cryptocurrencies%20and%20blockchain.pdf>).
11. “Udhëzues për sekuestrimin e krypto-monedhave”, Zyra e Programit të Krimit Kibernetik e Këshillit të Evropës, shkurt 2021
12. Udhëzuesi i monedhave virtuale për autoritetet gjyqësore i RrEGjKK

BURIMET ELEKTRONIKE:

13. <https://www.investopedia.com/terms/c/central-bank-digital-currency-cbdc.asp>
14. <https://www.investopedia.com/terms/b/bitcoin-mining.asp>
15. <https://cointelegraph.com/bitcoin-for-beginners/how-does-blockchain-work-a-beginners-guide-to-blockchain-technology>
16. <https://builtin.com/blockchain/blockchain-applications>
17. <https://www.analyticsinsight.net/real-world-applications-of-blockchain-technologies/>
18. <https://ethereum.org/en/developers/docs/consensus-mechanisms/pos/>
19. https://en.wikipedia.org/wiki/Unspent_transaction_output
20. <https://cryptocurrencyhub.io/exchanger-vs-exchange-which-one-to-choose-73af890dea0a>
21. <https://cryptocurrencyhub.io/exchanger-vs-exchange-which-one-to-choose-73af890dea0a>
22. <https://cryptocurrencyfacts.com/what-is-a-cryptocurrency-wallet/>
23. <https://paxful.com/blog/what-are-public-keys-private-keys-wallet-address/>
24. <https://cryptocurrencyfacts.com/what-is-a-cryptocurrency-wallet/>
25. <https://medium.com/hackernoon/crypto-wallet-vs-address-54f7fb980bd3>
26. <https://thenextweb.com/news/the-differences-between-a-bitcoin-wallet-and-an-address>
27. <https://en.cryptonomist.ch/2020/08/15/bitcoin-mixers-centralized-decentralized/>

28. <https://bitcoinmagazine.com/guides/what-are-bitcoin-mixers>
29. <https://www.europol.europa.eu/newsroom/news/multi-million-euro-cryptocurrency-laundering-service-bestmixerio-taken-down>
30. <https://www.europol.europa.eu/newsroom/news/cryptocurrency-laundering-service-members-of-criminal-organisation-arrested-in-spain>
31. <https://www.justice.gov/opa/pr/ohio-resident-pleads-guilty-operating-darknet-based-bitcoin-mixer-laundered-over-300-million>
32. <https://en.cryptonomist.ch/2020/08/15/bitcoin-mixers-centralized-decentralized/>
33. <https://www.investopedia.com/terms/a/altcoin.asp>
34. <https://www.binance.com/en/support/law-enforcement>

BURIMET LIGJORE:

35. Direktiva (EU) 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e datës 30 maj 2018 që e ndryshon Direktivën (EU) 2015/849 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, dhe që i ndryshon Direktivat 2009/138/EC dhe 2013/36/EU <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32018L0843>
36. Komiteti i Konventës për Krimet Kibernetike, Shënimi udhëzues i T-CY nr. 1 <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016802e79e6>
37. Direktiva 2009/110/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e datës 16 shtator 2009 për marrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit të institucioneve të parasë elektronike që i ndryshon Direktivat 2005/60/EC dhe 2006/48/EC dhe shfuqizon Direktivën 2000/46/EC <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32009L0110&from=en>
38. Konventa e Budapestit për Krimin Kibernetik <https://rm.coe.int/1680081561>
39. Raporti shpjegues për Konventën e Budapestit për Krimin Kibernetik <https://rm.coe.int/16800cce5b>
40. Komiteti i Konventës për Krimet Kibernetike, Shënimi udhëzues i T-CY nr.10 <https://rm.coe.int/16806f943e>
41. Konventa e Strasburgut - Konventa për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Vepra Penale (CETS nr. 141) <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=141>
42. Konventa e Varshavës - Konventa për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Vepra Penale dhe për Financimin e

- Terrorizmit <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=198>
43. Konventa e së Drejtës Penale për Korrupsionin (CETS nr. 173) - <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=173>
 44. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional - https://www.unodc.org/documents/middleeastandnorthafrica/organised-crime/UNITED_NATIONS_CONVENTION_AGAINST_TRANSNATIONAL_ORGANIZED_CRIME_AND_THE_PROTOCOLS_THEREO.pdf
 45. Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 139/2004 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014, 196/2015, 226/2015, 97/2017 dhe 248/2018
 46. Ligji i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 150/10, 100/12 dhe 198/18
 47. Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 120/18, 275/19 dhe 317/20
 48. Ligji për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, Dobisë Pronësore dhe Sendeve të Konfiskuara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 98/08, 145/10, 104/13, 187/13, 43/14, 160/14, 97/15, 148/15 dhe 64/18
 49. Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 18/01, 92/08, 139/09, 35/10
 50. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut nr. 1/92, 31/98, 91/01, 84/03, 107/05, 3/09, 49/11, 6/19, 39/19)
 51. Udhëzuesi për hetimin e veprave penale në lidhje me monedhat virtuale, ref. nr. Ktr-zb-9/11/2019/AF-nf, Prokuroria Supreme e Shtetit të Republikës së Sllovenisë, Nëntor 2019
 52. Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 68/16, 81/19, 91/20 dhe 2/21
 53. Ligji për Shërbimet e Pagesave, Shërbimet e Emetimit të Parave Elektronike dhe Sistemeve të Pagesave, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 68/16, 7/18, 9/18 dhe 102/20)
 54. Ligji për Punë Devizore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 81/08, 85/09 dhe 109/12
 55. Ligji për Letrat me Vlerë të Pamaterializuara, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr.75/15, 74/16 – ORZNP48, 5/17, 15/18 dhe 43/19)
 56. Ligji për Tregun e Instrumenteve Financiare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 77/18, 17/19, 66/19 dhe 123/21

57. Ligji për Miratimin e Euros, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 114/06
58. Ligji për Obligacionet, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 97/07, 64/16 dhe 20/18 – OROZ631
59. Ligji për Pronësinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 87/02, 91/13 dhe 23/20
60. Kodi Penal, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 50/12, 6/16, 54/15, 38/16, 27/17, 23/20, 91/20 dhe 95/21
61. Ligji i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 32/12, 47/13, 87/14, 8/16, 64/16, 65/16, 66/17 – ORZKP 153,154, 22/19, 55/20, 89/20, 191/20, 200/20 dhe 105/21
62. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Sllovenisë, ref. nr. VSRS I Ips 19290/2017
63. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Sllovenisë, ref. nr. I Ips 19290/2017

Shtojca I - Shabllon se çfarë informacioni mund të merret nga një shkëmbyes ose nga ofruesit e tjerë të shërbimeve. Shënim: në seksionin e privatësisë së të dhënave të çdo ofruesi të shërbimeve dhe në seksionin për hapjen e llogarisë, mund të gjenden informacione se cilat të dhëna i mbajnë ofruesit e shërbimeve. Shembulli është dhënë për informacionin që mund të merret në përgjithësi, por për këtë shembull janë përdorur të dhënat që i mban Coinbase.

PROKURORIA THEMELORE

RO/KO nr ._____

(data, vendi)

DERI TE

(emri i shkëmbimit (bursës) ose i ofruesit të shërbimit)

Lënda: Kërkesë për të dhënat e ofruesit të shërbimit

Në Prokurorinë Themelore është duke u zhvilluar procedurë penale për shkak të ekzistimit të dyshimit për kryerjen e veprës penale _____ në bazë të nenit _____ të KP-së. Një nga aspektet e hetimit fokusohet në të dhënat nga platforma e tregtimit të monedhave virtuale _____ (emri i platformës për tregtim si p.sh. Coinbase).

Në bazë të kompetencave që më janë autorizuar nga neni 198 i Ligjit për Procedurën Penale, kërkoj të dhëna në lidhje me transaksionet e dërguara nga klasteri _____ (të specifikohet klasteri i interesit):

- A. Detajet e regjistrimit të llogarisë(ve) të shkëmbyesit që e ka pranuar monedhën virtuale _____ (emri i monedhës virtuale) në portofolet elektronike që janë përfshirë në Shtojcën I të kësaj kërkesë dhe që janë bashkangjitur në një medie optike:
- emri i përdoruesit të përdorur;
 - emri i vërtetë i përdorur në procesin e kontrollit të klientit KYC (Know your client - njih klientin tënd) - emri i plotë ligjor, data e lindjes, moshë, kombësia, gjinia, nënshkrimi dhe kopja digjitale e dokumentit të identitetit

të përdorur për krijimin e llogarive (si p.sh. pasaporta, leja e vozitjes, letërnjoftimi kombëtar, numrin tatimor i identifikimit, numri i pasaportës, të dhënat e lejes së vozitjes, të dhënat e letërnjoftimit kombëtar, informacioni për vizë ose vërtetimi i vendbanimit);

- adresa e e-mail-it të përdorur;
 - numri i telefonit;
 - adresa e shtëpisë;
 - informacioni për llogarinë bankare;
 - numri i llogarisë kryesore të kartës së pagesës (PAN);
 - data kur u krijua(n) llogaria(të);
 - data e hyrjes së fundit në llogari(të).
- B. Seancat e hyrjes në llogarinë(të) përkatëse:
- bilanci i llogarisë rrjedhëse;
 - lista e transaksioneve të MV-ve të dërguara nga llogaria(të) e shkëmbyesit (duke përfshirë transaksionet e brendshme ose të jashtme brenda platformës, drejt portofoleve ose shkëmbyesve të tjerë);
 - mesazhet ndërmjet përdoruesit(ve) të llogarisë(ve) të shkëmbyesit dhe përdoruesve të tjerë të kësaj platforme.
- C. Detaje rreth portofoleve elektronike ekzistuese të MV në platformën e shkëmbyesit (bursës) ku është dërguar monedha virtuale u dërgua nga klasteri _____ (të specifikohet klasteri i interesit):
- bilanci i llogarisë rrjedhëse;
 - lista e transaksioneve të MV-ve të dërguara nga llogaria(të) e shkëmbyesit (duke përfshirë transaksionet e brendshme ose të jashtme brenda platformës, drejt portofoleve ose shkëmbyesve të tjerë);
 - mesazhet ndërmjet përdoruesit(ve) të llogarisë(ve) të shkëmbyesit dhe përdoruesve të tjerë të kësaj platforme.
- D. Informacioni tregtar për MV-të (detajet e transaksionit) në lidhje me llogaritë e përmendura në pikën C:
- Numri unik i identifikimit (ID unike) - numri ID që e identifikon një tregti konkrete;
 - Numri unik i reklamës (Ad Unique) - numri ID që identifikon se cila reklamë është përdorur për të krijuar tregtinë;
 - Ofruesi online - Emri i mënyrës së pagesës (vetëm tregtimet online);
 - Blerësi - Emri i përdoruesit të llogarisë së përdoruesit të shkëmbyesit që blen MV;
 - Shitësi - Emri i përdoruesit të llogarisë së përdoruesit të shkëmbyesit që shet MV;
 - Çmimi fiat - Vlera tregtare e shprehur në reklamën e specifikuar;
 - Sasia e MV - Vlera tregtare e shprehur në MV;
 - Kontesti ka filluar - Tregon nëse tregtia është kontestuar apo jo;

- Mesazhi i fundit nga - tregon vulën kohore të mesazhit të fundit të përdoruesit në çatin (bisedën) e tregtisë;
- Mesazhi i fundit i administratorit - tregon vulën kohore të mesazhit të fundit të administratorit në çatin (bisedën) e tregtisë;

Informacionet shtesë që po ashtu duhet të jepen janë si më poshtë:

1. Nëse llogaritë e përmendura në pikën C janë raportuar në lidhje me aktivitetin e dyshuar;
2. Nëse llogaritë e përmendura janë përfshirë në kërkesat tjera nga organet e zbatimit të ligjit.

Përgjigja duhet t'i dërgohet prokurorit publik jo më vonë se 30 ditë nga pranimi i kësaj kërkesë.

Prokurori publik

Shtojca II - Kërkesë për shqiptimin e masave të përkohshme mbrojtëse për MV-të që janë dobi pronësore të veprës penale dhe MV-të që janë instrumente të veprës penale

Formulari 1: Kërkesë për shqiptimin e masës së përkohshme për sigurimin e monedhave virtuale që paraqesin përfitim të dobisë së paligjshme pronësore (MV-të si dobi pronësore të veprës penale)

PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

KO/RO nr. _____/_____

(Vendi, data)

DERI TE:

GJYKATA THEMELORE - _____

- Gjyqtari i procedurës paraprake –

Në procedurën penale që zhvillohet pranë kësaj Prokurorie Publike nën RO/KO nr._____, kundër të dyshuarit _____, për shkak të ekzistimit të bazave për dyshim/dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale _____ nga neni _____ i Kodit Penal, në bazë të nenit 39 paragrafi 2 dhe nenit 353 paragrafi 1 në lidhje me nenin 202 të LPK-së, parashtroj:

Kërkesë për shqiptimin e masës së përkohshme për sigurimin - sekuestrimin e përkohshëm të sendeve (monedhave virtuale)

Nga portofoli i monedhave virtuale _____ (të jepet një përshkrim i portofolit, për shembull: ku ndodhet, për çfarë lloj portofoli bëhet fjalë ose numri i identifikimit të portofolit nëse dihet) të _____ (emri dhe mbiemri i personit, numri amë i qytetarit- NAQ, vendbanimi) të sekuestrohen përkohësisht sendet edhe atë të gjitha _____ (emri i monedhës virtuale, për shembull bitcoin-e) të vendosura në portofolin për monedha virtuale, të cilat më datë _____ në _____ kanë vlerën _____ denarë.

Sekuestrimi i përkohshëm i monedhave virtuale duhet të bëhet nga pjesëtarët e policisë gjyqësore nga _____ (emri i organit që do ta bëjë sekuestrimin, p.sh.

Sektori për Forenzikën Digjitale në MPB; hetuesit nga qendra hulumtuese, etj.).

Sekuestrimi i monedhave virtuale - _____ (sasia dhe emri i monedhës virtuale që pritet të gjendet në portofol, për shembull: 5 bitcoin-e), të bëhet duke transferuar _____ (emri i monedhës virtuale) nga portofoli i përshkruar më sipër në portofolin e sigurt me numër publik të adresës _____ (të shënohet vetëm adresa publike e portofolit të portofolit të sigurisë, e jo edhe çelësi privat!).

Pas transferimit të _____ (emri i monedhës virtuale), portofoli i sigurt i dorëzohet për ruajtje _____ (organi që do ta ruajë portofolin e sigurt - Prokuroria Publike, MPB-ja, Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, etj.).

Monedhat virtuale sekuestrohen përkohësisht deri në përfundimin e procedurës në gjykatën e shkallës së parë.

Arsyetim

Pranë kësaj Prokurorie Publike është duke u zhvilluar procedurë penale kundër _____, për shkak të ekzistimit të bazave për dyshim/dyshimit të bazuar se ka(në) kryer veprë penale _____ nga neni ___ i KP-së.

Në fakt, _____ (këtu duhet të jepet një përshkrim i shkurtër i veprës penale dhe rrethanave që i ka të njohura prokurori publik, së bashku me provat mbi të cilat bazohet dyshimi se monedhat virtuale paraqesin përfitim të dobisë pronësore nga vepra e kryer penale. Në veçanti, duhet të shpjegohen njohuritë dhe provat nga të cilat del fakti se në portofolin e përmendur në kërkesë ka monedha virtuale dhe në çfarë sasive. Nëse ka një dallim të madh midis dobisë së përfituar pronësore dhe vlerës momentale të monedhave virtuale, në këtë seksion është e nevojshme të shpjegohen arsyet e një dallimi të tillë. Është e rëndësishme të përcaktohet lloji i monedhave virtuale që kërkohet të sekuestrohen - për shembull bitcoin, etherium etj. dhe sasia e tyre, sipas të dhënave që janë siguruar përmes veprimeve të ndërmarra hetimore. Në këtë pjesë është e nevojshme të bëhet një përshkrim i personit që posedon monedha virtuale dhe nëse bëhet fjalë për një person të tretë, e jo për të dyshuarin, duhet të sqarohet edhe baza ligjore për sekuestrimin e monedhave nga personi i tretë - për shembull kur i janë transferuar pa kompensim.).

Në rastin konkret, e pasi bëhet fjalë për monedha virtuale, nuk ka dyshim se ekziston rreziku që deri në përfundim të procedurës penale të vështirësohet dukshëm ose të pamundësohet sekuestrimi i tyre. Kështu, nuk është e mundur të dihet me siguri se kush ka qasje në portofolin për monedha virtuale dhe kush mund të hyjë nga distanca në portofol dhe t'i tjetërsojë ose t'ua transferojë monedhat virtuale përdoruesve të tjerë. Vetë rrethanat e rastit, si ndërmarrja e

masave për mbrojtjen e anonimitetit të personit nga i cili kërkohet sekuestrimi i përkohshëm i monedhave virtuale, sugjerojnë nëse këto monedha virtuale nuk sekuestrohen përkohësisht, atëherë gjasat për sekuestrimin e tyre deri në fund të procedurës penale do të vështirësohet dukshëm, gjegjësisht do të pamundësohet.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, kërkoj nga gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës të shqiptojë masë të përkohshme të sigurimit - sekuestrimin e përkohshëm të sendeve (monedhave virtuale) edhe atë _____ (sasia dhe përshkrimi i monedhës virtuale) nga personi _____, për të cilat dyshohet se paraqesin përfitim të dobisë së paligjshme pronësore.

Prokurori Publik

Formulari 2: Kërkesë për shqiptimin e masës së përkohshme për sigurimin e monedhave virtuale që sipas KP-së duhet të sekuestrohen (MV-të si doli pronësore të veprës penale)

PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

KO/RO nr. _____/_____

(Vendi, data)

DERI TE:

GJYKATA THEMELORE - _____

- Gjyqtari i procedurës paraprake -

Në procedurën penale që zhvillohet pranë kësaj Prokurorie Publike nën RO/KO nr. _____, kundër të dyshuarit _____, për shkak të ekzistimit të bazave për dyshim/dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale _____ nga neni _____ i Kodit Penal, në bazë të nenit 39 paragrafi 2 dhe nenit 202 të LPK-së, parashtroj:

Kërkesë për shqiptimin e masës së përkohshme për sigurim - sekuestrim të përkohshëm të sendeve (monedhave virtuale)

Nga portofoli i monedhave virtuale _____ (të jepet një përshkrim i portofolit, për shembull: ku ndodhet, për çfarë lloj portofoli bëhet fjalë ose numri i identifikimit të portofolit nëse dihet) të _____ (emri dhe mbiemri i personit, numri amë i qytetarit - NAQ, vendbanimi) të sekuestrohen përkohësisht sendet edhe atë të gjitha _____ (emri i monedhës virtuale, për shembull bitcoin-e) të vendosura në portofolin për monedha virtuale, të cilat më datë _____ në _____ kanë vlerën _____ denarë.

Sekuestrimi i përkohshëm i monedhave virtuale duhet të bëhet nga pjesëtarët e policisë gjyqësore nga _____ (emri i organit që do ta bëjë sekuestrimin, p.sh. Sektori për Forenzikën Digjitale në MPB; hetuesit nga qendra hulumtuese, etj.).

Sekuestrimi i monedhave virtuale - _____ (sasia dhe emri i monedhës virtuale që pritet të gjendet në portofol, për shembull: 5 bitcoin-e), të bëhet duke

transferuar _____ (emri i monedhës virtuale) nga portofoli i përshkruar më sipër në portofolin e sigurt me numër publik të adresës _____ (të shënohet vetëm adresa publike e portofolit të portofolit të sigurt, e jo edhe çelësi privat!).

Pas transferimit të _____ (emri i monedhës virtuale), portofoli i sigurt i dorëzohet për ruajtje _____ (organi që do ta ruajë portofolin e sigurt - Prokuroria Publike, MPB-ja, Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, etj.).

Monedhat virtuale sekuestrohen përkohësisht deri në përfundimin e procedurës në gjykatën e shkallës së parë.

Arsyetim

Pranë kësaj Prokurorie Publike është duke u zhvilluar procedurë penale kundër _____, për shkak të ekzistimit të bazave për dyshim/dyshimit të bazuar se ka(në) kryer vepër penale _____ nga neni ___ i KP-së.

Përkatësisht, _____ (këtu duhet të jepet një përshkrim i shkurtër i veprës penale dhe rrethanave që i ka të njohura prokurori publik, së bashku me provat mbi të cilat bazohet dyshimi se monedhat virtuale sipas KP-së duhet të sekuestrohen. Në veçanti, duhet të shpjegohen njohuritë dhe provat nga të cilat del fakti se në portofolin e përmendur në kërkesë ka monedha virtuale dhe në çfarë sasia. Është e rëndësishme të përcaktohet lloji i monedhave virtuale që kërkohet të sekuestrohen - për shembull bitcoin, etherium etj. dhe sasia e tyre, sipas të dhënave që janë siguruar përmes veprimeve të ndërmarra hetimore. Në këtë pjesë është e nevojshme të bëhet një përshkrim i personit që posedon monedha virtuale dhe nëse bëhet fjalë për një person të tretë, e jo për të dyshuarin, duhet të sqarohet edhe baza ligjore për sekuestrimin e monedhave nga personi i tretë - për shembull kur i janë transferuar pa kompensim.).

Në rastin konkret, e pasi bëhet fjalë për monedha virtuale, nuk ka dyshim se ekziston rreziku që deri në përfundim të procedurës penale të vështirësohet dukshëm ose të pamundësohet sekuestrimi i tyre. Kështu, nuk është e mundur të dihet me siguri se kush ka qasje në portofolin për monedha virtuale dhe kush mund të hyjë nga distanca në portofol dhe t'i tjetërsojë ose t'ua transferojë monedhat virtuale përdoruesve të tjerë. Vetë rrethanat e rastit, si ndërmarrja e masave për mbrojtjen e anonimitetit të personit nga i cili kërkohet sekuestrimi i përkohshëm i monedhave virtuale, sugjerojnë nëse këto monedha virtuale nuk sekuestrohen përkohësisht, atëherë gjasat për sekuestrimin e tyre deri në fund të procedurës penale do të vështirësohet dukshëm, gjegjësisht do të pamundësohet.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, kërkohet nga gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës të shqiptojë masë të përkohshme të sigurimit - sekuestrimin e

përkohshëm të sendeve (monedhave virtuale) edhe atë _____ (sasia dhe përshkrimi i monedhës virtuale) nga personi _____, e të cilat sipas KP-së duhet të sekuestrohen.

Prokurori Publik

Aneksi III - shabllonet e kërkesës për urdhër kërkimi në kombinim me kërkesën për sekuestrim të përkohshëm të MV-ve

Formulari 1: Kërkesë për lëshimin e urdhrit për kontroll në një sistem kompjuterik dhe urdhrit për sekuestrimin e monedhave virtuale që paraqesin përfitim të dobisë së paligjshme pronësore (MV si dobi pronësore të veprës penale)

PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

KO/RO nr. _____/_____

(Vendi, data)

DERI TE:

GJYKATA THEMELORE - _____

- Gjyqtari i procedurës paraprake -

Në procedurën penale që zhvillohet pranë kësaj Prokurorie Publike nën RO/KO nr._____, kundër të dyshuarit _____, për shkak të ekzistimit të bazave për dyshim/dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale _____ nga neni _____ i Kodit Penal, në bazë të nenit 39 paragrafi 2 dhe nenit 181 paragrafi 2 në lidhje me nenin 184 dhe 186 të LPK-së, si dhe nenin 194 të LPK, parashtroj:

1. Kërkesë për të lëshuar urdhër kontrolli në sistemet kompjuterike – pajisjet elektronike në pronësi dhe të përdorura nga _____, edhe atë:

a. Tablet të markës _____, modeli _____, me numër serik _____

b. Telefon celular të markës _____, modeli _____, me numër të IMEI-it _____, me kartë SIM nga operatori _____ me numër telefoni _____ dhe numër serik _____

c. Laptop i markës _____, modeli _____, me numër serik _____

- me qëllim të gjetjes së sendeve të rëndësishme për procedurën penale, në pajtim me nenin 182 paragrafi 1 të LPK-së.

- 2. Kërkesë për lëshimin e urdhrin për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve (të dhënave elektronike) që mund të shërbejnë si provë në procedurë penale dhe që paraqesin përfitim të dobisë së paligjshme pronësore** edhe atë të gjitha _____ (emri i monedhës virtuale, për shembull bitcoin-e) të vendosura në portofolin e monedhës virtuale që është në dispozicion në pajisjet elektronike të përshkruara në pikën 1.

Kontrolli i sistemeve kompjuterike dhe sekuestrimi i të dhënave elektronike duhet të bëhet nga pjesëtarët e policisë gjyqësore nga _____ (emri i organit që do ta bëjë sekuestrimin, p.sh. Sektori për Forenzikën Digjitale në kuadër të MPB-së; hetuesit nga Qendra hetuese Shkup etj.), të cilëve u përcillet urdhri së bashku me pajisjet elektronike të sekuestruara, kurse pjesëtarët e policisë gjyqësore duhet urdhrin t'ua dorëzojnë drejtpërdrejt palëve.

Kontrolli duhet të kryhet nga pjesëtarë të policisë gjyqësore me qasje në portofolin e monedhave virtuale të instaluar në pajisjet elektronike të përshkruara në pikën 1.

Sendet, përkatësisht të dhënat elektronike duhet të sekuestrohen pa vonesë nga pronari dhe shfrytëzuesi i pajisjeve elektronike të përshkruara në pikën 1 - _____ (emri dhe mbiemri i personit).

Sekuestrimi i të dhënave elektronike - _____ (sasia dhe emri i monedhës virtuale që pritet të gjendet në portofol, për shembull: të paktën 5 bitcoin-e), të bëhet duke transferuar _____ (emri i monedhës virtuale) nga portofoli në të cilin janë gjetur në portofolin e sigurt me numër adrese _____ (të shënohet vetëm adresa publike e portofolit të sigurt, e jo edhe çelësi privat!).

Pa transferimit të _____ (emri i monedhës virtuale), portofoli i sigurt i dorëzohet për ruajtje _____ (organi që do ta ruajë portofolin e sigurt - Prokuroria Publike, MPB-ja, Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, etj.).

Arsyetim

Pranë kësaj Prokurorie Publike është duke u zhvilluar procedurë penale kundër _____, për shkak të ekzistimit të bazave për dyshim/dyshimit të bazuar se ka(në) kryer veprë penale _____ nga neni ___ i KP-së.

Në fakt, _____ (këtu duhet të jepet një përshkrim i shkurtër i veprës penale dhe rrethanave që i ka të njohura prokurori publik, së bashku me provat mbi të cilat bazohet dyshimi se monedhat virtuale paraqesin përfitim të dobisë pronësore nga vepra e kryer penale. Në veçanti, duhet të shpjegohen njohuritë për ekzistencën e portofolit për monedha virtuale në pajisje dhe prej ku lindin dyshimet se monedhat virtuale mund të gjenden në pajisje dhe në çfarë mase. Është e rëndësishme të përcaktohet lloji i monedhave virtuale që

kërkohet të sekuestrohen - për shembull bitcoin, etherium etj. dhe sasia e tyre, sipas të dhënave që janë siguruar përmes veprimeve të ndërmarra hetimore).

Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, ka të ngjarë që në sistemet kompjuterike - pajisjet elektronike në pronësi të _____ do të gjendet portofoli për _____ (emri i monedhës virtuale, për shembull bitcoin), si dhe _____ (emri i monedhës virtuale, për shembull bitcoin). Bëhet fjalë për sende të rëndësishme në procedurën penale sepse ekziston dyshimi se bëhet fjalë për përfitim të dobisë pronësore nga vepra e kryer penale, siç u shpjegua më lart. Nga njohuritë e deritanishme të hetimit, bëhet fjalë për të paktën _____ (emri i monedhës virtuale, për shembull bitcoin-e). Probabiliteti që këto sende të rëndësishme për procedurën penale të gjenden në sistemet kompjuterike të _____ (emri dhe mbiemri i personit) lind nga _____ (të shënohen njohuritë që i ka prokurori publik).

Për të gjitha arsyet e mësipërme, kërkoj nga gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës që të lëshojë urdhër për kontroll të sistemit kompjuterik - pajisjeve elektronike në pronësi dhe të përdorura nga _____, për gjetjen dhe sekuestrimin e sendeve të rëndësishme për procedurën penale, si dhe urdhër për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve (të dhënave elektronike) që mund të shërbejnë si provë në procedurën penale dhe për të cilat dyshohet se paraqesin përfitim të dobisë së paligjshme pronësore.

Prokurori Publik

Formulari 2: Kërkesë për lëshimin e urdhrin për kontroll të sistemit kompjuterik dhe urdhrin për sekuestrimin e monedhave virtuale që sipas KP-së duhet të konfiskohen (MV-të si instrumente të veprës penale)

PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

KO/RO nr. _____/_____

(Vendi, data)

DERI TE:

GJYKATA THEMELORE - _____

- Gjyqtari i procedurës paraprake -

Në procedurën penale që zhvillohet pranë kësaj Prokurorie Publike nën RO/KO nr._____, kundër të dyshuarit _____, për shkak të ekzistimit të bazave për dyshim/dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale _____ nga neni _____ i Kodit Penal, në bazë të nenit 39 paragrafi 2 dhe nenit 181 paragrafi 2 në lidhje me nenin 184 dhe 186 të LPK-së, si dhe nenin 194 të LPK, parashtroj:

3. Kërkesë për të lëshuar urdhër kontrolli në sistemet kompjuterike – pajisjet elektronike në pronësi dhe të përdorura nga _____, edhe atë:

- a. Tablet të markës _____, modeli _____, me numër serik _____
- b. Telefon celular të markës _____, modeli _____, me numër të IMEI-it _____, me kartë SIM nga operatori _____ me numër telefoni _____ dhe numër serik _____
- c. Laptop i markës _____, modeli _____, me numër serik _____

- me qëllim të gjetjes së sendeve të rëndësishme për procedurën penale, në pajtim me nenin 182 paragrafi 1 të LPK-së.

4. Kërkesë për lëshimin e urdhrin për sekuestrim të përkohshëm të sendeve (të dhënave elektronike) që sipas Kodit Penal duhet të sekuestrohen edhe atë të gjitha _____ (emri i monedhës virtuale, për shembull bitcoin-e) të vendosura në portofolin e monedhës virtuale që është në dispozicion në pajisjet elektronike të përshkruara në pikën 1.

Kontrolli i sistemeve kompjuterike dhe sekuestrimi i të dhënave elektronike duhet të bëhet nga pjesëtarët e policisë gjyqësore nga _____ (emri i organit që do ta bëjë konfiskimin, p.sh. Sektori për Forenzikën Digjitale në kuadër të MPB-së; hetuesit nga Qendra hetuese Shkup etj.), të cilëve u përcillet urdhri së bashku me pajisjet elektronike të sekuestruara, kurse pjesëtarët e policisë gjyqësore duhet urdhrin t'ua dorëzojnë drejtpërdrejt palëve.

Kontrolli duhet të kryhet nga pjesëtarë të policisë gjyqësore me qasje në portofolin e monedhave virtuale të instaluar në pajisjet elektronike të përshkruara në pikën 1.

Sendet, përkatësisht të dhënat elektronike duhet të sekuestrohen pa vonesë nga pronari dhe shfrytëzuesi i pajisjeve elektronike të përshkruara në pikën 1 - _____ (emri dhe mbiemri i personit).

Sekuestrimi i të dhënave elektronike - _____ (sasia dhe emri i monedhës virtuale që pritet të gjendet në portofol, për shembull: të paktën 5 bitcoin-e), të bëhet duke transferuar _____ (emri i monedhës virtuale) nga portofoli në të cilin janë gjetur në portofolin e sigurt me numër adrese _____ (të shënohet vetëm adresa publike e portofolit të sigurt, e jo edhe çelësi privat!).

Pas transferimit të _____ (emri i monedhës virtuale), portofoli i sigurt i dorëzohet për ruajtje _____ (organi që do ta ruajë portofolin e sigurisë - Prokuroria Publike, MPB-ja, Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, etj.).

Arsyetim

Pranë kësaj Prokurorie Publike është duke u zhvilluar procedurë penale kundër _____, për shkak të ekzistimit të bazave për dyshim/dyshimit të bazuar se ka(në) kryer veprë penale _____ nga neni ___ i KP-së.

Përkatësisht, _____ (këtu duhet të jepet një përshkrim i shkurtër i veprës penale dhe rrethanave që i ka të njohura prokurori publik, së bashku me provat mbi të cilat bazohet dyshimi se monedhat virtuale janë sende që sipas KP-së duhet të konfiskohen. Në veçanti, duhet të shpjegohen njohuritë për ekzistencën e portofolit për monedha virtuale në pajisje dhe prej ku lindin dyshimet se monedhat virtuale mund të gjenden në pajisje dhe në çfarë mase. Është e rëndësishme të përcaktohet lloji i monedhave virtuale që kërkohet të sekuestrohen - për shembull bitcoin, etherium etj. dhe sasia e tyre, sipas të dhënave që janë siguruar përmes veprimeve të ndërmarra hetimore).

Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, ka të ngjarë që në sistemet kompjuterike - pajisjet elektronike në pronësi të _____ do të gjendet portofoli për _____ (emri i monedhës virtuale, për shembull bitcoin-e), si

dhe _____ (emri i monedhës virtuale, për shembull bitcoin-e). Bëhet fjalë për sende të rëndësishme në procedurën penale sepse ekziston dyshimi se bëhet fjalë për sende që sipas KP-së duhet të sekuestrohen, siç u shpjegua më lart. Nga njohuritë e deritanishme të hetimit, bëhet fjalë për të paktën _____ (emri i monedhës virtuale, për shembull bitcoin-e). Probabiliteti që këto sende të rëndësishme për procedurën penale të gjenden në sistemet kompjuterike të _____ (emri dhe mbiemri i personit) lind nga _____ (të shënohen njohuritë që i ka prokurori publik).

Për të gjitha arsyet e mësipërme, kërkoj nga gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës që të lëshojë urdhër për kontroll të sistemit kompjuterik - pajisjeve elektronike në pronësi dhe të përdorura nga _____, për gjetjen dhe sekuestrimin e sendeve të rëndësishme për procedurën penale, si dhe urdhër për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve (të dhënave elektronike), të cilat sipas KP-së duhet të sekuestrohen.

Prokurori Publik



Follow OSCE



OSCE Mission to Skopje
Bulevar 8-mi Septemvri No. 16, 1000 Skopje
e-mail: info-MK@osce.org
website: <http://www.osce.org/mission-to-skopje>